

BESIMI FETAR, DIALOGU DHE SIGURIA

Nxitja e dialogut dhe veprimeve të përbashkëta përtej kufijve fetarë dhe besimeve të ndryshme



osce
ODIHR

BESIMI FETAR, DIALOGU DHE SIGURIA

**Nxitja e dialogut dhe veprimeve të përbashkëta përtej kufijve
fetarë dhe besimeve të ndryshme**



Falënderime

ODIHR-i dëshiron të falënderojë të gjithë ata që gjetën kohën të ndajnë me ne njohuritë, ekspertizën dhe përvojën e tyre, që nga përfaqësuesit e shoqërisë civile, akademikët dhe zyrtarët qeveritarë, deri te përfaqësuesit e komuniteteve fetare, besimeve të ndryshme dhe ekspertët e dialogut. Falënderime të veçanta shkojnë edhe për anëtarët e panelit (dy paneleve njëri pas tjetrit) të ekspertëve të ODIHR-it për lirinë e fesë dhe besimit, të cilët kanë dhënë kontribute të konsiderueshme për këtë botim, ku përfshihen Thiago Alves Pinto, Pasquale Annicchino, Danil Buglov, Elizabeth Clark, Joelle Fiss, Mariam Gavatdze, Jagbir Jhutti-Johal, John Kinahan, Genti Kruja, Fabio Petito, Ahmed Shaheed, Peter Weiderud, Marco Ventura dhe Tamara Vukacevic. Përveç tyre, kontribute të vyera kanë dhënë edhe: Indira Aslanova, Andrea Benzo, Judd Birdsall, Josh Cass, Catherine Cornille, Salpy Eskidjian, Gabriele Fattori, Silvio Ferrari, Rachel Forster, Benjamin Greenacre, Elizabeta Kitanovic, Sarah Markiewicz dhe Sharon Rosen. ODIHR-i vlerëson gjithashtu bashkëpunimin dhe mbështetjen e Ministrisë Italiane të Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar, si dhe Departamentin e Drejtësisë në Universitetin e Foxhias në Itali, ku u zhvillua takimi i parafundit për rishikimin e tekstit të këtij udhëzuesi më 29 qershor 2023.

Besimi, dialogu dhe siguria - Nxitja e dialogut dhe veprimeve të përbashkëta përtej kufijve fetarë dhe besimit

Publikuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR)

ul. Miodowa 10

00-251 Warsaw


Poloni

www.osce.org/odih

© OSCE/ODIHR 2025

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përmbajtja e këtij publikimi mund të përdoret dhe të kopjohet lirshëm për qëllime edukuese dhe për qëllime të tjera jofitimprurëse, me kusht që në çdo riprodhim të tillë të shënohet OSBE/ODIHR-i si burimi i tij.

ISBN: 978-92-9271-307-2



PËRMBAJTJA

Fjalorth	6
Parathënie	8
Kapitulli 1 Nevoja për dialog dhe veprim të përbashkët	9
Metodologjia	14
Kapitulli 2 Liria e mendimit, ndërgjegjes, fesë ose besimit	15
2.1. Kufizimet e lirisë së fesë ose besimit	19
2.2. Shkaqet e kufizimeve	19
Kapitulli 3 Dialogu dhe veprimet e përbashkëta përtej kufijve të feve ose besimeve të ndryshme	23
Kapitulli 4 Roli i shtetit	29
4.1. Respektimi i të drejtave të njeriut	32
4.2. Mos bëj dëm	47
4.3. Barazia	50
4.4. Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja	53
4.5. Transparenca dhe llogaridhënia	70
Kapitulli 5 Projektet dhe thirrjet për financim	73
5.1. Procesi i hartimit të thirrjeve për financim	76
5.2. Vlerësimi i aplikimeve	73
5.3. Matja e ndikimit dhe suksesit	81
Kapitulli 6 Lista e kontrollit për shtetet	83
Kapitulli 7 Përfundim	93
Shtojcat	97
Shtojca 1 — Udhëzime për lehtësuesit e dialogut	98
Shtojca 2 — Pyetjet e sondazhit	100
Shtojca 3 — Përmbledhja e përgjigjeve të sondazhit	102
Fundshënimet	104

> Kliko në titullin e një kapitulli më sipër për të shkuar në faqen përkatëse.

> Në çdo faqe të dokumentit, mund të shkosh në fund të faqes dhe të kthehesh sërish te faqja e përmbajtjes.

FJALORTH

Siguria gjithëpërfshirëse

Modeli i sigurisë gjithëpërfshirëse i OSBE-së përbëhet nga tre dimensione që plotësojnë njëri-tjetrin: dimensionin njerëzor, dimensionin politiko-ushtarak dhe dimensionin ekonomik-mjedisor, të cilët janë njëjloj të rëndësishëm.

Dimensioni njerëzor i sigurisë

Ky dimension përfshin të gjitha aspektet e të drejtave të njeriut, lirive themelore, demokracisë, tolerancës, mosdiskriminimit dhe shtetit të së drejtës.¹ Sipas këtij dimension, mosrespektimi i këtyre aspekteve përbën po aq kërcënim për sigurinë kombëtare sa edhe kërcënimet ushtarake.

Dialogu dhe veprimi i përbashkët përtej kufijve të fesë ose të besimeve fetare

Në këtë udhëzues, ky term përfshin, që në nivelet bazë e deri në nivelet e larta, dialogun dhe partneritetin, formal ose informal, drejtuar nga shteti ose organizuar në mënyrë të pavarur, i cili mund të jetë:

- ndërfetar: ndërmjet dy ose më shumë feve
- ndërbesimor: ndërmjet dy ose më shumë besimeve (shpesh shihet si dialogu më gjithëpërfshirës)
- brendafetar: brendapërbrenda një feje/besimi
- ndërkonfesional: ndërmjet prejardhjeve dhe/ose bindjeve të ndryshme fetare

Shënim: kur në këtë udhëzues flitet për dialog, nuk bëhet fjalë për dialog shpirtëror apo teologjik, por për dialogun mbi shqetësimet e jetës së përditshme.

Veprimi i përbashkët

Partneritetet midis komuniteteve, apo besimeve të ndryshme fetare, që përpiqen të adresojnë në mënyrë aktive probleme të përbashkëta, shpesh si pjesë e dialogut mes tyre. Këto aktivitete mund të përfshijnë aktorë që i përkasin një feje apo besimi fetar dhe/ose aktorë laikë.

Lehtësimi i dialogut

Procesi që bën të mundur dhe përmirëson komunikimin mes palëve të ndryshme të përfshira në një mosmarrëveshje ose konflikt. Qëllimi kryesor i këtij procesi nuk është arritja e një marrëveshjeje, një rezultati apo një zgjidhjeje specifike, megjithëse procesi i dialogut mund të çojë

në vendime dhe veprime konkrete, por nxitja e njohjes, mirëkuptimit, ndjeshmërisë dhe besimit më të madh mes të gjitha palëve të përfshira.²

Mjedis favorizues

Mbrojtja efikase e dinjitetit, integritetit fizik dhe psikologjik, lirisë dhe sigurisë së çdo individi që i përket një feje, apo një besimi është një parakusht për t'i dhënë atij mundësinë për t'u angazhuar në dialog dhe për të mbrojtur të drejtat e njeriut përmes të vepruarit bashkërisht. Kjo përfshin marrjen e masave nga ana e shteteve për të bërë përpara në lirinë e mendimit, ndërgjegjes, fesë ose besimit (LFB) dhe në të gjitha të drejtat dhe liritë e tjera të njeriut për të gjithë.

Liria e Mendimit, Ndërgjegjes, Fesë ose Besimit (LFB)

Kjo liri mishërohet në nenin 18 si të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNJ)³ ashtu edhe në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP), i cili thotë: “Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë. Kjo e drejtë përfshin lirinë e individit për të pasur ose për të përqaftuar një fe ose besim sipas zgjedhjes së tij, si dhe lirinë për të shfaqur publikisht ose privatisht, si individ ose bashkë me individë të tjerë, fenë e vet ose besimin te adhurimi, respektimi, praktikimi dhe të mësuarit e saj individëve të tjerë.”⁴

Sekularizmi

Ndarja midis fesë dhe shtetit, që ka për qëllim ruajtjen e entiteteve fetare ose besimeve nga ndërhyrjet politike dhe mbrojtjen e sferës politike nga ndërhyrjet fetare. Sekularizmi nuk ka për qëllim ta kufizojë fenë, por të sigurojë një kuadër ligjor që garanton ushtrimin e lirë të fesë ose besimit.⁵

PARATHËNIE

Nga Bakuja në Bruksel, nga Londra në Stamboll dhe nga Nju Jorku në Sarajevë, pluralizmi i fesë dhe besimit është karakteristikë dalluese e rajonit të OSBE-së. Kjo larmi besimi, mendimi dhe shprehjeje krijon një kulturë të pasur dhe mundësi për të mësuar dhe për t'u rritur, nga e cila mund të përfitojë e gjithë shoqëria. Në të njëjtën kohë, ndryshime të tilla nuk janë të lehta për të gjithë, prandaj duhen menaxhuar mirë në mënyrë që ata të cilët mund të përfitojnë nga fragmentimi shoqëror, të mos t'i shfrytëzojnë dot këto dallime. Për të qenë paqësore, shoqërive pluraliste u duhet një nivel i lartë tolerance dhe besimi social; kjo mund të ndodhë vetëm kur shtetet pa asnjë dallim bëjnë përpjekje aktive dhe të dukshme për të përmbushur plotësisht detyrimet e tyre ndërkombëtare sa i përket lirisë së mendimit, ndërgjegjes, fesë ose besimit dhe të drejtave të tjera të njeriut, pa asnjë dallim. Programi i ODIHR-it për Lirinë e Fesë ose Besimit dhe Paneli i tij i Ekspertëve për Lirinë e Fesë ose Besimit ofron këshilla dhe ekspertizë, si dhe zbaton disa projekte duke u ardhur në ndihmë shteteve pjesëmarrëse për këtë qëllim.

Synimi i këtij udhëzuesi është që t'u vijë në ndihmë shteteve pjesëmarrëse, që ato të krijojnë një mjedis, ku të mund të lulëzojnë diskutimet, dialogu dhe veprimet e përbashkëta mes komuniteteve. Ai mund të jetë i dobishëm edhe për aktorët joshtetërorë, që dëshirojnë të promovojnë dialogun dhe veprimin e përbashkët përtej kufijve të fesë ose besimeve të ndryshme. Udhëzuesi nuk ofron një model, që u përshtatet të gjithëve, por ofron disa këshilla praktike se si krijohet një mjedis i tillë. Nxitja e respektimit më të madh të lirisë themelore të fesë ose besimit krahas të gjitha të drejtave dhe lirive të tjera themelore të njeriut është thelbësore për garantimin e sigurisë së rajonit të OSBE-së.

Matteo Mecacci

Drejtor i ODIHR-it

KAPITULLI 1

NEVOJA PËR DIALOG DHE VEPRIM TË PËRBASHKËT

“ Dialogu dhe veprimi i përbashkët mund të mbështesin përpjekjet e shteteve për krijimin e shoqërive më kohezive dhe më të sigurta. ”



KAPITULLI 1

NEVOJA PËR DIALOG DHE VEPRIM TË PËRBASHKËT

Fetë dhe besimet e ndryshme formojnë identitetin dhe vlerat e individit dhe të komuniteteve. Këto identitete dhe vlera mund t'i frymëzojnë njerëzit drejt gjetjes së gjuhës së përbashkët, aq edhe mund edhe t'i ndajnë ata. Për shkak se identitetet fetare ose besimi i kalojnë kufijtë rajonalë dhe kombëtarë, veprimet dhe ngjarjet në mbarë botën dhe ato në internet shpesh shkaktojnë reagime në komunitetet lokale, që e përçajnë shoqërinë. Këto ndarje, nëse u kushtohet vëmendje, mund t'i nxisin edhe më shumë paragjykimet, urrejtjen, dhunën, pasigurinë e mund të çojnë edhe deri në krime mizore.

Shtetet kanë përgjegjësinë kryesore për garantimin e respektimit dhe të mbrojtjes efikase të të drejtave të njeriut, për parandalimin e nxitjes së urrejtjes dhe mbrojtjen e njerëzve nga krimet. Dialogu dhe të vepruarit bashkërisht përtej kufijve të fesë dhe besimeve të ndryshme mund të mbështesin përpjekjet e shteteve për të ndërtuar shoqëri më të



bashkëlidhura dhe më të sigurt. Ato mund të ndihmojnë në zbutjen e tensioneve, përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve, rritjen e niveleve të besimit dhe mirëkuptimit shoqëror, nxitjen e gëzimit të të drejtave themelore të njeriut dhe nxitjen e qëndrueshmërisë shoqërore ndaj polarizimit dhe paqëndrueshmërisë.⁶ Megjithatë, ky nuk duhet të jetë një aktivitet për të cilin shtetet kujtohen në moment të fundit, vetëm atëherë kur shpërthen dhuna lidhur me një fe, apo besim të caktuar. Lëvizje të tilla mund të çojnë në të mira afatshkurtra, ndërkohë që shtetet duhet të ofrojnë vazhdimisht mbështetje për dialog dhe për nisma të përbashkëta veprimi për arritjen e ndryshimeve pozitive reale dhe të qëndrueshme në shoqëri.

Në rajonin e OSBE-së ka fe dhe besime të ndryshme. Njerëzit që angazhohen aktivisht në komunitetet e tyre janë shpesh të mirëpozicionuar për të identifikuar problemet, që prekin vendet ku ata jetojnë. Aktorët që përfaqësojnë fe dhe besime të ndryshme mund të jenë partnerë të vlefshëm – përmes aktiviteteve të nivelit të lartë dhe atij bazë – në përpjekjet e shteteve për të siguruar të drejtat themelore dhe një siguri gjithëpërfshirëse, veçanërisht për lirinë e mendimit, ndërgjegjes, fesë ose besimit (LFB).

Që të mund të ketë vërtet një dialog kuptimplotë mes komuniteteve të feve ose besimeve të ndryshme, duhet para së gjithësh të respektohet liria e fesë dhe besimit që të mund të ketë një dialog kuptimplotë, duke u ofruar të njëjta rregulla loje përfaqësuesve të feve ose besimeve, të vjetra e të reja, të mëdha ose të vogla, të njohura dhe të panjohura. Liria e fesë dhe e besimit nuk mund të shkëputet nga të drejtat e tjera dhe sidomos nga liria e shprehjes dhe e organizimit. Të drejtat e njeriut

lulëzojnë aty ku ka respekt për zgjedhjet individuale, duke përfshirë edhe zgjedhjen e fesë apo të një besimi të caktuar, si dhe komunikim dhe mirëkuptim reciprok ndërmjet pjesëve të ndryshme të shoqërisë, përfshirë këtu edhe një kulturë të kultivuar të debatit publik.

Të gjitha shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë zotuar se do të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke përfshirë edhe lirinë e fesë dhe të besimit. Ato theksojnë “rëndësinë e një dialogu të vazhdueshëm dhe të përforcuar ndërfetar dhe ndërkulturor për promovimin e një tolerance, respekti dhe mirëkuptimi më të madh”⁷ dhe konkretisht i bëjnë thirrje njëri-tjetrit që të “promovojnë dhe të lehtësojnë dialogun dhe partneritetet e hapura dhe transparente mes feve dhe besimeve të ndryshme”.⁸



“ Shtetet pjesëmarrëse njohin rëndësinë universale të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, respektimi i të cilave është një faktor thelbësor për paqen, drejtësinë dhe mirëqenien e nevojshme për garantimin e zhvillimit të marrëdhënieve miqësore dhe të bashkëpunimit si mes tyre, ashtu edhe midis të gjitha shteteve. ”


Akti përfundimtar i Helsinkit⁹

Në të gjithë rajonin e OSBE-së, politikbërësit po e pranojnë gjithnjë e më shumë se nxitja e dialogut dhe veprimeve të përbashkëta, përtej kufijve të fesë dhe besimit është e dobishme për një respektim më të madh të lirisë së fesë dhe besimit (LFB) dhe ata përqafojnë një sërë qasjesh për ta inkurajuar këtë. Ajo që është më e rëndësishmja, shtetet duhet të krijojnë kushte për dialog dhe veprime të përbashkëta, por jo t’i udhëheqin ato. Dialogu dhe veprimet e përbashkëta nuk duhet të imponohen kurrë nga shteti, si një proces i detyrueshëm nga lart-poshtë, pavarësisht dëshirës dhe nevojave të pjesëmarrësve. As nuk duhet që dialogu dhe veprimet e përbashkëta të shfrytëzohen nga aktorët shtetërorë për t’u hapur rrugë axhendave të caktuara, si për shembull, për të promovuar imazhin e shtetit në shkallë ndërkombëtare. Besimi i njerëzve është tejet i rëndësishëm; po aq vështirë sa mund të fitohet, po aq lehtë mund edhe të humbet. Pjesëmarrja e komunitetit duhet të jetë mbi baza vullnetare dhe pjesëmarrësit duhet të kenë mundësi, që ta përcaktojnë vetë axhendën e dialogut dhe aktiviteteve. Përveç kësaj, pjesëmarrësit duhet të ndihen gjithmonë se mund të shprehen lirshëm për çdo shqetësim, pa frikën e hakmarrjes dhe pa pasur nevojë t’u hyjnë dinamikave të ndërlikuara të pushtetit për mbrojtjen dhe mbështetjen e të drejtave të tyre.

ODIHR-i e ka hartuar këtë udhëzues në përputhje me mandatin e tij dhe në përgjigje të kërkesave nga shtetet pjesëmarrëse për disa orientime dhe mjete praktike, që mund t’u vijnë atyre në ndihmë për të krijuar një mjedis që mundëson një dialog të frytshëm dhe veprim të përbashkët



Rruga drejt sigurisë:



Angazhimet për të drejtën e lirisë së mendimit, ndërjegjes (LFB)

Angazhimet për dialogun mes feve dhe besimeve të ndryshme

përtej kufijve të fesë dhe besimeve të ndryshme. Ky udhëzues nuk prezanton një model që mund të përdoret nga të gjithë. Në fakt, ai na orienton rreth pyetjeve dhe faktorëve, që shtetet duhet të marrin parasysh në trajtimin e kësaj teme. Në të diskutohet se si përzgjidhen nisma të ndryshme dhe si mbështeten ato në praktikë. Ai përfshin disa shembuj praktikash të mira dhe disa intervista me aktorë të angazhuar në dialog dhe në nisma veprimesh të përbashkëta në një gamë të gjerë kontekstesh. Ato tregojnë se si disa forma shumë të ndryshme të dialogut dhe veprimit të përbashkët mund të nxisin më tej respektin për lirinë e fesë dhe besimit dhe për të drejtat dhe liritë e tjera të njeriut. Megjithëse këto raste studimi mund të jenë të vështira për t'u përsëritur në kontekste të ndryshme, ato ofrojnë një këndvështrim interesant mbi mënyrën se si shtetet mund të mbështesin dialogun dhe veprimet e përbashkëta, që promovojnë lirinë e fesë dhe besimit.

METODOLOGJIA

Ky udhëzues është produkt i konsultimeve të gjera *online* dhe *offline* me ekspertë nga i gjithë rajoni i OSBE-së, duke përfshirë këtu përfaqësues të komuniteteve fetare dhe besimeve të ndryshme, profesionistë të fushës dhe akademikë. Gjithashtu, ODIHR-i ka zhvilluar edhe një anketë në shtetet pjesëmarrëse mbi mënyrat e ndryshme me të cilat ata kanë mbështetur ose kanë lehtësuar nismat për dialog në promovimin e lirisë së fesë dhe të besimit përtej kufijve të fesë dhe të besimeve të ndryshme. Pyetjet e kësaj ankete dhe një përmbledhje të gjetjeve të saj mund të gjenden në [Shtojcën 2](#) dhe [Shtojcën 3](#). ODIHR-i u konsultua edhe me [Panelin e tij të Ekspertëve për Lirinë e Fesë ose Besimit](#), një organ prej 16 ekspertësh të pavarur, që të gjithë nga rajoni i OSBE-së.


Ky udhëzues bazohet te rekomandimet e dhëna tek [Liria e Fesë dhe Besimit dhe Siguria: Udhëzimet e ODIHR-it 2019](#)¹⁰ dhe raporti i vitit 2018 mbi [Strategjitë e angazhimit ndërfaqësor](#)¹¹ mbështetur nga ODIHR-i dhe Kryesia italiane e OSBE-së. Ai përmban edhe disa mësim të nxjerra nga [Takimet Pasuese të Dimensionit Njerëzor të OSBE-së](#),¹² të cilat u kanë dhënë shteteve pjesëmarrëse mundësinë për të bërë një bilanc të zbatimit të angazhimeve të tyre për dialog dhe veprim të përbashkët përtej kufijve të feve dhe besimeve të ndryshme.

ODIHR-i arriti pjesëmarrje të barabartë të grave dhe të burrave në procesin e konsultimit, si dhe pjesëmarrje të barabartë të përfaqësuesve të brezave të ndryshëm. Ky udhëzues është produkt i një procesi, që edhe vetë ka përfituar nga dialogu përtej kufijve fetarë dhe besimeve të ndryshme, duke reflektuar në thelb nga njëra anë rëndësinë e respektimit të së drejtës të secilit për të shprehur lirisht mendimet dhe këndvështrimet e veta dhe nga ana tjetër, duke krijuar një dialog kuptimplotë dhe pasurues, që vendos lidhje dhe ndërton ura.



KAPITULLI 2

LIRIA E MENDIMIT, NDËRGJEGJES, FESË DHE BESIMIT



“ Është jetësore të
garantohet që secili të
ketë të drejtën e LFB-
së.”



KAPITULLI 2

LIRIA E MENDIMIT, NDËRGJEGJES, FESË OSE BESIMIT

Liria e mendimit, ndërgjegjes, fesë ose besimit (në vijim e përdorur edhe në forma të shkurtuara si “liria fetare”, “liria e besimit” ose “liria e fesë ose besimit” ose LFB) është një e drejtë themelore dhe universale e njeriut. Ajo garantohet nga nenet 18 të DUDNJ-së dhe KNDCP-së, si dhe nga instrumente të ndryshme rajonale për të drejtat e njeriut dhe është pjesë e një sërë angazhimesh të OSBE-së. Një përmbledhje e hollësishme e objektit të së drejtës për liri mendimi, liri ndërgjegjeje, liri fetare ose liri besimi jepet në publikimin e ODIHR-it *Liria e Fesë dhe Besimit dhe Siguria: Udhëzime për politika.*



“Çdo njeri ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë. Kjo e drejtë përfshin lirinë e personit për të pasur ose për të përqaftuar një fe ose një besim sipas zgjedhjes së tij, si dhe lirinë, individualisht ose bashkë me persona të tjerë, publikisht ose privatisht, për ta shfaqur fenë ose besimin e tij përmes adhurimit, respektimit, praktikimit dhe duke ua mësuar atë të tjerëve.”

Neni 18 (1) i KNDCP-së

Është e rëndësishme të dimë se:

- **LFB-ja është një liri që u përket të gjithëve.** Gjithkush e ka një lloj të drejtën e lirisë së fesë ose të besimit, pavarësisht nëse është qytetar vendas, shtetas i huaj, i burgosur, refugjat, emigrant, apo person pa shtetësi. Për ta ushtruar lirisht këtë të drejtë të njeriut nuk nevojitet asnjë leje nga shteti, nga komunitetet fetare, apo besimeve të ndryshme dhe nga askush tjetër.
- **LFB-ja mbron aftësinë e çdo personi për të menduar dhe për të vendosur se çfarë qëndrimi duhet të mbajë për të gjitha çështjet, si dhe për të pasur (ose për të mos pasur) një bindje, apo një përkushtim personal ndaj një feje, apo një besimi.**
- **LFB-ja mbron lirinë e çdo personi për të zgjedhur vetë nëse do, apo jo që të ketë apo të mos ketë, të përqafojë apo të ndryshojë fe apo besim pa u shtrënguar nga askush.** Kjo nuk do të thotë se çdo njeri është i detyruar të bëjë një zgjedhje, apo që disa të tjerë të mos e ushtrjnë dot aftësinë e tyre për të zgjedhur.

- **LFB-ja mbron veprimet e motivuara nga feja ose besimi, që lidhen me adhurimin, respektimin, praktikimin, mësimdhënien¹³, bërjen të ditur publikisht të fesë së dikujt dhe dhënien publikisht të informacioneve në lidhje me fenë ose besimin e dikujt, si dhe të mbajturit e fesë ose të besimit për vete. Prandaj, ajo lidhet ngushtë me të drejtat e lirisë së shprehjes, të drejtën për organizim dhe me të drejtën për privatësi. Gjithashtu, liria e fesë ose e besimit mbron, ndër të tjera, ritualet dhe ceremonitë, zakonet dhe praktikat e bazuara në bindje, si ndjekjen e dietave të caktuara dhe kufizimeve të tyre, zgjedhjen për t'u veshur me veshje të veçanta apo për t'u mbuluar, shfaqjen e simboleve, festat fetare dhe ditët e pushimit.**
- **LFB-ja mbron praktikimin e përbashkët ose aftësinë e dy ose më shumë personave për të praktikuar së bashku një fe apo një besim, publikisht (qoftë në mënyrë të organizuar, qoftë sporadike) ose privatisht, nëse ata dëshirojnë ta bëjnë këtë. Liria e fesë ose besimit është një e drejtë e njeriut, që i përket çdo individ, por për sa kohë që individët bëhen bashkë për ta manifestuar fenë ose besimin e tyre, ajo është edhe një e drejtë kolektive.**
- **LFB-ja mbron autonominë e brendshme të komuniteteve fetare ose të komuniteteve të besimeve të ndryshme dhe është pjesë përbërëse e mënyrës se si i trajtojnë çështjet e tyre kryesore komunitetet fetare ose ato të besimeve të ndryshme, p.sh., e drejta për t'u vetorganizuar; liria për të zgjedhur udhëheqësit dhe mësuesit e fesë, apo besimit të tyre; liria për t'u regjistruar si person juridik, institucion bamirësie, institucion fetar apo arsimor; si dhe liria për të përgatitur dhe për të shpërndarë tekste ose botime fetare. Liria e fesë ose besimit mbron edhe të drejtën për të kërkuar dhe për të marrë kontribute financiare vullnetare, duke u mundësuar kështu komuniteteve të feve ose të atyre të besimeve të ndryshme, t'i manifestojnë këto të drejta në mënyrë të pavarur.¹⁴**
- **LFB-ja është pjesë e pandashme e mosdiskriminimit. Të gjitha qeniet njerëzore kanë të drejtë të gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre themelore njerëzore pa u diskriminuar për shkak të karakteristikave të identitetit të tyre, që mbrohen me ligj. Të drejtat nuk mund të shkelen për shkak të moshës sonë reale, apo moshës sonë të perceptuar dhe as, ndër të tjera, për shkak të 'racës'¹⁵ ose të përkatësisë etnike, gjinisë, gjuhës, statusit të aftësisë së kufizuar apo opinionit politik.¹⁶**

Liria e fesë dhe e besimit na e bën të gjithëve të mundur që shprehemi se kush jemi në të vërtetë, pa frikën e diskriminimit. Për të krijuar një shoqëri pa diskriminim, është jetike të sigurohemi që secili të ketë të drejtën e lirisë së fesë ose të besimit. Kjo vlen veçanërisht për komunitetet që përballen rregullisht me marxhinalizim, armiqësi ose dhunë.

2.1. KUFIZIMET E LIRISË SË FESË OSE BESIMIT

Çdo shtet ka detyrimin e respektimit, mbrojtjes dhe përmbushjes së aftësisë së çdo personi për të ushtruar lirinë e fesë ose besimit. Megjithatë, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, shumica e të drejtave të njeriut mund të kufizohen, por vetëm në kushte shumë strikte. Liria e mendimit, ndërgjegjes, fesë ose besimit përbëhet nga dy njësi: forumin e brendshëm dhe forumin e jashtëm.

- **Forumi i brendshëm**

Njësia përbërëse e brendshme, që lidhet me mendimet, bindjet dhe besimet tona. Procesi i të menduarit të njeriut, të përshtaturit ose të ndryshuarit e ndërgjegjes, apo besimeve tona të brendshme nuk mund të kufizohet nga askush dhe për asnjë arsye. Kjo "mbrohet në mënyrë absolute" nga e drejta ndërkombëtare. Kjo do të thotë se ato nuk mund të kufizohen kurrë për asnjë lloj arsyeje. Për shembull, një shtet nuk mund ta detyrojë dikë me ligj të ndryshojë fenë/besimin, apo ta ndëshkojë atë për mendimet e tij.

- **Forumi i jashtëm**

Njësia përbërëse e jashtme, që ka të bëjë me mënyrën se si ne i shfaqim mendimet, bindjet dhe besimet tona mes veprimeve që kryejmë. Liria për të manifestuar ose praktikuar fenë ose besimin mund të kufizohet në rrethana të caktuara. Kjo liri nuk gëzon të njëjtën mbrojtje absolute. Në rrethana rreptësisht të kufizuara, mund të kufizohet praktikimi i dukshëm i fesë ose besimit. Neni 18 i KNDKP-së, i cili zbatohet për të gjitha shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, parashikon që manifestimet e dukshme të lirisë së fesë ose të besimit të mund të kufizohen vetëm për arsye shumë të ngushta dhe sipas procedurave të rrepta. Barra e arsyetimit të çdo kufizimi bie mbi shtetin.

Në grafikun në faqen vijuese ilustrohen arsyet dhe procedura, që duhet të ndiqet për çdo kufizim të ligjshëm sipas nenit 18.

2.2. SHKAQET E KUFIZIMEVE


Pesë arsyet e kufizimit janë 'siguria publike', 'rendi publik', 'shëndeti publik', 'moral i publik' ose 'të drejtat dhe liritë themelore të personave të tjerë' dhe ato janë shteruese. Siguria kombëtare nuk përbën një justifikim të vlefshëm për kufizimin e manifestimeve të lirisë së fesë ose besimit. Edhe kur siguria publike paraqitet si shkak i kufizimit, ajo duhet të interpretohet ngushtë, siç duhet të interpretohet secili nga katër kriteret e tjera. Për shembull, një kufizim i bazuar në 'moral' nuk mund të rrjedhë vetëm nga një traditë e caktuar. Një emergjencë publike, që kërcënon jetën e kombit nuk mund të jetë përligjje, që shteti të shkelë lirinë e fesë ose të besimit, sepse, sipas KNDKP-së, liria e fesë ose besimit është një

e drejtë e patjetërsueshme (si e drejta për jetën ose liria për të mos iu nënshtruar asnjë torture). Edhe në kohë krizash publike, liria e fesë ose besimit mund të kufizohet vetëm për pesë arsye të renditura më sipër.

Shteti duhet ta arsyetojë kufizimin, të vendosë masat e përshtatshme mbrojtëse dhe të sigurojë mjete juridike të frytshme kundër abuzimit në zbatimin e atij kufizimi, duke përfshirë çdo abuzim që nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.¹⁷



A është i ligjshëm një kufizim i caktuar i lirisë së fesë ose besimit?¹⁸



Një kufizim është i paligjshëm nëse ai synon të pengojë ushtrimin e arsyeshëm të lirisë së fesë, besimit ose të të drejtave të tjera, nëse krijon një sistem ku ushtrimi i asaj të drejte përbën një përjashtim dhe jo rregullin, ose nëse për atë kufizim nuk jepet asnjë argumentim objektiv, apo i arsyeshëm.¹⁹



“... çdo kufizim dhe të gjitha kufizimet duhet të jenë përjashtime, jo rregulli. Përveç kësaj, barra e arsytimit të kufizimeve të tilla bie mbi ata që dëshirojnë t'i imponojnë ato, që janë shpesh qeveritë ose organet shtetërore (...) kufizimet duhet gjithashtu (...) të jenë masa më pak kufizuese nga të gjitha masat e përshatshme, që mund të ndërmerren dhe duhet, që në çdo rast, të mos cenojnë vetë të drejtën.”

Prof. Ahmed Shaheed, ish-Raportues i Posaçëm i Kombeve të Bashkuara për Lirinë e Fesë dhe Besimit²⁰

Diagrami i mëposhtëm paraqet disa nga mënyrat në të cilat shtetet e kufizojnë lirinë e fesë ose besimit përtej asaj që është e nevojshme ose në përpjestim ose tërthorazi diskriminojnë grupe të caktuara, që u përkasin feve ose besimeve të ndryshme, duke minuar kështu edhe dialogun dhe veprimin e përbashkët.



Shembuj kufizimesh joproporcionale ose diskriminuese nga shtetet ndaj LFB-së

NDALIMI i shpërndarjes së literaturës fetare	NDALIMI i veshjes së simboleve/rrobave fetare	Dhënia e pozitive PRIVILEGJUESE feve të njohura nga shteti	NDALIMI i veprimtarive misionare
Ligje KUFIZUESE dhe rënduese ndaj regjistrimit të feve të ndryshme	PENGESAT ndaj thithjes së fondeve vendase ose ndërkombëtare për veprimtari të feve ose besimeve të ndryshme	Ligjet e BLASFEMISË/ APOSTAZISË	Ligjet lidhur me terrorizmin ose SIGURINË KOMBËTARE , që prekin në mënyrë të shpërpjestuar komunitetet fetare ose të besimeve të ndryshme

KAPITULLI 3

DIALOGU DHE VEPRIMET E PËRBASHKËTA PËRTEJ KUFIJVE TË BESIMEVE TË NDRYSHME FETARE


“ Dialogu ofron mundësi unike për partneritete veprimesh të përbashkëta, që mbrojnë dhe zbatojnë të drejtat e njeriut. ”



KAPITULLI 3

DIALOGU DHE VEPRIMET E PËRBASHKËTA PËRTEJ KUFIJVE TË BESIMEVE TË NDRYSHME FETARE

Në të gjithë OSBE-në ekzistojnë terma të ndryshme për të përshkruar dialogun dhe veprimin e përbashkët përtej kufijve të fesë ose të besimit. Termi i saktë që përdoret, si dhe struktura dhe aktorët që marrin pjesë në një dialog, varen nga qëllimi, konteksti dhe rezultatet e dëshiruara, si dhe nga traditat teologjike, historia, konteksti social-kulturor dhe bindjet filozofike. Gjithashtu, në gjuhë të ndryshme u mëshohet aspekteve të ndryshme të dialogut dhe përdoren terma pak a shumë gjithëpërfshirës.²¹



Dialogu dhe veprimi i përbashkët mund të adresojnë probleme konkrete ose të synojnë përmirësimin e të kuptuarit teologjik ose social të traditave të ndryshme dhe mund të kenë si pikësypnimit ose të angazhojnë aktorë të ndryshëm. Ajo që është e rëndësishme është që dialogu nuk ka për qëllim të përcaktojë se besimi i kujt është “më i vërtetë”, as edhe të konvertojë individët/grupe të caktuara në një sistem tjetër feje/besimi. Kjo nuk do të thotë që pjesëmarrësit nuk mund të tentohet të konvertohen, por nuk duhet të jetë ky qëllimi i procesit. Përveç kësaj, lehtësuesi i dialogut duhet të inkurajojë vendosjen e disa rregullave bazë (shih [Shtojcën 1](#)). Në këto rregulla duhet të përfshihet edhe marrëveshja mes pjesëmarrësve për të shmangur gjatë dialogut përpjekjet për konvertim.

Veprimet e përbashkëta mund të dalin nga një dialog formal, i strukturuar dhe i nivelit të lartë ose nga aktivitete joformale, spontane dhe *ad hoc* të nivelit bazë. Kur njerëzit me besime fetare dhe jofetare kanë takime joformale me mundësi për biseda të thella dhe për të ndërtuar marrëdhënie më të forta, mund të ndodhin transformime sociale. Dialogu jozyrtar nuk duhet të organizohet domosdoshmërisht në rrafshin e fesë, besimeve të ndryshme jofetare, apo në rrafshin etnik dhe kulturor. Ky dialog për shembull, mund të zhvillohet edhe në ambiente joformale, si në lagje, shkolla ose klube multikulturore dhe multifetare.

Dialogu mund të ndihmojë në zhvillimin dhe ndërmarrjen e nismave të vlefshme bashkëpunuese për adresimin e nevojave dhe sfidave praktike në të gjitha nivelet (nivel lokal, kombëtar, apo global), duke përfshirë edhe hartimin e politikave për çështjet e interesit të

përbashkët përmes një lenteje ndërkomunitare. Po kështu, edhe angazhimi ndërkomunitar mund të mos ketë fillimisht për qëllim krijimin e një dialogu mes feve të ndryshme, apo mes besimtarëve të së njëjtës fe, ose njerëzve të besimeve të ndryshme, por mund të shkojë drejt asaj rruge, duke u përqendruar në të njëjtën kohë të çështje të tjera me interes për të gjithë, si çështjet sociale/mjedisore. Siç vuri në dukje një pjesëmarrës në konsultimet e ODIHR-it, ky lloj angazhimi besimesh fetare “ka të bëjë me besime të ndryshme, vlera të njëjta dhe veprime të përbashkëta”; pra, me fjalë të tjera, do të thotë të zgjedhësh t’i adresosh nevojat që na bashkojnë, duke i ruajtur dallimet mes nesh, por pa i lënë këto dallime që të na përçajjnë.

LLOJET E DIALOGUT DHE TË AKTIVITETEVE TË PËRBASHKËTA

Dialogu mund të jetë qëllim në vetvete ose pjesë e një projekti më të gjerë, që përfshin veprime sociale, ose të përdoret për të adresuar një çështje me interes për anëtarët e një komuniteti. Aktivitetet e gjera, që zakonisht ofrohen nën ombrellën e ‘dialogut’ përfshijnë të feve ose besimeve, përfshijnë njohjen e ‘tjetrit’, ndryshimin e zemrave dhe mendjeve; mësimdhënien dhe mësimnxënien dhe ndërmjetësimin; si dhe punën për zgjidhjen e çështjeve me interes të përbashkët, por nuk kufizohen me kaq. Aktivitetet zakonisht përfshijnë:

- Mbledhjen së bashku të drejtuesve të feve ose të besimeve të ndryshme për të folur bashkërisht në mbrojtje të një çështjeje specifike;
- Të kuptuarin më të mirë të organeve/institucioneve të nivelit të lartë të feve ose besimeve të ndryshme të këtyre organeve/institucioneve, duke krijuar më shumë besim, respekt të ndërsjellë dhe marrëdhënie më të mira mes komuniteteve;
- Veprimet sociale në nivelet bazë të feve ose të besimeve të ndryshme, ku pjesëmarrësit me dallime fetare bashkohen për të promovuar dhe për t’u angazhuar në aktivitete ndërkomunitare për të sjellë ndryshime shoqërore (edhe përmes mjeteve krijuese, si sportet dhe artet);
- Proceset e arsytimit të shkrimeve hyjnore²²; rrënjësor në tekste të shenjta ose filozofike, të cilat thellojnë njohuritë e çështjeve të veçanta bashkëkohore nga një këndvështrim teologjik ose më i gjerë. (Aktivitete të tilla zakonisht udhëhiqen nga individë të mirëpërgatitur në përdorimin e këtyre qasjeve, që vijnë veçanërisht nga studime teologjike ose në drejtimin komunitar). Megjithatë ky udhëzues nuk merret me këtë lloj dialogu, ka nisma të tjera për nxitjen e veprimeve të përbashkëta, që i hyjnë analizës së procesit të arsytimit të shkrimeve të shenjta.²³



Praktikë e mirë: Korniza dhe metodologjia e “Besimit për të Drejtat” për veprime të përbashkëta përtej kufijve të feve dhe besimeve²⁴

Kuadri ‘Besimi për të Drejtat’ ofron një hapësirë për reflektim dhe veprim ndërdisiplinar mbi lidhjet e thella mes feve, besimeve dhe të drejtave të njeriut, të cilat mund ta pasurojnë njëra-tjetrën reciprokisht. Ky kuadër ka për qëllim të nxisë zhvillimin e shoqërive paqësore, që mbështesin dinjitetin njerëzor dhe barazinë për të gjithë dhe ku diversiteti, jo vetëm tolerohet, por respektohet dhe festohet plotësisht. Ky kuadër i mëshon nevojës që të gjithë besimtarët - teistë, joteistë, ateistë, apo njerëzit e besimeve të tjera - të punojnë bashkërisht për të gjetur mënyra, përmes të cilave “besimi” të mund të mbrojë si duhet “të drejtat” dhe ku, besimi dhe të drejtat bashkë, të mund të përmirësojnë njëri-tjetrin.

Deklarata e Bejrutit²⁵ thekson se “vetëm kur ne, si aktorë fetarë, të marrim përsipër rolet, që na takojnë, të shprehim një vizion të përbashkët mbi përgjegjësitë tona dhe nga predikimi të hidhemi në veprim, vetëm atëherë do të promovojmë në mënyrë të besueshme pranimin dhe vëllazërinë e ndërsjellë mes njerëzve të feve ose besimeve të ndryshme dhe do t’i fuqizojmë ata për të mposhtur shtysat negative të urrejtjes, ligësisë, manipulimit, lakmisë, mizorisë dhe formave të ngjashme çnjerëzore.”

Paketa e mjeteve #Faith4RightsToolkit²⁶ e përkthen këtë kuadër në programe praktike për rritje kapacitetesh dhe në platforma të mësuarit, të cilat përmbajnë module mësimore për secilin nga 18 angazhimet ndaj ‘Besimit për të Drejtat’.

Përveç paketës së mjeteve ‘Besimi për të Drejtat’, në internet ka edhe mjete të tjera:

- **Besimet dhe të Drejtat e Njeriut: Një Qasje ndaj “Besimit për të Drejtat”,** Akademia Globale Gandhi-King²⁷
- **Udhëzues për Trajnerët e Kurseve “Besimi për të Drejtat”,** Qendra Ndërkombëtare për Studime të së Drejtës dhe Fesë²⁸
- **Paketa e Trajnimit mbi Besimin për të Drejtat,** Akademia Faith4Rights²⁹



“Kuadri “Besimi për të Drejtat” që u krijua nga Zyra ime në vitin 2017 angazhon qeveritë, autoritetet fetare dhe një gamë të gjerë aktorësh të shoqërisë civile në shkëmbime mes kolegësh rreth përpjekjeve konkrete në terren. Për shembull, në Qipro, disa udhëheqës fetarë, që janë pjesë e praktikave të komunitetit “Besimi për të Drejtat” kanë kërkuar që njerëzit e të gjitha besimeve të mund të kenë qasje, pa u penguar, në vendet e tyre të adhurimit; ata gjithashtu kanë dënuar nxitjen e dhunës, diskriminimit ose të armiqësisë në emër të fesë.”³⁰

Volker Türk, Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut

Dialogu ofron mundësi unike për partneritete veprimesh të përbashkëta, që mbrojnë dhe zbatojnë të drejtat e njeriut.³¹ Jo çdo proces dialogu çon në veprime të përbashkëta. Për të pasur dialogë dhe partneritete kuptimplote, që kanë vërtetë ndikim, duhet të bëhen përpjekje të vetëdijshme për t'i kultivuar ato dhe për të krijuar një mjedis ku ato me kalimin e kohës të mund të zhvillohen më tej. Dialogu dhe partneriteti nuk janë procese lineare. Në disa raste, para se të kalojmë te dialogu mes feve të ndryshme dhe veprimeve të tyre të përbashkëta, mund të fillohet me diskutime, që zhvillohen brendapërbrenda së njëjtës fe për të dëgjuar pikëpamje të ndryshme dhe për të gjetur gjuhën e përbashkët brenda të njëjtit grup fetar ose të njëjtit besim. Aty ku shfaqen nisma të përbashkëta, disa mund të japin shumë shpejt rezultate pozitive, të tjerat mund të kërkojnë më shumë kohë.

Ja disa shembuj për të parë se çfarë mund të përfshijnë veprimet e përbashkëta lidhur me lirinë e fesë dhe të besimit:

Edukimi për paqen

- Edukimi në shkolla për të drejtat e njeriut, anti-diskriminimi dhe/ose besimet e ndryshme fetare
- Edukimi në lidhje me të drejtat e njeriut, anti-diskriminimin dhe/ose besimet e ndryshme fetare në formatet e arsimit për të rriturit
- Ndërgjegjësimi në lidhje me edukimin mbi besimet fetare, diversitetin dhe bashkëjetesën paqësore mes feve
- Seminare për shoqërinë civile, aktorë fetarë/besimtarë dhe aktorë shtetërorë

Aktivitetet e kohezionit social në ekipe ose në grupe të përziera

- Deklarata të përbashkëta publike
- Aktivitete të përbashkëta publike:
 - Aktivitete sportive
 - Aktivitete artistike
 - Aktivitete komuniteti p.sh., për të mbrojtur trashëgiminë kulturore, fetare ose për të luftuar krimin e urrejtjes

Ngritje rrjetesh bashkëpunimi

- Ngritja e strukturave të përbashkëta dhe formateve formale dhe joformale të shkëmbimit:
 - Platforma dialogu
 - Këshilla ndërfejarë
 - Komitete Këshillimore
 - Grupe interesi
 - Grupe avokuese për reformën e ligjit, apo politikave

KAPITULLI 4

ROLI I SHTETIT

“ Shtetet duhet të marrin masat, që të gjitha proceset që lidhen me projektet për dialog dhe veprime të përbashkëta të jenë transparente. ”



KAPITULLI 4

ROLI I SHTETIT

Shtetet kanë detyrimin kryesor për të respektuar, mbrojtur dhe përmbushur të drejtat e njeriut. Mbështetja e dialogut dhe veprimit të përbashkët përtej kufijve të feve ose besimeve është një mënyrë e frytshme për ta bërë këtë. Si lehtësues, shteti nuk duhet të organizojë vetë nismat e dialogut, apo të veprimit të përbashkët, por të krijojë mjedisin ku mund të lulëzojnë këto nisma, të organizuara nga aktorë të besuar, joshtetërorë, të cilët duhet ta bëjnë këtë punë në përputhje me të drejtat e njeriut.

Ky kapitull shqyrton se si shteti mund ta kryejë këtë rol mbështetës dhe mundësues. Ai trajton se si duhet të përkthehen instrumentet ligjore dhe angazhimet politikisht detyruese në politika, praktika dhe procese të efektshme ndryshimi për të ndikuar pozitivisht në jetën e përditshme të njerëzve. Në qendër të kësaj qasjeje të bazuar në të drejtat e njeriut janë parimet e Pjesëmarrjes, Përgjegjshmërisë, Mosdiskriminimit dhe Barazisë, Fuqizimit dhe Legalitetit (të njohura në anglisht si PANEL).



- **Pjesëmarrja** - çdokush, qoftë fetar apo jo, ka të drejtën e pjesëmarrjes aktive në proceset vendimmarrëse, që ndikojnë në gëzimin e të drejtave të tyre.
- **Llogaridhënia** – Shtetet kanë përgjegjësinë të përbushin detyrimet e tyre ndaj individëve që gëzojnë të drejta. Në rast të shkeljeve të të drejtave të njeriut, është e domosdoshme që shtetet të sigurojnë mjete juridike të efektshme.
- **Mosdiskriminimi dhe barazia** - të gjithë individët kanë të drejtë të gëzojnë të drejtat e tyre në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim.
- **Fuqizimi** - të gjithë mund të kuptojnë, të kërkojnë dhe të ushtrojnë të drejtat e tyre, duke marrë pjesë në zhvillimin e politikave, të cilat ndikojnë në jetën e tyre
- **Ligjshmëria** - qasjet duhet të jenë në përputhje me të drejtat ligjore të përcaktuara në ligjet vendase dhe ato ndërkombëtare.³²

Të theksosh se roli më i përshtatshëm për shtetin është ai i mbështetjes - në vend të nxitjes për dialog - nuk do të thotë se shteti, nëse ftohet, nuk mund të marrë pjesë në dialog dhe në nisma për veprime të përbashkëta. Në të vërtetë, disa komunitete mund t'i ftojnë shtetet të marrin pjesë si bashkëbisedues të vlefshëm, për të bërë pyetje ose për të kuptuar më mirë planet shtetërore për tema me interes. Megjithatë, në disa kontekste, mund të jetë e papërshtatshme që aktorët shtetërorë të flasin ose të marrin pjesë. Në disa vende, individë ose grupe të caktuara mund të kenë arsye të mos i besojnë shtetit, për shembull, për shkak të abuzimeve historike, paragjykimeve institucionale ose incidenteve të dhunshme, ku shteti nuk ka arritur t'i mbrojtë ata. E njëjta gjë vlen edhe kur shteti merr një rol tepër qendror, duke u përpjekur

të drejtojë dialogun ose veprimet e përbashkëta. Kjo mund të dëmtojë reputacionin e shtetit, si një ndërmjetës neutral dhe të dekurajojë angazhimin e vlefshëm të të tjerëve.

Kjo mund të ndodhë lehtësisht kur një shtet ka një fe ose besim zyrtar, ose kur trajton në mënyrë jozyrtare një fe ose besim në mënyrë preferenciale; Aktivitetet e dialogut të nisura nga shteti mund të perceptohen si përforsim i një pozicioni hegjemonist ndaj komuniteteve të tjera. Nëse ndodh kjo, nevojiten aktivitete për të rindërtuar besimin përpara se të rifillojë një dialog kuptimplotë.

Prandaj, në përgjithësi është më mirë, që shtetet të përqendrohen në ofrimin e mbështetjes, të krijojnë kushte, që inkurajojnë dialogun formal ose joformal dhe të mbështesin nismat, që çojnë në tolerancë, respekt dhe mirëkuptim më të madh midis komuniteteve. Këto kushte janë:

- Respektimi i të drejtave të njeriut në përgjithësi, dhe LFB-së në veçanti, brenda shoqërisë, si dhe kur angazhohen në dialog dhe veprime të përbashkëta përtej kufijve të feve ose besimeve;
- Shteti merr qasjen “mos bëj dëm”, kur angazhohet me aktorë fetarë dhe besimtarë dhe/ose mbështet veprimet e tyre të përbashkëta;
- Shteti vepron njëlloj ndaj aktorëve fetarë ose besimtarë;
- Merr masa për përfshirje dhe pjesëmarrje të plotë të feve dhe besimeve të ndryshme; dhe,
- Shteti vepron në mënyrë transparente dhe me përgjegjshmëri, kur angazhohet me fe dhe besime të ndryshme dhe/ose kur mbështet veprimet e tyre të përbashkëta.

Në seksionet e mëposhtme trajtohet secili prej këtyre kushteve me më shumë hollësi.

4.1. RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT

Respektimi i të drejtave të njeriut u mundëson të gjithëve të jetojnë një jetë dinjitoze. Aktorët e fesë dhe besimit, si dhe komunitetet më gjerësisht, do të kenë nivele më të larta besimi dhe angazhimi me shtetin nëse shteti ua respekton të drejtat dhe vepron qartësisht për mbrojtjen dhe promovimin e tyre. Është e rëndësishme, që shtetet të sigurojnë, që korniza legjislativë dhe veprimet e tyre të garantojnë në mënyrë efektive respektimin e detyrimeve të të drejtave të njeriut. Tregues të ndryshëm mund të saktësojnë nëse një shtet respekton, mbron dhe përmbush të drejtat e njeriut. Për shembull, ish-Raportuesi Special i Kombeve të Bashkuara për LFB-në, Ahmed Shaheed, propozon një kuadër tregues (joshterues) për të monitoruar dhe për të

promovuar zbatimin e të drejtave të njeriut në një kohë dhe kontekst të caktuar. Ai i ndan ato në tri kategori: strukturore (korniza ligjore dhe institucionale); procese (politikat, procedurat, praktikat, buxhetet dhe kapacitetet) dhe rezultatet/permanca (të dhëna për boshllëqet në gëzimin e një të drejte, për shkeljet ose për përmirësimet).³³

Brenda këtij kuadri, do të ishte e rëndësishme për komunitetet fetare ose besimtare që për shembull, legjislativi i brendshëm të njohë paragjykimet e bazuara në fe ose besim, si një rrethanë rënduese kur kryhet një krim (strukturor); që të ofrohet trajnim për agjencitë ligjzbatuese dhe gjyqësorin, se si t'i dallojnë dhe t'i hetojnë krime të tilla (proceset) dhe që periodikisht të mblidhen dhe të vlerësohen të dhëna të detajuara për veprime të mëtejshme në nivele të ndryshme të sistemit të drejtësisë mbi krimet e urrejtjes me motiv fenë/besimin, të cilat janë të rëndësishme për komunitete specifike (rezultati/permanca).

Tregues të tjerë mund të ofrojnë të dhëna veçanërisht për gëzimin e LFB-së dhe mund të jenë tregues sociologjikë, si distanca midis shumicës dhe grupeve të pakicave.³⁴ Përdorimi i treguesve të tillë i ndihmon shtetet të identifikojnë nëse kanë krijuar një mjedis të favorshëm dhe nëse ka boshllëqe, apo fusha që mund të kenë nevojë për ndryshim.

Në rastet kur shtetet krijojnë/përshtatin treguesit, ky proces duhet të përfshijë angazhimin dhe konsultimin me një gamë të gjerë palësh të interesuara përpara se të vendoset për një listë përfundimtare (por jo fleksibël) treguesish, e cila është kuptimplotë dhe e përshtatur me kontekstin.



Udhëzimet e ODIHR-it për rishikimin e legjislativitetit në lidhje me fenë ose besimin³⁵ mund të mbështesin shtetet në sigurimin e një kuadri strukturor të përshtatshëm për respektimin e LFB-së, me rekomandime se si shtetet mund të marrin masa, që legjislativi i tyre të jetë në përputhje me detyrimet e të drejtave të njeriut në lidhje me LFB-në.

Shtetet duhet të garantojnë që punonjësit shtetërorë të kenë edukim të mjaftueshëm mbi të drejtat e njeriut, me qëllim që të angazhohen me komunitetet fetare dhe besimtare për LFB-në në mënyra që janë në përputhje me të drejtat e njeriut. Institucioneve shtetërore mund t'u duhet të analizojnë kulturën e brendshme institucionale dhe boshllëqet në aftësi, në mënyrë që të modifikojnë strukturat e brendshme, proceset, sjelljet, shpërndarjen e burimeve dhe buxheteve.



Praktikë e mirë: Rruga Fetare drejt Paqes në Qipro

Rruga Fetare drejt Paqes në Qipro është një nismë, që nënvizon rolin konstruktiv të fesë, besimit dhe respektimit të të drejtave të njeriut në ndërtimin e paqes në një shoqëri të përçarë, ndër të tjera edhe përtej përkatësive fetare.³⁶ E lehtësuar nga Ambasada Suedeze, që nga viti 2009 pas një marrëveshjeje paqeje të dështuar që kishte mundësuar OKB-ja, Suedia ofroi “zyrat e mira” të përfaqësimit të saj diplomatik për dialogun midis përkatësive të ndryshme të krishtera dhe myslimane. Shtypsa për temat e diskutimit vjen nga pjesëmarrësit.

Rruga Fetare ndjek një qasje me katër shtylla për ndërtimin e paqes: i) promovimin e ndërgjegjësimit dhe besimit midis udhëheqësve fetarë dhe komuniteteve, ii) promovimin e veprimeve të përbashkëta dhe masave të ndërtimit të besimit, iii) mbrojtjen e të drejtës së secilit për të shfaqur publikisht fenë e vet dhe iv) mbrojtjen e vendeve dhe monumenteve me rëndësi fetare në Qipro. Shkeljet e LFB-së me të cilat përballet secili komunitet në ishull pranohen dhe adresohen kolektivisht nga të gjithë. Rruga Fetare është përqendruar fort në të drejtat e grave, të drejtat e emigrantëve dhe të refugjatëve, si dhe në çështje të tjera ndërsektoriale, që përjetohen ndryshe në bazë të fesë.

Rruga Fetare synon rezultate praktike. Udhëheqësit fetarë që kanë marrë pjesë në këtë nismë, kanë bashkëpunuar për riparimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të kultit, kanë lehtësuar pelegrinazhet përmes “linjës së gjelbër” të ishullit të ndarë që administrohet nga OKB-ja, si dhe kanë nxjerrë shumë deklarata të përbashkëta mbi çështje si, dhuna ndaj grave dhe vajzave, terrorizmi, si dhe bisedimet për paqe nën spektrin e të drejtave të njeriut.³⁷



Praktikë e mirë: Rrjeti Ekumenik Nordik për Lirinë e Fesë dhe të Besimit (NORFORB)

NORFORB është një rrjet organizatash kishtare, OJQ-ve me bazë besimi dhe agjencive të zhvillimit ekumenik nga vendet nordike, të cilat në punën e tyre ndjekin qasjen e bazuar tek të drejtat e njeriut. Ky rrjet ndërftuar filloi në vitin 2014, pasi anëtarët u përpoqën të gjenin një bazë të përbashkët për të zhvilluar mbështetjen e LFB-së dhe për të ndërmarrë nisma të përbashkëta. Megjithatë, pjesëmarrësit vunë re, që u duhej vazhdimisht të shpjegonin çfarë përfaqëson LFB-ja dhe se si duhet të integrohet ajo në vlerësimet e ndikimit. Organizatat e NORFORB-it e kuptuan se nuk ekzistonte asnjë material trajnimi praktik i mundshëm për t’u përdorur publikisht mbi LFB-në dhe as se si duhej të zbatohet ai në praktikë. Për të adresuar këtë boshllëk, në gusht 2018, tre anëtarë të NORFORB-it, Aleanca Ndërkombëtare Stefanus, Këshilli i Misionit Suedez dhe Qendra për Zhvillim me bazë Kishën, krijuan Platformën e të Mësuarit të LFB-së.

Për shumë vite, NORFORB është angazhuar me studiues dhe ekspertë ndërkombëtarë, komunitete teiste, joteiste dhe ateiste, aktorë të shoqërisë civile dhe udhëheqës vendorë, për të krijuar kurse trajnimi online dhe hibride mbi tema të tilla si: LFB-ja; LFB-ja dhe barazia gjinore; si dhe praktikatat më të mira pedagogjike për trajnimin mbi LFB-në. NORFORB merr masat, që pjesëmarrësit (25 për kurs) të përfaqësojnë prejardhje të ndryshme fesh dhe besimesh, si dhe të diversitetit gjeografik. Kurset zhvillohen në tre kontinente dhe përherë ka më shumë kërkesa sesa pranime. NORFORB zhvillon gjithnjë e më shumë trajnime edhe për zyrtarët shtetërorë, mbi të drejtën për LFB-në.

4.1.1. Liria e shprehjes dhe LFB-ja

Dialogu ndërmjet komuniteteve fetare ose besimit mund të ndodhë vetëm kur liria e shprehjes dhe LFB-së janë tashmë të respektuara. Kur shikohet përmes optikës së shprehjes, LFB-ja u jep aktorëve fetarë ose besimtarë, zgjedhjen për të marrë pjesë ose për të abstenuar nga dialogu ose diskutimet me aktorë të tjerë pa ndonjë pasojë negative.

Dialogu efektiv duhet të lejojë pjesëmarrësit të flasin hapur dhe sinqerisht, por me respekt. Pa këtë, mund të jetë e vështirë, që mirëkuptimi i ndërsjellë, të mësuarit dhe rritja të zënë rrënjë. Që një dialog të arrijë përtej kufijve ose të adresojë çështje të diskutueshme, duhet të pranohet diversiteti i opinioneve. Gjatë një dialogu, mund të ketë aq mendime sa ka njerëz të pranishëm. Opinioneve edhe brenda një komuniteti mund të ndryshojnë, dhe disa mund të kenë pikëpamje, që janë joliberales ose në kundërshtim të drejtpërdrejtë me të tjerët të pranishëm. Për të ruajtur dialogun e vërtetë, çdo pjesëmarrës duhet të ketë të drejtën e tij për të folur lirisht. Kjo mund të përfshijë gjëra që “fyejnë, tronditin ose shqetësojnë”, siç mbrohen nga nenet 18 dhe 19 të KNDCP, në vend që ta reduktojnë dialogun në një shkëmbim ndërkulturor të kënaqësive mbi “çajin dhe samosën”.³⁸ Kur sigurojnë fonde për nismat e dialogut, shtetet nuk duhet të presin, që pjesëmarrësit të ndryshojnë parimet e tyre fetare ose besimin për të përmbushur qëllimet shtetërore ose qëllimet e atyre që organizojnë dialogun.

Në përgjithësi, shtetet duhet të jenë vigjilente kur të shprehurit përçon urrejtje që rezultojnë në dëm të pakicave të feve apo të besimeve ose të zërave kundërshtues brenda komuniteteve të shumicës.³⁹ Ligjërimi i urrejtjes, qoftë në kontekste formale, joformale, politike apo sociale, mund të çojë në përjashtime. Prandaj, edhe kur një sanksion ligjor nuk do të garantohej sipas ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, shtetet duhet të adresojnë dhe të reagojnë ndaj çdo shprehjeje të urrejtjes dhe të inkurajojnë veprime, që çojnë në mirëkuptim dhe më shumë gjithëpërfshirje, si online, ashtu edhe offline.⁴⁰ Siç përshkruhet nga Raportuesi Special i Kombeve të Bashkuara për LFB-në në

një raport të vitit 2024, “nismat e mbështetura nga shteti duhet të synojnë inkurajimin e dialogut dhe adresimin e rrënjëve psikologjike të paragjyqimeve ndërmjet komuniteteve në nivelin bazë dhe duhet të fuqizohen për të kryer aktivitetet e tyre në vazhdimësi dhe jo vetëm në kohërat e rritjes së dhunës”⁴¹.

Përveç dialogut, shtetet duhet të trajtojnë në mënyrë parandaluese dhe proaktive përhapjen e “gjuhës së urrejtjes”.

Së pari, jo të gjitha llojet e shprehjeve fyese, duhet të parashikohen si vepër penale. Përveç kësaj, shtetet duhet të shohin standardet ndërkombëtare të parashikuara në Planin e Veprimit të Rabatit, i cili përcakton testin e pragut të nxitjes së urrejtjes (shih më poshtë). Megjithatë, shprehjet që bëjnë propagandë për luftë, apo urrejtje kombëtare, raciale apo fetare, që çojnë në nxitjen e diskriminimit, armiqësisë apo të dhunës, duhet të ndalohen me ligj. Shtetet duhet të garantojnë zbatimin e duhur të legjislacionit në rastet kur shfaqen këto mënyra të shprehuri, si edhe mbrojtjen e duhur të viktimave. Duke marrë parasysh mbrojtjen e viktimës, shtetet duhet të komunikojnë në përgjithësi çdo sanksion ligjor ndaj fajtorëve.



Plani i Veprimit i Rabatit

Plani i Veprimit i Rabatit⁴² mbledhi së bashku studiues, avokatë, praktikues fetarë, OJQ laike dhe me bazë besimi, ndër të tjera për të shtjelluar disa masa ndaj urrejtjes për shkak të kombësisë, racës ose fesë, duke pasur për bazë të drejtat e njeriut. Deri më sot, “testi i pragut prej 6 pikash” mbetet një nga masat më autoritare, kur gjuha e urrejtjes mund të kufizohet sipas të Drejtës Ndërkombëtare për Të Drejtat e Njeriut.

Teksti i pragut 6-pikësh

KONTEKSTI i deklaratës	Pozita ose statusi i FOLËSIT	SYNIMI për të nxitur audiencën kundër një grupi të caktuar
PËRMBAJTJA dhe forma e deklaratës	SHKALLA e përhapjes	GJASAT e dëmit, përfshirë kërcënimin e atypëratyshëm

Rekomandimi i Këshillit të Evropës i vitit 2022 për luftën kundër gjuhës së urrejtjes⁴³ përshkruan gjithashtu një qasje gjithëpërfshirëse ndaj trajtimit të gjuhës së urrejtjes brenda kornizës së të drejtave të njeriut. Shtetet duhet të mbështesin fushatat ndërgjegjësuese për të edukuar publikun dhe për të promovuar aftësitë e të menduarit kritik, mediat, informacionin dhe shkrim-leximin dixhital në të gjithë sistemet arsimore.⁴⁴ Ato gjithashtu duhet të edukojnë përdoruesit e mediave sociale për dëmet e ngacmimit dhe abuzimit online, duke përfshirë edhe ndikimet psikologjike dhe efektet frikësuese në grupet e synuara ose të marxhinalizuara (në këtë rast, zërat që vijnë nga fe dhe besime të ndryshme). Shtetet duhet gjithashtu të rregullojnë në mënyrë efikase ndërmjetësuesit online dhe kompanitë e mediave sociale, për çështje që variojnë nga dizajni dhe zhvillimi i modeleve algoritmike deri te ndreqja e gabimeve dhe mjetet juridike efikase për ata që dëmtohen.⁴⁵ Në varësi të kontekstit, kjo mund të sjellë zbatimin e detyruar të Aktit për Shërbime Dixhitale të BE-së në nivel kombëtar.⁴⁶ Për më shumë informacion mbi këtë temë, ju lutemi konsultohuni me manualin e politikave të Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias “Prozhektorët mbi Inteligjencën Artificiale dhe Lirinë e Shprehjes”.⁴⁷

4.1.2. Liria e organizimit dhe LFB-ja

Të drejtat për t’u organizuar dhe për të ushtruar LFB-në bashkërisht me të tjerët duhet të garantohen nëse komunitetet e feve ose të besimeve mbledhen dhe fillojnë të flasin. Sipas Ligjit Ndërkombëtar të të Drejtave të Njeriut, shtetet nuk mund të refuzojnë t’i akordojnë statusin e personit juridik një shoqate individësh të bazuar në fe ose në besim, përveçse nëse vërtetohet se ajo shoqatë është e përfshirë në aktivitete të paligjshme.⁴⁸ Si rregull, askush nuk duhet të penalizohet për shoqërimin me njerëz ose bashkësi fetare, që një shtet nuk i njej zyrtarisht. Shtetet duhet gjithashtu të marrin masa, që ligjet të mos kufizojnë aftësinë e komuniteteve fetare ose të besimeve për t’u mbledhur dhe as t’ua vështirësojnë këtë, duke ua bërë të detyrueshme me ligj që të regjistrohen. Për më tepër, për ata që dëshirojnë të marrin pjesë në konsultime ose dialogë, pjesëmarrja nuk duhet të varet nga kritere të tilla, si a është regjistruar ai grup zyrtarisht dhe a ka një numër të caktuar ndjekësish⁴⁹. Shih *Udhëzimet e ODIHR-it mbi Personalitetin Ligjor të Komuniteteve të Feve dhe Besimeve* për rekomandime specifike.

LFB-ja u garanton organizatave fetare aftësinë për të krijuar institucione bamirësie dhe për të kërkuar fonde. Siç nënvizohet në *Udhëzimet e ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias për Lirinë e Organizimit*, shoqatat duhet të kenë lirinë të kërkojnë, të marrin dhe të përdorin burime financiare dhe burime të tjera, qofshin ato vendase, të huaja apo ndërkombëtare, për ndjekjen e aktiviteteve të tyre, e cila është thelbësore për ekzistencën dhe funksionimin e çdo shoqate dhe pjesë integrale e së drejtës për lirinë e organizimit.⁵⁰ Kjo liri [për të kërkuar,

marrë dhe përdorur burime financiare dhe të tjera], duhet t'i nënshtrohet vetëm kërkesave të bazuara në ligj dhe që janë të nevojshme, proporcionale dhe jodiskriminuese dhe përgjithësisht të zbatueshme për doganat, këmbimet valutore, parandalimin e korrupsionit, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe për ato që kanë të bëjnë me financimin e zgjedhjeve dhe të partive politike, për aq sa këto kërkesa janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Çdo kufizim për aksesin në burime nga jashtë (ose në burime të huaja ose ndërkombëtare) duhet të përshkruhet me ligj, të ndjekë një qëllim legjitim në përputhje me bazat specifike të lejueshme të kufizimeve të përcaktuara në standardet përkatëse ndërkombëtare, si dhe të jetë i nevojshëm në një shoqëri demokratike dhe proporcionale me atë qëllim.⁵¹


Shtetet janë të detyruara të rregullojnë lëvizjet financiare të brendshme dhe ato ndërkombëtare për të garantuar sigurinë dhe për të luftuar korrupsionin. Në të vërtetë, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara ka vendosur disa detyrime mbi shtetet për të luftuar qarkullimet globale të financimit të lidhura me terrorizmin.⁵² Megjithatë, duket sikur kornizat legjislative shtetërore dhe përgjigjet e politikave zakonisht shkojnë përtej asaj çka kërkohet nga këto detyrime dhe organizatat e komuniteteve të feve ose të besimeve përballen shpesh me shkurtime të financimeve përmes proceseve jo të rregullta sa duhet ose për shkak të perceptimit të tyre pa fakte, si të lidhura me aktorë të ndaluar. Disa shtete kanë vënë detyrime shumë të rrepta për regjistrimin, raportimin e shoqatave, që marrin fonde të huaja me qëllim, sipas tyre, kufizimin e “influencës së huaj”.⁵³ Për të krijuar një mjedis të favorshëm për shfaqjen autentike të dialogut dhe të veprimit të përbashkët përtej



kufijve fetarë ose besimorë, shtetet nuk duhet të kufizojnë në mënyrë të padrejtë aksesin në financim për shoqërinë civile, duke përfshirë komunitetet fetare ose të besimit. Qasja në burime të ndryshme financimi - vendase dhe ndërkombëtare - është jetike për të lehtësuar ndërmarrjen e disa nismave, që garantojnë pavarësinë e tyre. Në të vërtetë, shumë grupe fetare ose besimi janë ndërkombëtare për nga shtrirja dhe komunitetet duan të dërgojnë para për të ndihmuar në aktivitetet e njëri-tjetrit, duke përfshirë, për shembull, aktivitetet bamirëse, që drejtohen nga homologët vendas në kohë nevojë.

4.1.3. Liria e tubimit paqësor dhe LFB-ja

Liria e tubimit paqësor u mundëson individëve të shprehen si pjesë e një kolektivi. Tubimet mund të veprojnë si platforma për të avokuar për ndryshim ose për të shprehur solidaritet. Nismat e përbashkëta të veprimit që dalin nga proceset e dialogut, ndonjëherë mund të bëjnë që komunitetet fetare ose komunitetet e besimeve të ndryshme të mblidhen përtej kufijve të fesë ose besimit, si tubime paqësore për një sërë qëllimesh të ndryshme. Si të tilla, asambletë variojnë nga grupe individësh që mblidhen në protestë për çështje me interes, deri te tubimet me rëndësi simbolike, për shembull, përkujtimi i ngjarjeve ose përkujtimi i datave të rëndësishme fetare ose të lidhura me besimin. Për sa kohë tubimet mbeten paqësore, është detyrë e shtetit t'i menaxhojë ato.⁵⁴ Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se shtetet nuk mund të ndërhyjnë në këtë të drejtë thjesht sepse nuk pajtohen me pikëpamjet e komuniteteve të feve ose të besimeve të pranishme. Ato duhet të marrin masa që e drejta për tubim paqësor të gëzohet në mënyrë të barabartë nga të gjitha grupet, pa diskriminim.



4.1.4. Mosdiskriminimi dhe LFB-ja

Në përputhje me parimet e të drejtave të njeriut, kur shtetet vendosin të trajtojnë sfidat e lidhura me LFB-në, ato duhet të përpiqen për përfshirje kuptimplotë dhe pjesëmarrje të barabartë të një game sa më të gjerë aktorësh në hartimin e aktiviteteve, që lidhen me dialogun e mundshëm dhe proceset e veprimit të përbashkët. Kjo përfshin njerëz nga grupe të marxhinalizuara historikisht ose të përjashtuar nga diskutime të tilla (gratë, LGBTI-të, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, komunitetet indigjene, emigrantët, refugjatët). Është e rëndësishme që individët nga komunitetet e feve ose të besimeve, qofshin teiste, joteiste apo ateiste, të mos përjashtohen aktivisht nga konsultimet për çështjet që i shqetësojnë dhe që shtetet të përpiqen të krijojnë hapësirë për ata që përballen me diskriminim.

Gjatë organizimit të konsultimeve, krijimit të komiteteve të përbashkëta këshillimore për një temë, ose përfshirjes në proceset e dialogut, shtetet duhet të marrin në konsideratë mënyrën se si krijohen konfliktet dhe tensionet sociale, si dhe ndikimin e mundshëm të diskriminimit strukturor dhe dhunës në komunitete të caktuara. Po kështu, duke pasur parasysh fuqinë e tyre të qenësishme në krahasim me aktorët e tjerë shoqërorë, shtetet duhet të jenë të ndjeshme kur hartojnë çështjet për diskutim, pasi kjo mund të çojë në çekuilibër të pushtetit midis aktorëve të ndryshëm, duke ndikuar në proceset e dialogut.

Shtetet gjithashtu duhet të jenë të vetëdijshme se konsultimet lidhur me LFB-në, komitetet e përbashkëta këshillimore ose dialogu që synon promovimin e të pasurit më shumë tolerancë, respekt dhe mirëkuptim janë të lidhura me mënyrën se si shtetet në përgjithësi krijojnë dhe reagojnë ndaj çështjeve që lidhen me intolerancën dhe diskriminimin, duke përfshirë edhe manifestimet e tyre strukturore dhe institucionale. Aktorët shtetërorë në të gjitha nivelet duhet të bëjnë sistematikisht deklaratat dhe të miratojnë politika që thyejnë stereotipet, paragjykimet dhe praktikat e rrënjësura dhe të shmangin fajësimin e një, apo disa komuniteteve të feve ose të besimeve si shkaktarët e sëmundjeve të ndryshme shoqërore. Përgjigjet publike diskriminuese rrezikojnë që komunitetet e shpallura si “fajtores” të shihen “automatikisht si të dyshuara”, gjë që mund të çojë në mosangazhimin më tej me këto komunitete, duke cenuar kohezionin shoqëror, duke i krijuar hapësirë gjuhës së urrejtjes, apo edhe të krimeve të urrejtjes. Në këtë atmosferë, aktorë të ndryshëm të feve apo besimeve mund ta perceptojnë me dyshim mbështetjen e shtetit për konsultime, komitete të përbashkëta këshillimore dhe dialog dhe të mos marrin pjesë në to; ata mund të kenë frikë nga pasojat e mundshme ose perceptimet negative nga komunitetet e veta.

Shtetet kanë edhe detyrimin ndërkombëtar që të përkufizojnë krimet e urrejtjes (veprat penale të motivuara nga paragjykimi⁵⁵), si një kategori e veçantë krimesh, në legjislacionin dhe politikat e tyre kombëtare.⁵⁶ Gjithashtu, shtetet duhet të trajtojnë në mënyrë proaktive krimin e urrejtjes si dhe format strukturore dhe të institucionalizuara të diskriminimit, duke ndërtuar një sistem gjithëpërfshirës, i cili kupton urrejtjen, krimin e urrejtjes dhe pasojat e rënda edhe tek individët dhe komunitetet, si dhe dëmin që i shkaktohet kohezionit shoqëror në tërësi. Shtetet duhet të monitorojnë fenomenin dhe të mbledhin të dhëna të hollësishme për krimet e urrejtjes edhe për shkak të fesë apo të besimit, si dhe të veprojnë bazuar në këto të dhëna për të garantuar siguri për të gjithë. Kjo nënkupton miratimin e një sërë politikash dhe procedurash, si: trajnimin e agjencive ligjzbatuese dhe të gjyqësorit; mbështetjen e viktimave për të pasur akses në drejtësi; fitimin e besimit të viktimave; luftimin e mosraportimit sa duhet; garantimin e shërbimeve të përshtatshme në mbështetje të viktimave; vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet palëve të interesuara për mbështetjen e viktimave;⁵⁷ si dhe komunikimin dhe bashkëpunimin e mirë me komunitetet e feve dhe të besimeve në çdo rast.

Shtetet duhet të konsultohen me komunitetet e feve dhe të besimeve, si dhe të pranojnë rolin që mund të luajnë në trajtimin e shqetësimeve të atyre komuniteteve për sigurinë brendapërbrenda tyre ose më tej. Ato duhet të krijojnë mundësi të cilat nxitin, por pa detyrim, përfshirjen proaktive të të gjitha komuniteteve në veprime të përbashkëta ndërfetare për t'iu kundërvënë gjuhës së urrejtjes dhe krimin të urrejtjes, si dhe për të garantuar siguri për të gjitha komunitetet.

Krimet e urrejtjes kanë ndikim negativ jo vetëm tek individ(ët) në fjalë, por edhe te komuniteti i shënjestruar, sepse mund të shkaktojnë një ndjesi gjithmonë e më të madhe izolimi nga shoqëria e gjerë; pjesëtarët e komunitetit mund të ngurrojnë të shfaqin fenë ose besimin e tyre publikisht, të përfshihen në diskutime publike për çështje që lidhen me identitetin e tyre, apo qoftë edhe të marrin pjesë në procese më të gjera demokratike. Shteti, shoqëria civile dhe komunitetet e feve dhe besimeve duhet, që përmes kanaleve të duhura, të adresojnë krimet e urrejtjes në mënyrë konstruktive dhe të promovojnë kohezionin e gjerë ndërkombëtar, por kur këto kanale mungojnë apo janë joefikase, atëherë ndjesia e pakënaqësisë dhe e zemërimit mund të shndërrohen në vektorë paqëndrueshmërie dhe pasigurie në të gjithë shoqërinë.



“ Antisemitizmi ka prekur prej kohësh komunitetet hebraike dhe manifestohet në mënyra të ndryshme, që nga teoritë e konspiracionit deri te diskursi jotolerant. Kjo mungesë tolerance mund të provokojë krime të urrejtjes, duke përfshirë sulme të dhunshme ndaj hebrenjve. Hebrenjtë ndonjëherë raportojnë se kanë frikë të ndjekin shërbesat e adhurimit, duke mbajtur veshjet apo simbolet fetare, prandaj ndodh që të mos e shfaqin publikisht faktin që janë hebrenj. ”⁵⁸



Praktikë e mirë, *Safe Haven*, Irlandë

Safe Haven (SH) është një program i përbashkët veprimi që drejtohet nga Forumi Ndërfetar i Dublinit (DCIF) dhe buron nga rritja e incidenteve të nxitura nga urrejtja, e konstatuar kjo nga vetë anëtarët e DCIF-së. *Safe Haven* trajnon pjesëtarë nga një spektër i larmishëm komunitetesh fetare që të kuptojnë qartë incidentet që kanë si motiv urrejtjen dhe të informohen mbi mekanizmat aktualë të regjistrimit dhe të denoncimit dhe si t'i mbështesin drejtpërdrejt viktimat. Programi përdor platformën denoncuese të Rrjetit Irlandez kundër Racizmit, por raporton drejtpërdrejt edhe te *An Garda Síochana* (Shërbimi Policor Irlandez) si palë e tretë, si edhe te mekanizmat regjistruar të vetë DCIF-së. Të dhënat shërbejnë për të pasur përgjigje lokale të mirinformuar dhe mbështetje të mëtejshme të viktimave. *Safe Heaven* trajnon edhe personelin e vijës së parë, si efektivët e policisë, ofrues shërbimesh dhe shoqërinë civile, se si ta dallojnë, ta njohin dhe të reagojnë ndaj racizmit dhe urrejtjes fetare. Programi u financua fillimisht nga Komisioni Irlandez për Të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë dhe tani funksionon me kapacitete më të kufizuara, me mbështetjen e DCIF-së.



Incidentet e motivuara prej urrejtjes, pavarësisht nëse kanë elementë penalë apo jo, kanë ndikim të fortë si te viktimat ashtu edhe te komunitetet me të cilat viktimat identifikohet. Duke qenë “krime që japin mesazh”, pjesëtarët e grupit të sulmuar shpesh reagojnë sikur të jenë sulmuar vetë ata. Kjo mund të dëmtojë marrëdhëniet e komunitetit dhe të krijojë tensione, gjë që i bën pakicat e tjera të ndihen të cenueshme. Përgjigjja e përshtatshme kërkon domosdoshmërisht një panoramë të qartë se çfarë përfaqësojmë dhe trajnim të duhur të policisë dhe të ofruesve të tjerë të shërbimeve. *Safe Haven* ka ndihmuar në të dyja këto aspekte.”

Adrian Cristea, zyrtar ekzekutiv, DCIF

Organizatave specifike të komunitetit mund të luajnë rol thelbësor, duke punuar ngushtë me organizata të ngjashme të komuniteteve të tjera, veçanërisht kur ekzistojnë kanale të mira komunikimi me strukturat shtetërore për diskutime të përbashkëta. Shembulli tipik vjen nga Mbretëria e Bashkuar, ku TellMAMA, organizatë që lufton urrejtjen ndaj myslimanëve bashkëpunon ngushtë me Community Security Trust i cili lufton antisemitizmin. Të dyja organizatat monitorojnë incidentet, e urrejtjes ndaj komuniteteve të tyre dhe kur ka përçarje (sidomos në kuadrin e situatës në Lindjen e Mesme), flasin së bashku me një zë dhe kjo jep një mesazh bashkimi.



Praktikë e mirë: TellMAMA dhe Community Security Trust (CST), Mbretëria e Bashkuar

Që nga viti 2012, organizata bamirëse TellMAMA mat, regjistron dhe analizon tendencat e incidenteve kundër myslimanëve në Mbretërinë e Bashkuar. TellMAMA ofron edhe këshillim për viktimat dhe aktivistët në forume kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtje më të mirë të viktimave, drejtësi dhe llogaridhënie për krimet e motivuara prej paragjykimeve ndaj myslimanëve. Ajo ka ndjekur modelin e një tjetër organizate bamirëse, Community Security Trust (CST) që është themeluar në vitin 1994 dhe kryen hulumtime mbi incidentet antisemite, ofron këshillim dhe mbështetje për komunitetin hebre në Mbretëri të Bashkuar dhe mbron e përkrah me qeverinë britanike në emër të tyre. Të dyja grupet marrin pjesë në nismat e dialogut të gjerë dhe të koalicioneve, përfshirë këtu Aleancën Komunitare për Luftën ndaj Urrejtjes (CATCH), e cila financohet nga bashkia e Londrës dhe përbëhet nga komunitete dhe organizata të ndryshme (raciale, fetare, orientimi seksual dhe identiteti gjinor) për adresimin e problemeve sociale.

TellMAMA dhe CST mbajnë dialog të rregullt, i cili fillimisht konsistonte në çështje metodologjike dhe administrative derisa TellMAMA hartoi një program pune. Sof, diskutimet përqendrohen në shqetësime praktike. Për shembull, CST rregullisht përcjell te TellMAMA incidentet e motivuara prej urrejtjes ndaj myslimanëve dhe anasjelltas. Ky dialog dhe bashkëpunim i ngushtë ka sjellë edhe një tjetër përfitim: megjithëse të dyja organizatat punojnë me metodologji të ngjashme dhe për të njëjtin qëllim, d.m.th. adresimin e incidenteve të nxitura prej urrejtjes fetare, ato mbajnë qëndrime konsistente dhe të njëjta në diskutimet me policinë, prokurorinë dhe strukturat e tjera shtetërore të Mbretërisë së Bashkuar. Për shkak të ekspertizës dhe legjitimitetit që buron nga mbështetja historike e komuniteteve, TellMAMA dhe CST kanë zhvilluar marrëdhënie me agjencitë ligjzbatuese dhe me prokurorinë, që u mundësojnë të dyja grupeve të funksionojnë më me efektivitet në adresimin e urrejtjes. Për shembull, personat që ngurrojnë të kallëzojnë incidentet në polici, mund t'i raportojnë ato pranë këtyre organizatave. Përmes shkëmbimit të statistikave të anonimizuara, TellMAMA dhe CST ndihmojnë që veprimi policor në Mbretërinë e Bashkuar të kryejë analiza të sakta dhe rrjedhimisht t'u përgjigjet problematikave shoqërore.

Megjithatë dialogu dhe bashkëpunimi mes CST dhe TellMAMA i ka rrënjët në konsideratat praktike dhe të përditshme me synime të përbashkëta, ndërveprimi i tyre vazhdon pavarësisht rrymave gjeopolitike që kërcënojnë dialogë të tjerë. Për shembull, që nga sulmet e Hamasit ndaj Izraelit më 7 tetor 2023 dhe konfliktit Izrael-Hamas që pasoi, shumë dialogë mes feve dhe besimeve u polarizuan, ndaluan ose rreshtën së ekzistuari. Komunikimi ndërmjet TellMAMA dhe CST jo vetëm që vazhdoi edhe pas 7 tetorit 2023, por u bë edhe më i fortë. Megjithëse incidentet antisemite dhe ato kundër myslimanëve shënuan rritje drastike në Mbretërinë e Bashkuar, asnjëra prej këtyre organizatave nuk mbajti qëndrime

publike në lidhje me ngjarjet e mëdha gjeopolitike. Të dyja raportojnë se kjo e ka bërë marrëdhënien e tyre më të fortë, duke ua rritur aftësinë për të adresuar urrejtjen dhe për t'u ofruar viktimave mbështetje psikosociale.

Përgjigjet e shteteve ndaj ngjarjeve të brendshme mund të prekin vijueshmërinë e dialogut dhe të veprimeve të përbashkëta. Për shembull, përdhosja publike e teksteve fetare mund të rezultojë në reagime të forta emocionale dhe/ose tensione shoqërore, të cilat e polarizojnë shoqërinë për shkaqe kulturore, feje apo besimi. Shteti e ka të vështirë të formulojë përgjigjen e duhur, sepse i duhet të vlerësojë nëse një akt përbën liri të shprehjes apo nxitje të urrejtjes.⁵⁹ Shtetet duhet të tregojnë kujdes që deklaratat publike dhe politikat të mos shkaktojnë dëme, të mos delegjitimojnë komunitete fetare apo besimtare, si dhe të mos adresojnë në mënyrë arbitrare apo të shpërpjestuar dëmet, apo shkeljet e të drejtave të grupeve të ndryshme.

Deklaratat publike duket të zbusin tensionet, edhe kur përgjigja juridike rezulton e papërshtatshme ose e pamundur. Ato duhet të mbajnë parasysh përjetimin unik të dëmeve që përjeton komuniteti fetar apo besimtar. Duke pranuar publikisht këto përjetime, shteti arrin të ulë tensionet, të luftojë perceptimet e distancimit apo të përjashtimit, si dhe të promovojë angazhimin konstruktiv ndërkomunitar.

Shteti duhet t'i kuptojë sfidat kryesore me të cilat përballen komunitetet e ndryshme, në mënyrë që t'i adresojë me përgjigjen e duhur. Këtu përfshihet shkelja e të drejtave të njeriut, ku shteti ka detyrimin të veprojë, edhe pse disa shkelje mund të jenë tabu brenda disa komuniteteve dhe rrjedhimisht më të vështira që të shmangen dhe të pranohen.



Intervistë: Shefja e Policisë, Jennifer Pearson

Jennifer Pearson është shefe e Policisë së Midlandit Perëndimor (Mbretëri e Bashkuar), si dhe kryetare e Forumit të Besimit dhe të Grave në Shërbimin Policor të Midlandit Perëndimor. Karrierën në polici e nisi si oficere kontakti për krimet në familje, si pjesë e një pakete të gjerë trajnimi për adresimin e racizmit brenda radhëve të policisë.

Në vitin 2021, Jennifer mori Medaljen e Policisë nga Mbretëresha, për punën e saj në mbështetje të të mbijetuarve të dhunës në familje dhe në bashkërendimin e përpjekjeve për të përballuar pandeminë COVID-19. Me përvojën 14-vjeçare të fituar në Tajlandë ku u atashua në mbështetje të rimëkëmbjes pas cunamit të vitit 2004, ajo udhëhoqi transformimin e një hangari avionësh në aeroportin e Birminghamit në një morg të përkohshëm. Ajo e kuptoi ndikimin që mund të kishte pandemia në praktikat dhe nevojat fetare në lidhje me varrimin. Prandaj,

u angazhua urgjentisht me të gjitha grupet fetare, krijoi kanale të hapura komunikimi, përfshiu në komunikim oficerë policie me prejardhje nga pakicat dhe diskutoi në mënyrë transparente mbi kushtet për ruajtjen e trupave të vdekur.

“Për shkak se kuptuam dhe u investuam në rëndësinë e besimit në një nga momentet më të vështira të jetës, ne fituam besimin e komuniteteve, i cili u ruajt edhe pas pandemisë.”

Në takimet ndërfaqetare në zyrën e kryetarit të bashkisë, që tashmë janë bërë të rregullta, marrin pjesë udhëheqës fetarë ose besimtarë zyrtarë dhe jozyrtarë, si dhe shoqata të ndryshme, ku diskutohet mbi çështje që prekin komunitetet në të gjithë Birmingamin. Në takimet ndërfaqetare, pjesëmarrësit diskutojnë edhe mbi ngjarje dhe konflikte ndërkombëtare nga këndvështrimi i identitetit fetar dhe se si ato ndikojnë në komunitetet e tyre vendore. Kjo vetëdije ndihmon në hetimin e krimeve të urrejtjes.

Si përfaqësuese e Grave në Shërbimin Policor, puna e saj ndërfaqetare rezultoi edhe në krijimin e të parit grup të pavarur këshillimor të vajzave për policinë, duke punuar dhe me vajzat e lindura nga martesat të detyruara. Edhe vetëdija se besimi është i rëndësishëm për vajzat ishte thelbësor për të fituar besimin e tyre dhe për t'i nxitur që të angazhoheshin.

“Ideja është të shohim se çfarë e motivon individin. Për sa kohë vlerat e tua kanë të bëjnë me barazinë, gjithëpërfshirjen dhe respektin, policia duhet të arrijë te këto vlera, të ndërtojë lidhjet dhe të kuptojë gjuhën e përbashkët”.

Shtetet duhet të ndjekin politika arsimore që synojnë të forcojnë respektin, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe luftën efektive ndaj hamendësimeve të bazuara në paragjykime dhe koncepteve të papajtueshme me LFB-në. Sistemet dhe programet arsimore u japin shteteve fuqi të konsiderueshme për të nxitur mirëkuptimin dhe respektimin më të madh të feve dhe të besimeve të ndryshme, si edhe vlerësimin pozitiv për pluralizimin dhe diversitetin e feve dhe të besimeve.



Parimet Udhëzuese të Toledos për Mësimdhënien rreth Feve dhe Besimeve në Shkollat Publike⁶⁰ të hartuara nga ODIHR-i, flasin për nevojën urgjente për të promovuar mbrojtjen dhe respektimin e LFB-së nëpërmjet arsimit, me qëllim që të forcohet paqja, mirëkuptimi dhe toleranca, si edhe që të zhvillohet respekti për pluralizimin.



Intervistë: Dr. Nayla Tabbara

Dr. Nayla Tabbara është bashkëthemeluese dhe kryetare e Fondacionit Adyan (Liban/Francë) dhe bashkëkryetare e shoqatës “Fetë për Paqen”. Përgjatë karrierës së saj kryesisht në Liban, Nayla ka punuar që të përfshijë diversitetin dhe pluralizmin në programet mësimore dhe të zhvillojë teologjinë islame mbi diversitetin fetar dhe LFB-në. Ajo është nderuar me shumë çmime në vlerësim të punës së saj.

Pse u angazhove në punën me dialogun dhe partneritetet shumëfetare dhe LFB-në?

“Njerëzit nuk e dinë instinktivisht si të trajtojnë diversitetin në mënyrë pozitive. Shumica prej nesh nuk janë të vetëdijshëm se si identiteti ynë personal zhvillohet në konkurrencë me “të tjerët” dhe se si përkatësia dhe historia e komunitetit tonë ndikon në mënyrën se si sillemi me “të tjerët” dhe me botën. Kam kuptuar se aftësimi i njerëzve për të kuptuar dinamikën që rrethon identitetin, si dhe të kuptuarit e të tjerëve dhe i të drejtave të njeriut, janë faktorë kyç për jetesën harmonike në diversitet. Kjo është thelbësore për shoqëritë tona dhe kjo është arsyeja pse në Adyan punojmë që nga viti 2006 për të hartuar programe dhe kurrikula për edukimin mbi diversitetin, mbi qytetarinë aktive dhe gjithëpërfshirëse dhe mbi LFB-në, si nga perspektiva e të drejtave të njeriut, ashtu edhe nga perspektiva fetare. Për shembull, kemi punuar me Ministrinë e Arsimit në Liban për të hartuar një kurrikulë ndihmëse, që promovon të nxënit mbi diversitetin, si dhe trajnimin e mësuesve mbi qytetarinë gjithëpërfshirëse.”

Çfarë përfitimesh mendoni se u sjell kjo punë shteteve?

“Programi ynë arsimor joformal bashkon nxënës me prejardhje të ndryshme dhe i ndihmon të besojnë në zërin, rolin dhe kapacitetin e tyre për të punuar për të mirën e përbashkët së bashku me studentë me prejardhje të tjera kulturore, fetare, besimi apo sociale. Kjo ndihmon në krijimin e një kulture mirëkuptimi të ndërsjellë, që çon në solidaritet ndërkulturore dhe ndërkomunitar. Madje, organizata partnere në Evropë na kërkuan të importojnë programet tona mësimore, gjë që tani kanë filluar t’i zbatojnë, duke i kontekstualizuar praktikat më të mira të programit tonë jashtëshkollor për shkollat e mesme mbi qytetarinë aktive dhe gjithëpërfshirëse për metodologjinë e arsimit joformal”.

Kur njerëzve u mungon informacioni dhe njëfarë niveli mirëkuptimi i feve dhe besimeve të ndryshme, e mbushin këtë boshllëk me një “koleksion mendor thashethemesh, supozimesh, mitesh dhe stereotipesh që ndërtohen me kalimin e kohës”⁶¹, çka rezultojnë në mosbesim dhe me shumë gjasa në frikë dhe refuzim, të cilat në vetvete mund të çojnë në përjashtim, mungesë tolerance dhe urrejtje.⁶² Dokumenti i ODIHR-it Liria e Fesë apo Besimit dhe Siguria: Udhëzimet e Politikave flet se si hartohen dhe jepen programet arsimore dhe ndërgjegjësuere përmes bashkëpunimit mes shtetit dhe aktorëve të tjerë si organizatat e

shoqërisë civile, IKDNj-të, institucionet e trashëgimisë kulturore, media dhe komunitetet fetare apo besimtare. Këto programe duhet së pari të rrisin ndërgjegjësimin për jetën, besimet dhe përvojat e komuniteteve të ndryshme fetare dhe besimtare, si edhe të theksojnë vlerën diversitetit të feve dhe besimeve si një burim pasurimi të ndërsjellë për shoqërinë. Programet që angazhojnë këto aktorë të ndryshëm përqendrohen në zvogëlimin e stereotipeve negativë që nxisin diskriminimin, armiqësinë dhe mungesën e tolerancës në shoqëri, duke promovuar të kuptuarit më të thellë dhe respektin për fetë dhe besimet. Këto janë të nevojshme për të mundësuar shkëmbime kuptimplote që janë të nevojshme për të nxënë reciprok dhe aftësinë për të bashkëjetuar në mënyrë gjithëpërfshirëse.

4.2. MOS BËJ DËM

Kjo qasje u kujton aktorëve të verifikojnë nëse veprimet e planifikuara mund të kenë ndikime të dëmshme në një kontekst të caktuar.⁶³ Zbatimi i parimit “mos bëj dëm” synon që të kuptohen, të zbuten dhe të shmangen pasojat e dëmshme që mund të ketë një veprim i planifikuar. Gjithashtu, kërkohet minimalisht kohë dhe burime të dedikuara për të kuptuar plotësisht kontekstin vendor dhe aktorët fetarë e besimtarë të përfshirë, shtu këtu historitë e ndërveprimit dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Ndonjëherë marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve janë përkeqësuar kaq shumë, saqë thjesht prania e “tjetrit” mund të shkaktojë tension. Prandaj, kjo mund të jetë arsyeja pse shteti po sheh mundësinë e financimit të nismave të dialogut për të përfshirë këto grupe. Për të shmangur dëmet në kontekste të tilla, mund të jetë e udhës që të bëhet një vlerësim i ndikimit të drejtave të njeriut përpara se të vendoset nëse dhe si të përshtatet mbështetja për nismat e dialogut.

Hartëzimi dhe analiza e aktorëve është e rëndësishme për të përcaktuar se kush duhet të ftohet në dialog. Në varësi të kontekstit dhe të temave për diskutim, konfidencialiteti i pjesëmarrjes mund të jetë qetësues për disa pjesëmarrës të cilët mund t'i druhen hakmarrjes nga komunitetet e veta për shkak të angazhimit në proceset e dialogut/partneritetit. Gjithashtu, shpjegimi paraprak dhe i qartë i objektivave për nismën pse po thirren bashkë aktorë të ndryshëm dhe i çështjeve për diskutim, mund të garantojë parashikueshmëri, të zvogëlojë keqkuptimet dhe të lehtësojë diskutimet.

Po kështu, personat me mendime kundërshtuese mund të druhen të flasin para atyre me pikëpamje të shumicës. Aktorët e pakicave mund të ndihen në siklet të diskutojnë për çështje të caktuara në prani të aktorëve të shumicës, apo përballë një pakice tjetër. Gratë ose të rinjtë mund të ndihen në siklet të flasin për nevojat e tyre në prani të burrave, që janë udhëheqës fetarë apo besimtarë. Për më tepër, disa pjesëtarë të komuniteteve fetare apo besimtare mund të jenë kulturalisht

dominues, ose të kenë pasur më shumë akses dhe ekspozim te aktorët shtetërorë, prandaj e kuptojnë më mirë se si komunikohet në mjedise të tilla. Dallimet janë të pashmangshme dhe duhet të kuptohen mirë; rasti mund ta dojë që ato të prezantohen, me qëllim që të parandalohen dinamika negative që minojnë proceset e dialogut. Gjithashtu, dallimet duhet të faktorizohen në organizimin dhe zhvillimin e procesit të dialogut (shih Kapitullin 6).

Në rastet kur ka barriera gjuhe, përkthyesit mund të ndihmojnë pjesëmarrësit që të ndihen rehat duke folur hapur. Pakicat mund të mos dëshirojnë të angazhohen në një proces ku detyrohen të flasin në gjuhën “dominuese”. Për këtë arsye, është e rëndësishme që të udhëzohen përkthyesit të përkthejnë mesazhet e përcjella në mënyrën e duhur dhe pa paragjykime personale ndaj pakicës apo grupeve të tjera.



“ Çdo person, në predikimin apo ushtrimin e fesë së vet individualisht apo në komunitet me të tjerët, ka të drejtë të flasë në gjuhën(t) që e zgjedh vetë. ”

Rekomandimet e Oslos për Të Drejtat Gjuhësore të Pakicave Kombëtare⁶⁴



“ Për të promovuar integrimin e shoqërisë [Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së] duhet të pranojnë diversitetin në shoqëritë e tyre dhe të frenojnë çdo përpjekje për asimilimin e pakicave kundër dëshirës së tyre. Gjithashtu, shtetet kanë detyrimin të promovojnë të drejtat e personave që përkasin pakicave me qëllim që të marrin pjesë efektivisht në çështjet publike dhe të ruajnë identitetet e tyre, duke ofruar mundësi të përshtatshme që të zhvillojnë kulturën, të përdorin gjuhën dhe të ushtrojnë fenë e tyre. ”

Udhëzimet e Lubjanës për Integrimin e Shoqërive Diverse⁶⁵

Për të garantuar pjesëmarrjen e qenësishme të personave me aftësi të kufizuar duhen mjete të duhura komunikimi dhe rregullime të caktuara. Nëse nuk hiqen barrierat dhe nuk bëhen rregullimet përkatëse për t'u dhënë mundësinë e pjesëmarrjes kuptimplotë, mund të thellohet edhe më shumë ndjesia e përjashtimit.

Për të garantuar që të mos dëmtohet dialogu apo përfituesit e projekteve me masa të përbashkëta, pjesëmarrësit duhet të zhvishen nga pikëpamjet paragjykuese dhe stereotipet, si dhe të kapërcejnë traumën dhe/ose lëndimin e fortë të shkaktuar ndoshta drejtpërdrejt apo tërthorazi nga palët e tjera pjesëmarrëse në proces.

Prandaj, tensionet mund të jenë veçanërisht akute në zona konflikti, ku pjesëmarrësit mund të kenë qenë dëshmitarë apo të mbjetuar të mizorive të shkaktuara nga pjesëtarë të një grupi tjetër fetar apo besimtar. Trauma mund të përjetohet edhe nga ata që dëgjojnë rrëfimet e të tjerëve apo lajmet e dhunës së vazhdueshme që pësojnë njerëzit nga komuniteti i tyre, duke përfshirë edhe ata që mund të jetojnë në një

shtet tjetër. Gjithashtu, komunitetet e emigrantëve dhe diaspora mund të kenë përjetime krejt të tjera nga pjesëtarët e këtyre grupeve fetare apo besimtare në kontekste të ndryshme.

Kur e vlerësojmë situatën nga perspektiva “mos bëj dëm”, është e rëndësishme të mbahen parasysh kontekstet e traumës së shkaktuar prej konflikteve të kaluara me motive fetare apo besimi. Është fakt që trauma e rëndon mënyrën se si njerëzit perceptojnë motivet e të tjerëve që angazhohen në dialog dhe partneritet. Kështu, është thelbësore që aktorët e shoqërisë civile që planifikojnë të udhëheqin projekte të tilla të kenë parasysh një gamë faktorësh që mund të shkaktojnë ritraumatizim, siç është diskutimi mbi tema të caktuara apo nëse vendi ku mbahet dialogu konsiderohet i sigurt. Për të thirrur dialogun duhet të përzgjidhen persona me njohuri, aftësi dhe përvojë profesionale.

Ata që i thërrasin palët për dialog, në kontekste ku ekzistojnë ndasi mes pjesëmarrësve, është e mira që të ofrojnë disa korniza konceptuale të reja krahasuar me ato që përdorin pjesëmarrësit. Kjo me siguri do t'i ndihmojë të kapërcejnë paragjykimet dhe frikën duke transformuar perceptimet, qëndrimet dhe marrëdhëniet individuale me njerëzit që janë të ndryshëm prej tyre. Kornizat konceptuale që brendësojnë elementë si e drejta për LFB-në, transformimi i konfliktit dhe roli i fesë apo besimit në transformimin e konfliktit mund të jenë të dobishme. Për pjesëmarrësit shërben edhe që të njohin llojet e ndryshme të shkeljeve të të drejtave të njeriut, kërcënimet apo dhunën me të cilën mund të përballen ata vetë ose grupi i tyre. Në situata të tilla, organizatorët duhet të përfshijnë trajnime për ndërmjetësimin dhe komunikimin jo të dhunshëm. Kjo ndihmon në krijimin e themeleve për diskutim që u mundëson pjesëmarrësve të trajtojnë dhe të perceptojnë çështjet në mënyrë joparagjykuese. Gjithashtu, mund të ndihmojë në zbulimin e faktorëve që pengojnë diskutimin e sinqertë dhe zgjidhjen e konfliktit, siç janë kritikata e kamufluara, lëvdatat e tepërta ose të sforcuara.

Angazhimi i feve dhe besimeve, me ose pa përfshirjen e shtetit, duhet të karakterizohet nga respekti për aftësinë e secilit që të mbajë qëndrime të kundërta si dhe nga gatishmëria për t'u përfshirë aktivisht. Kjo nuk nënkupton që dialogu mes feve apo besimeve duhet patjetër të jetë i zbutur dhe jofyës. Përkundrazi, dialogu shpesh bëhet pasionant dhe provokon emocione të fuqishme. Ideja është që të gjithë aktorët të përfshihen me sinqeritet dhe mirëbesim, si të barabartë dhe të përpiqen të mos bëjnë dëm.

Është e arsyeshme të supozohet se jo çdo aktor pjesëmarrës në dialogun mes feve apo besimeve kupton apo mbështet plotësisht të drejtat e njeriut; në fakt, disa aktorë mund të besojnë te ato që konsiderohen praktika diskriminuese. Për këtë arsye, është e rëndësishme që të sigurohet angazhimi i tyre në dialog. Gjithsesi, inkuadrimi i projektit duhet të jetë në përputhje me parimet e të drejtave të njeriut. Për të përcaktuar nëse një veprim i përbashkët që rezulton

nga dialogu duhet të përfitojë fonde buxhetore, shtetet duhet të vlerësojnë meritat e secilit projekt në integrimin e qasjes bazuar në të drejtat e njeriut dhe të parimeve [PANEL](#).

4.3. BARAZIA

Secili shtet duhet të miratojë një kuadër ligjor solid në fushën e Lirisë së Fesë dhe Besimit (LFB), që pasqyron të drejtat e komuniteteve të ndryshme fetare dhe besimtare. Sipas të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, shteti është garant i paanshëm dhe kjo kërkon pa dallim bashkëpunim dhe integrim të grupeve fetare dhe besimtare.⁶⁶ Për shembull, shteti nuk duhet të komentojë mbi vlefshmërinë e besimeve të caktuara. Krijimi i “hierarkisë së feve” *de jure* apo *de facto* mund të rezultojë në shkelje sistematike të LFB-së.⁶⁷ Shumë shtete favorizojnë hapur ose fshehurazi një sistem besimi ndaj një tjetri, qoftë si fe “zyrtare” ose jo, me status të preferuar apo të favorizuar, apo si rezultat i sekularizmit doktrinor. Pavarësisht fesë apo besimit mbizotërues, shtetet duhet të shmangin “përkrahjen” e një feje, besimi, interpretimi apo botëkuptimi të një tradite fetare ndaj një tjetre.



“ Sipas të drejtës ndërkombëtare, shtetet shërbejnë si garantë zyrtarë të të drejtave të njeriut, duke përfshirë lirinë e fesë dhe besimit. Në mënyrë që të veprojnë si garantë të besueshëm të lirisë së fesë dhe besimit për të gjithë, shtetet duhet të ofrojnë një kornizë të hapur dhe gjithëpërfshirëse në të cilën pluralizmi i feve dhe besimeve të mund të shpaloset lirisht dhe pa diskriminim. Kjo kërkon që të mos zgjidhet asnjë mjedis ekskluziv. Mbi të gjitha, duhet parandaluar mundësia që shteti të identifikohet me një fe ose besim të caktuar në kurriz të trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues të ndjekësve të bindjeve të tjera. Kontekste të tilla ekskluziviste nuk ndodhin vetëm në shtete që kanë përqafuar formalisht një fe zyrtare ose një fe shtetërore. ”

[Raporti i Raportuesit Special për lirinë e fesë ose besimit, 2013⁶⁸](#)



“ Shteti, gjatë ushtrimit të fuqisë rregullatore në marrëdhëniet me fetë dhe besimet e ndryshme, ka detyrimin të qëndrojë neutral dhe i paanshëm, duke mos mbajtur anë në mosmarrëveshjet me tipare fetare ose konfesionale [...] Kur përballet me konflikte me fe ose elemente besimi, të cilat mund të kenë natyrë etno-kombëtare, territoriale, ndërshtetërore, ekonomike ose kulturore, roli i autoriteteve politike është të kërkojnë zgjidhje sipas ligjit, duke u bërë thirrje komuniteteve fetare të respektojnë ligjin dhe njëri-tjetrin. Zgjidhja në rrethana të tilla nuk mund të gjendet në diskriminimin ose privimin e gëzimit të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore. ”

[Parimet e Strasburgut për dialogun ndërfeetar brenda Këshillit të Evropës⁶⁹](#)

Kjo barazi është e rëndësishme kur shtetet japin mbështetje financiare siç është financimi i dialogut dhe nismave të përbashkëta të cilat çojnë përpara të drejtat e njeriut për të gjithë, si edhe mbështetje administrative siç është ofrimi i ambienteve, lehtësimi i udhëtimit apo ndihma në komunikimin e rezultateve të projektit. Mbështetja mund të përfshijë edhe elementin e njohjes shtetërore të projekteve, duke përfshirë dhënien e çmimeve për projektet me ndikim të fuqishëm pozitiv.

Shteti duhet të reflektojë për mesazhet që mund të përçojë mbështetja që ai jep. Për shembull, ekziston rreziku që të shtrembërojë mjedisin në të cilin veprojnë aktorët fetarë dhe besimtarë. Nëse financimi nuk planifikohet apo ndahet në mënyrë të barabartë, shtetet mund të shihen sikur u japin trajtim preferencial aktorëve të caktuar. Shtetet duhet edhe të shmangin financimin e individëve ose grupeve që kanë përdorur gjuhë urrejtjeje ndaj komuniteteve të tjera. Shtetet mund të krijojnë një mjedis të favorshëm për tubimin, dialogun dhe veprimet e përbashkët nëpërmjet mbështetjes praktike të departamenteve shtetërore apo të institucioneve të ngritura me ligj që janë të pavarura nga shteti dhe plotësisht në përputhje me Parimet e Parisit,⁷⁰ të tilla si Institucionet Kombëtare për Të Drejtat e Njeriut (IKDNj). Të gjithë nëpunësit civilë që angazhohen me komunitetet fetare dhe besimtare duhet ta bëjnë këtë në një mënyrë të paanshme që i trajton të gjitha komunitetet njëjloj. Shtetet duhet të garantojnë financimin e trajnimeve për aktorët shtetërorë që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, komunikimin jo të dhunshëm, ndërmjetësimin dhe edukimin fetar, në mënyrë që shtetet të jenë në pozitën e duhur që të angazhohen me takt me aktorët nga prejardhje fetare dhe besimtare të ndryshme. Në fakt, nëse nëpunësve civilë apo aktorëve shtetërorë u mungon formimi bazë për të drejtat e njeriut dhe edukimin fetar, ato mund të mos arrijnë të kuptojnë nevojat e komuniteteve dhe as të komunikojnë efektivisht me ta.



Praktikë e mirë: Këshilli i Feve, Gjeorgji⁷¹

Në vitin 2005, Avokati i Popullit i Gjeorgjisë, institucion kombëtar për të drejtat e njeriut, ngriti Këshillin e Feve⁷², si një organ i pavarur këshillimor dhe konsultativ për çështjet e lirisë së mendimit, ndërgjegjes, fesë dhe besimit. Objektivat e Këshillit janë mundësimi i mbrojtjes më të gjerë të lirisë së fesë dhe besimit dhe të të drejtave të tjera të njeriut, si dhe nxitja e dialogut shumëpalësh ndërmjet komuniteteve fetare për rritjen e tolerancës dhe gjithëpërfshirjes në shoqëri. Nisur nga statusi i pavarur, Avokati i Popullit merr edhe nisma të vetat dhe bashkëpunon me aktorë të tjerë si shoqëria civile dhe qeveria gjeorgjiane. Me pjesëmarrjen e 32 grupeve fetare dhe besimtare, Këshilli është forumi më i madh i komuniteteve fetare dhe besimtare në Gjeorgji. Duke funksionuar mbi bazën e barazisë së plotë

mes të gjitha organizatave anëtare, vendimet merren me konsensus. Komunitetet caktojnë përfaqësuesit dhe kanë garantuar pjesëmarrje të gjerë të udhëheqësve gra dhe të rinj.

Angazhimi i Këshillit me proceset ligjvënës dhe rregullatore u ka mundësuar klerikëve të të gjitha komuniteteve fetare që të vizitojnë të burgosurit e fesë së tyre, pa përjashtim, si edhe komuniteteve fetare që të regjistrohen si person juridik mes një sërë alternativash, apo të funksionojnë pa u regjistruar në shtet. Gjithashtu, janë rrëzuar edhe disa dispozita të propozuara në kuadrin e reformës kushtetuese që parashikonin “sigurinë shtetërore” si bazë për të kufizuar lirinë e fesë dhe të besimit.

Këshilli mbështetet në një sërë takimesh dhe konsultimesh të gjera me të gjithë aktorët, si shoqëria civile, deputetët dhe qeveria. Në raportin vjetor që i paraqiti parlamentit, Avokati i Popullit përfshiu rekomandimet e Këshillit për parlamentin, qeverinë dhe strukturat shtetërore. Gjithashtu, Avokati i Popullit monitoroi zbatimin e rekomandimeve përmes një raporti vjetor.

Aktiviteti i Këshillit të Fesë dhe Avokati i Popullit në Gjeorgji ilustron një sërë praktikash të mira për dialogun dhe veprimet e përbashkëta ndërkomunitare. Së pari, tregon se shteti nuk është monolit dhe se institucionet publike vërtet të pavarura mund të luajnë rol të çmuar në mobilizimin e bashkëpunimit. Së dyti,



tregon ndikimin pozitiv që mund të kenë masat e përbashkëta të bazuara në të drejtat e njeriut, sepse shërbejnë si ekspertizë për proceset e reformave ligjore që i mundësojnë shtetit krijimin e një mjedisi të favorshëm për LFB-në

4.4. Pjesëmarrja dhe Gjithëpërfshirja

Dialogu gjithëpërfshirës dhe efektiv, si dhe veprimet e përbashkëta përtej kufijve të fesë dhe besimit nuk duhet të ngelet vetëm te ajo që zakonisht konsiderohet udhëheqje. Kjo duhet të jetë e dukshme në mënyrën se si shtetet i kuptojnë aktorët fetarë ose besimtarë me të cilët angazhohen në proceset e dialogut. Përkufizimi i “udhëheqësit fetar” duhet të njohë edhe udhëheqjen jozyrtare dhe ekspertizën, si dhe të mundësojë pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve përkatës (nga prejardhje të ndryshme raciale apo etnike, personat me aftësi të kufizuara, gratë, burrat dhe komunitetet LGBTI). Zyrtarët shtetërorë që angazhohen me grupe fetare ose besimtare duhet të njohin çështjet që kanë të bëjnë me përfaqësimin e komunitetit, sepse individë ose organizata



të caktuara mund të pretendojnë se përfaqësojnë zona që nuk i përfaqësojnë, ose mund të perceptohen si aktorë të paligjshëm prej atyre që gjoja përfaqësojnë.

Angazhimi i shtetit në mbështetjen e projekteve të dialogut dhe veprimeve të përbashkëta, për shembull, duke u konsultuar me komunitetet fetare ose besimtare, duhet të synojë përfshirjen e zërave të ndryshëm nga i gjithë spektri i feve dhe i besimeve. Megjithatë, në varësi të kontekstit specifik dhe të rezultateve të parashikuara, jo çdo aktor duhet të përfshihet në një proces konsultimi, komitet këshillimor apo dialog. Ndonjëherë, nevojat mund të identifikohen më mirë dhe qëllimet e përbashkëta mund të arrihen më lehtë duke ftuar më pak aktorë. Për shembull, ndërtimi i besimit ndërmjet palëve në konflikt që të hyjnë në dialog, mund të kërkojë një grup të kufizuar aktorësh që të bisedojnë jozyrtarisht. Thënë kjo, është e pamundur që të gjithë aktorët brenda një komuniteti të kuptojnë plotësisht ndikimin e secilës sfidë që diskutohet në të gjitha segmentet e komunitetit. Në fakt, disa mund të kenë qëndrime të paracaktuara institucionalisht që e bëjnë të pamundur diskutimin, prandaj shtetet duhet të komunikojnë qartë qëllimin dhe objektivat e konsultimit ose të komitetit të përbashkët dhe llojet e aktorëve që dëshirojnë të kenë të pranishëm.

Shtetet dhe organizatorët e dialogëve për LFB-në duhet të mbajnë parasysh se disa komunitete - si ato joteiste dhe ateiste - mund të mos kenë përfaqësues, ose nuk ndihen rehat apo të sigurt që të angazhohen në konsultime, komitete të përbashkëta, dialogë, apo veprime të përbashkëta përtej kufijve të fesë e të besimit, prandaj, nuk duhet të detyrohen. Njëkohësisht, atyre u duhet dhënë mundësia që të kontribuojnë në mënyra të tjera në çështje që i prekin ata ose që janë me interes publik (p.sh. përmes konsultimeve publike). Disa aktorëve mund t'u mungojnë kapacitetet apo mundësitë për të marrë pjesë, edhe nëse duan. Organizatorët e konsultimeve, komiteteve të përbashkëta apo të dialogut, duhet të jenë të vetëdijshëm për sfida të tilla, si edhe duhet të bëjnë përpjekje për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre. Gjithashtu, organizatorët e këtyre proceseve duhet të marrin masa që të mos e caktojnë takimin në data/kohë të papërshtatshme për pjesëmarrësit e mundshëm, p.sh., në një datë që bie festë fetare.

Qasja e hapur ndaj ndryshimeve nënkupton edhe plotësim të arsyeshëm të nevojave të pjesëmarrësve në konsultime apo komitete të përbashkëta. Në momente të caktuara, komunitetet apo pjesëtarë të caktuar të tyre mund të jenë më pak të gatshëm të angazhohen, për shkak të festave specifike apo të periudhave të agjërimit ku nivelet e energjisë mund të jenë të ndryshme mes pjesëmarrësve. Megjithatë, me qëllim që të nxitet gjithëpërfshirja, duhet të plotësohen sa më shumë nevojat për shembull të grave, të rinjve, të komuniteteve të personave të paprivilegjuar sa të tjerët, të pakicave gjuhësore, të emigrantëve, apo të personave me aftësi të kufizuar. Në komunikimin e

tyre, organizatorët mund të inkurajojnë idenë që përfaqësuesit të jenë të paktën 40% nga të rinjtë. Parimet e pjesëmarrjes së barabartë dhe gjithëpërfshirjes duhet të balancohen përkundër parimit të autonomisë së komuniteteve fetare dhe besimtare; në fund, është vendimi i tyre se kush do të marrë pjesë, edhe nëse dialogu mbështetet prej shtetit.

4.4.1. Gratë

Gratë mund të jenë pjesëtare aktive të komuniteteve fetare ose besimtare. Edhe kur përfaqësuesit tradicionalë janë burra, shumë gra punojnë si mësuese, drejtuese të komuniteteve ose si punonjëse sociale. Aftësitë dhe pozicionet e tyre sociale sjellin këndvështrime të ndryshme në dialogun dhe veprimin e përbashkët. Në situatat e konfliktit nëpër botë ku burrat kanë dështuar, gratë kanë treguar aftësinë për të gjetur gjuhën e përbashkët dhe për të përmirësuar komunitetet e tyre në mënyrë efikase.⁷³ Prandaj, kur mbështesin konsultimet ose ngritjen e komiteteve të përbashkëta, shtetet duhet:

- Të sigurohen që komunitetet fetare dhe besimtare të kërkojnë pjesëmarrjen e grave me përvojë në çështjet e shtruara për diskutim;
- Të përpiqen të trajtojnë sfidat e pjesëmarrjes së grave që vijnë nga komunitete të caktuara (udhëtimi, vendi, orari, kujdesi për fëmijët, etj.). Kini parasysht që mund të ketë rezistencë ndaj përfshirjes së grave në konsultime apo komitete të përbashkëta, për shembull, për shkak të rregullave patriarkale apo të traditës në lidhje me rolin e gruas;
- Të shqyrtojnë mundësinë që konsultimet apo komitetet me pjesëmarrjen të mbahen vetëm me gra, kryesisht mbi tema për të cilat gratë mund të vetëcensurohen nëse gjenden në një grup të përzier (p.sh., për dhunën në familje);
- Në konsultime me pjesëmarrje të përzier, të garantohet një hapësirë e respektuar për gratë, në mënyrë që pjesëmarrësit t'u drejtohen grave me të njëjtin respekt si burrave, të ulen në tryezë në të njëjtën mënyrë si burrat, si dhe t'u ofrohet kohë diskutimi e barabartë me burrat;
- Të mendojnë për normat dhe zakonet gjinore vendore që mund të krijojnë pabarazi fuqie gjatë konsultimeve apo takimeve të komitetit këshillimor;
- Të jenë të vetëdijshme se proceset e dialogut që përfshijnë gratë mund të shihen si kërcënim për strukturat tradicionale shoqërore/fetare, si dhe të garantojnë kornizë bazuar në të drejtat e njeriut dhe lehtësimin e përshtatshëm;
- Të jenë të vetëdijshme se gratë që flasin për problematikat e tyre mund të akuzohen se promovojnë "axhendë feministe" si mënyrë për të tkurrur shqetësimet e tyre, si dhe të garantojnë lehtësim që e sfidon këtë paragjykim;

- Të mendojnë për dallimet në formimin arsimor mes burrave dhe grave, sipas rastit, sepse dinamikat e fuqisë që rezultojnë në diskutim mund të duhet të zbuten;
- Të sigurojnë barazi gjinore ndërmjet pjesëmarrësve të shtetit;
- Të komunikojnë rëndësinë dhe vlerat që mbart pjesëmarrja e grave në një konsultim apo komitet të përbashkët, p.sh., arsimi për të ngushtuar hendekun e pabarazisë;
- Të integrojnë barazinë gjinore në konsultime dhe në hartimin e prioriteteve/proceseve prioritare që mbështesin LFB-në, sepse gratë vërtet përjetojnë shkelje të lirisë së fesë dhe besimit të ndryshme nga burrat, ose të njëjtat shkelje i përjetojnë në të tjera mënyra.⁷⁴



Intervistë: Dr. Jagbir Jhutti Johal

Dr. Jagbir Jhutti Johal është profesore e studimeve Sikh në Universitetin e Birmingamit (Mbretëria e Bashkuar) dhe anëtare e Panelit të Ekspertëve të ODIHR-it për Lirinë e Fesë dhe të Besimit. Bashkë me pesë gra të profilit të lartë nga gjashtë grupet fetare më të mëdha në Mbretërinë e Bashkuar, ajo themeloi Forumin e Besimit të Grave. Kjo organizatë punon për fuqizimin e grave që të kontribuojnë në hartimin e politikave. Ajo krijon një hapësirë ku zëri i grave mund të dëgjohet nga politikëbërësit, duke u mundësuar atyre të ndajnë përvojat, njohuritë dhe pikëpamjet e tyre mbi mënyrat e adresimit të çështjeve bashkëkohore.

Çfarë kontributi jep zëri i grave në dialog?

“Për shkak të roleve gjinore dhe përgjegjësisë të supozuara (si gjyshe, nëna, bija, motra, etj.), gratë janë më të lidhura me komunitetin sesa burrat dhe më të prirura të kuptojnë problemet e përditshme me të cilat përballen njerëzit, sidomos ato të grave. Gratë kanë më shumë gjasa të prezantojnë shqetësime në tryezë, të cilat ndonjëherë kapërcejnë kufijtë e fesë dhe të besimit, siç është raca, krimet e urrejtjes, varfëria apo shqetësimet me bazë gjinore që prekin kryesisht gratë (p.sh., dhuna seksuale dhe dhuna në familje).”

“Prania e grave dhe e rinisë në dialog rrit përfaqësimin e komunitetit dhe i bën diskutimet, rezultatet dhe zgjidhjet më relevante dhe të përshtatshme për problematikat me të cilat përballen komunitetet. Në situata krize apo konflikti, shpesh viktimat kryesore janë gratë dhe fëmijët, madje në mënyra specifike. Nga ana tjetër, gratë janë edhe pjesa thelbësore e zgjidhjes. Për më tepër, zgjidhjet e arritura me pjesëmarrjen e qenësishme të grave rezultojnë më afatgjata. Rezoluta 1325⁷⁵ e Këshillit të Sigurimit të OKB-së e miratuar në vitin 2000, pohon rëndësinë e pjesëmarrjes së grave dhe përfshirjes së perspektivave gjinore në bisedimet për paqe, planifikim humanitar, operacione paqeruajtëse, ndërtimin e paqes pas konflikteve dhe në qeverisje.”

Si kontribuon dialogu ndërmjet personave me fe dhe besime të ndryshme në kohezionin social?

“Dialogu në komunitet mes njerëzve të thjeshtë mund të ndodhë natyrshëm, gjatë kohës së lirë apo aktiviteteve vullnetare, kështu që është i hapur ndaj njerëzve të të gjitha feve dhe besimeve. Gratë prirën të diskutojnë në këtë nivel më shumë sesa burrat. Në këto kontekste, njerëzit tregojnë për përvojat e përditshme, mësojnë nga njëri-tjetri, ndërtojnë rrjete dhe miqësi. Njohja me një “person ndryshe” me të cilin mund të mos ndërveprojë në situata të përditshme, është instrument shumë i fuqishëm për të luftuar padijen dhe paragjykimin, madje kjo vlen edhe përtej fesë apo besimit. Në kohë tensionesh apo konfliktesh, personat e përfshirë në këto rrjete mund të gjejnë më lehtë zgjidhje praktike, si për shembull të edukojnë apo të porosisin fëmijët që të mos kërkojnë fajtorë dhe të mos krijojnë ndasi. Ata marrin shembull nga marrëdhëniet dhe përgjegjësitë e përbashkëta për të zvogëluar retorikën apo sjelljet e dëmshme. Rrjetet ndërkomunitare mund të funksionojnë në këtë mënyrë: diskutohet për çështje praktike që prekin këdo, ndërtojnë kohezionin përtej kufijve të fesë dhe të besimit, si dhe mbrojnë anëtarët ndaj polarizimit në kohë krize”.

Kush duhet të marrë pjesë në dialogun përtej kufijve të fesë dhe të besimit?

“Për shumë nga ne është prioritet angazhimi i besimeve abrahamike në dialog, veçanërisht në kohë tensionesh. Përfaqësuesit e besimeve dharmike mund të ndihen si partnerë të dorës së dytë që ftohen në dialog sa për numër, pa i njohur dhe pa i pranuar si duhet përvojat dhe botëkuptimet e tyre specifike. Besimet dharmike në përgjithësi nuk konvertohen dhe madje mund të ndihen të zhgënjyera kur trajtohen si “i huaji, që duhet shpëtuar”.

“Është shumë e rëndësishme që dialogu të mundësohet si duhet dhe që të gjitha komunitetet fetare të pranishme të respektohen dhe t’u jepet mundësia të ngrenë zërin. Në kohë krize, zëri i një komuniteti që nuk është i përfshirë në një konflikt mund të ndihmojë për uljen e tensioneve, duke vënë në dukje “pikat e padukshme” ose duke ofruar një këndvështrim të tretë “jashtë kornizës” së zakonshme, por kjo kërkon guxim. Ndonjëherë, vetë komuniteti juaj mund të ketë paragjykime për një konflikt, qoftë edhe si palë jashtë atij konflikti. Kjo është arsyeja pse dialogu i vërtetë në një tryezë ndërfaqetare duhet të mundësojë angazhimin brendapërbrenda secilës fe dhe ndërmjet feve të ndryshme, duke pranuar se secili prej nesh ka sfida personale dhe si komunitet dhe, duke ndarë përvojat, duke eksploruar zgjidhjet praktike dhe duke mbështetur njëri-tjetrin, ne krijojmë një botë më të sigurt dhe më kohezive”.

4.4.2. LGBTI

Në raportin e vitit 2023⁷⁶ për Lirinë e Fesë dhe të Besimit, Victor Madrigal Borloz, Eksperti i Pavarur i OKB-së për mbrojtjen ndaj dhunës dhe diskriminimit për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, konstatonte se personat LGBTI “shpesh marxhinalizohen, stigmatizohen dhe përjashtohen nga komunitetet fetare thjesht për shkak të asaj çka janë”. Gjithashtu, nënvizonte se liria e fesë

dhe e besimit nuk duhet të përdoret si pretekst për dhunë dhe trajtim diskriminues ndaj personave LGBTI. Dialogu dhe masat e përbashkëta mund të krijojnë mirëkuptim ndërmjet komuniteteve fetare dhe besimtare nga njëra anë, si dhe personave LGBTI nga ana tjetër, brenda ose jashtë komuniteteve të tyre. Për më tepër, mund të ndihmojnë për të angazhuar përfaqësuesit e feve dhe të besimeve të ndryshme në luftën për parandalimin e pasigurisë të personat LGBTI.



Praktikë e mirë: Plani i Veprimit për Diversitetin Gjinator dhe Seksual 2023-2026 në Norvegji⁷⁷

Qeveria norvegjeze vendosi disa synime në Planin e Veprimit 2023-2026 për Diversitetin Gjinator dhe Seksual për të përmirësuar cilësinë e jetës së personave LGBTI në komunitetet fetare. Në dritën e disa sfidave që mund të hasin personat LGBTI brenda komuniteteve fetare, fushat prioritare përfshinin rritjen e njohurive dhe pranimit, si dhe krijimin e hapësirave të sigurta për takime për dialog rreth identitetit gjinator dhe orientimit seksual. Ky plan përfshinte financimin e Këshillit për Komunitetet Fetare dhe Qëndresës për Jetën në Norvegji (STL) për të organizuar një projekt dialogu që të bënte bashkë komunitetet fetare dhe përfaqësues të organizatave LGBTI. Pas sulmeve kundër “Paradës së Krenarisë” së Oslos në vitin 2022⁷⁸, STL-ja e vendosi këtë temë në axhendën e vet.

Në vitin 2023 u zhvillua raundi i parë i dialogut që zgjati katër ditë dhe solli bashkëudhëheqës nga tradita të ndryshme fetare dhe persona LGBTI me të njëjtën prejardhje fetare. Për pjesëmarrësit LGBTI, shpjegimi i terminologjisë rreth identitetit gjinator dhe orientimit seksual ndihmoi në krijimin e një baze të përbashkët të të kuptuarit. Jashtë sesioneve kryesore të dialogut, pjesëmarrësit edhe gatuan dhe hëngrën bashkërisht, duke krijuar lidhje miqësore me njëri-tjetrin.

Gjatë raundit të dytë të dialogut, diskutimet trajtuan çështje më të ndjeshme në lidhje me lirinë e shprehjes dhe LFB-në. Një pjesëmarrës përshkroi pse është e rëndësishme të trajtohet liria e fesë dhe e besimit: *“Shpesh harrohet se LFB-ja është për të gjithë. Edhe personat LGBTI duhet ta gëzojnë këtë liri e cila na grabitet dhe shtrembërohet me idenë se liria fetare u jep disave të drejtën për të mos pranuar identitete gjinore dhe orientime seksuale të ndryshme”*. Dialogu vazhdoi në vitin 2024 me nisma të reja në nivel vendor.

Procesi i dialogut i vitit 2023 rezultoi në një deklaratë të përbashkët⁷⁹ ku pjesëmarrësit shprehën mirënjohjen për çfarë mësuan, renditën disa shqetësime të përbashkëta me të cilat përballen dhe pranuan se ende kishte disa mosmarrëveshje që nuk arritën të zgjidhen. E rëndësishme ishte se në këtë deklaratë theksohej vullneti për t’u ulur dhe për të diskutuar mbi çështjet për të cilat bihet dakord, si dhe për rëndësinë e të qenit të hapur për të mësuar nga njëri-tjetri”.

“Bashkë, kemi vendosur të vëmë theksin në çështjet për të cilat biem dakord, si edhe të dëgjojnë përvojat jetike të njëri-tjetrit. Kjo nuk nënkupton që traditat fetare të ndryshojnë papritur teologjinë dhe pikëpamjet tona, për shembull për martesën. As nuk nënkupton që personat *queer* të ndalojnë së sfiduari mësimet dhe praktikat fetare që i konsiderojnë problematike. Prapë do të ketë hapësirë për diskutime dhe mosmarrëveshje, por nuk ka arsye që këto mosmarrëveshje të mbizotërojnë në atë masë sa që ta bëjnë bashkëjetesën dhe respektin të pamundur”.⁸⁰

4.4.3. Rinia

Të rinjtë duhet të inkurajohen për të qenë aktorë në shoqëritë e sotme, që të ndihmojnë në formësimin e drejtimit që merr shoqëria. Në disa shtete, rinia përbën një përqindje të konsiderueshme të popullsisë. Të rinjtë mund të krijojnë rrjete virtuale të mëdha, energji dhe ide novatore në proceset e dialogut dhe veprimeve të përbashkëta.⁸¹

Shumë të rinj të angazhuar në LFB, apo në aktivitete për LFB-në, janë në pararojë të përpjekjeve për paqe dhe drejtësi dhe përfshihen në dialog, duke punuar për forcimin e veprimeve të përbashkëta në një sërë çështjesh. Shembulli tipik është krijimi i degëve rinore të organizatave të konsoliduara, siç është Fetë për Paqen, Rrjeti për Paqevënësit Fetarë dhe Tradicionalë, Qendra Ndërkombëtare e Dialogut (KAICIID) apo Forumi Ndërfetar G20.

Që proceset e dialogut dhe masave të përbashkëta të jenë efektive, shtetet duhet:

- Të përfshijnë të rinjtë si pjesëmarrës të barabartë, duke sfiduar drejtpërdrejt çdo stigmatizim të të rinjve si më pak të aftë për të kontribuar;
- Të mos ftojnë të rinjtë që të flasin vetëm për tema që lidhen me rininë, apo të kontribuojnë në programe që synojnë parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit⁸². Për shkak se ndihen të huaj, ata mund të shpërfillin si problematikat me të cilat përballen, ashtu edhe kontributet që mund të japin. Kur çështje të caktuara ndahen sepse u përkasin posaçërisht të rinjve, duhet pasur kujdes se mos kjo rezulton në përjashtim të të rinjve nga dialogu kryesor dhe zvogëlon të mësuarit ndërbrezor;
- Të konsultohen me të rinjtë për identifikimin e politikave dhe programeve që janë tërheqëse për ta apo nga të cilat mund të kenë përfitime pozitive;
- Të mbajnë parasysh se të rinjtë mund të ndihen të ndrojtur ose jo të aftë sa duhet kur flasin përballë njerëzve më me përvojë apo grupeve të mëdha;

- Të jenë të vetëdijshëm se përfshirja e të rinjve mund të mos u pëlqejë personave më në moshë, prandaj duhet të përgatisin masa zbutëse dhe të mundësojnë një dialog të përshtatshëm për t'u garantuar mundësinë të rinjve të flasin dhe të dëgjohen;
- Të shqyrtojnë mundësinë e mbështetjes së pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete në të cilat ata mund të përjetojnë diversitet kulturor, fetar dhe besimtar; dhe
- Të shqyrtojnë mundësinë e projekteve që fuqizojnë rininë në drejtimin e nismave dhe të projekteve të tyre që ofrojnë edukim dypalësh dhe ndërbrezor, si dhe të përpiqen të zbutin mosbesimin mes brezave. Kjo mund të përfshijë si forcimin e kapaciteteve të të rinjve që ata të angazhohen në çështjet LFB, por edhe pajisjen e aktorëve fetarë më të vjetër me trajnim ose burime, për shembull, me komunikim *online* ose se si të sigurohet angazhimi i qenësishëm i të rinjve.

E rëndësishme është që të rinjtë të ushtrojnë të drejtën e pjesëmarrjes në vendimmarrje, duke përfshirë edhe ata nën 18 vjeç, siç mishërohet në nenin 12 të Konventës së OKB-së për Të Drejtat e Fëmijës.⁸³



Praktikë e mirë: Futbolli për Paqen (FFP)⁸⁴

Futbolli për Paqen është një projekt global i diplomacisë sportive që është miratuar dhe mbështetur nga shtete dhe aktorë privatë të ndryshëm në kontekste të ndryshme. Projekti synon që përfituesit të jenë komunitetet vendore të marxhinalizuara. Themeluesi i saj, Kashif Siddiqi, u shpreh në Samitin e Njerëzimit në Vatikan në vitin 2016 se: *“Sporti është instrumenti, paqja është qëllimi”*. I shpallur në vitin 2013 në Forumin e Paqes dhe Sportit në Dubai, FFP-ja ka qenë aktive në mbarë botën duke shfrytëzuar pasionin e njerëzve për futbollin për ndërtimin e mirëkuptimit të ndërsjellë dhe të bashkëpunimit. Lojtarët, të bashkuar në diversitetin e tyre duke tejkaluar kufijtë e feve dhe të besimeve, përdorin futbollin për të treguar dobitë e pluralizmit në veprime. Përveç organizimit të ndjeshjeve të paqes, një nga nismat kryesore është edhe programi për Lojtarët më Të Mirë të Rinj, që i angazhon ata të marrin pjesë në seminare me tema si barazia, diversiteti dhe gjithëpërfshirja (edhe përtej kufijve të feve dhe të besimeve), lidershipi dhe veprimet në komunitet fokusuar në bërjen e veprave të mira.



Programet Rinore

Cili duhet të jetë prioriteti kur angazhohmë të rinjtë fetarë? Programet e dialogut dhe të veprimeve të përbashkëta përtej kufijve të feve dhe besimeve apo programet kundër ideologjive ekstremiste?

Në vitet e fundit, disa shtete u kanë dhënë prioritet programeve për të rinjtë nga komunitetet fetare që merren me rrezikun e përqafimit prej këtyre të rinjve të ideologjive të dhunshme dhe ekstremiste. Megjithatë, hulumtimet⁸⁵ e Institutit të Paqes (USIP) në SHBA tregojnë se, në përgjithësi, kur të rinjtë iu bashkohen grupeve ekstremiste, motivimi kryesor zakonisht nuk është ideologjik, por më tepër lidhet për shembull me ndjesinë e të qenit të pafuqishëm ose me përpjekjet për përkatësi ose identitet. Këto hulumtime sugjerojnë edhe se feja është shpesh më tepër një “faktor mbrojtës” dhe se të rinjtë besimtarë mund të kenë më pak gjasa t’u bashkohen grupeve me ideologji të dhunshme dhe ekstremiste.⁸⁶ Të rinjtë në përgjithësi janë në krye të nismave për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe shtetet mund të shohin mundësinë e mbështetjes së programeve që i fuqizojnë të rinjtë që të angazhohen në dialog dhe në veprime të përbashkëta përtej kufijve të feve dhe besimeve dhe jo në programe që fokusohen tek të rinjtë si ekstremistë të mundshëm të dhunshëm.



Praktikë e mirë: Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë është themeluar më 22 tetor 2007 nga udhëheqësit e katër komuniteteve fetare më të mëdha në Shqipëri (myslimanët sunitë, ortodoksët e krishterë, katolikët e krishterë dhe myslimanët bektashi).⁸⁷ Në 2018-ën iu bashkua edhe komuniteti ungjillor. Ky këshill ka dy objektiva kryesorë: zhvillimin e dialogut dhe veprimeve të përbashkëta ndërmjet komuniteteve fetare/besimtare në Shqipëri, si dhe promovimin e mirëkuptimit ndërfetar mes brezave të rinj, duke luftuar perceptimet e gabuara dhe dezinformimin rreth fesë në shoqëri.

Këshilli garanton pjesëmarrje të barabartë të të gjitha komuniteteve fetare të përfaqësuar. Kryesimi është me rotacion çdo vit ndërmjet udhëheqësve të pesë komuniteteve fetare, të cilët përbëjnë edhe Bordin e Presidencës. Bordi Ekzekutiv përfshin dy përfaqësues nga secili komunitet dhe vendimmarrja bëhet me proces bashkëpunimi. Këshilli fokusohet në rritjen e përfshirjes së grave dhe të rinjve. Në momentin e hartimit të këtij raporti, gratë përbënin një të tretën e bordit; “Departamenti i Gruas dhe i Rinisë” u themelua për të organizuar dialogun dhe vizitat studimore ndërfetare në mbarë vendin. Për të luftuar dezinformimin dhe përhapjen e mendshme të armiqësisë, Këshilli nxjerr deklarata përpara zgjedhjeve ose gjatë krizave sociale (p.sh. gjatë Covid-19) dhe pas ngjarjeve terroriste, apo krimeve ndërkombëtare mizore (si gjenocidi i akteve të ISIS-it⁸⁸). Gjithashtu, Këshilli ka bërë deklarata tematike edhe më të gjera për dhunën ndaj grave dhe për barazinë gjinore, si dhe ka prodhuar një dokumentar me titull “30 vjet liri besimi”⁸⁹, që bën një përshkrim pozitiv të diversitetit fetar në shoqërinë shqiptare.

Këshilli angazhohet edhe në veprime humanitare. Në vitin 2019 i dha ndihmë humanitare qeverisë për të përballuar pasojat e tërmetit 6.4 ballë. Gjithashtu, tani po zbaton një projekt shumëvjeçar për të mbështetur viktimat e ISIS-it dhe shqiptarët e kthyer nga Siria me (ri)integrimin e tyre në shoqërinë shqiptare. Kjo përfshin gjetjen e strehimit, shkollimit të fëmijëve dhe mundësive të punësimit për nënat e tyre.

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë ka marrë shumë çmime prestigjioze kombëtare dhe ndërkombëtare, si njohje të përpjekjeve për promovimin e dialogut ndërfetar dhe pajtimin.

4.4.4. Komunitetet jofetare



Intervistë: Tamara Vukičević - çfarë vlerë të shtuar mund të sjellë një i ri ateist?

Tamara Vukičević është mjekë, që jeton në Berlin (Gjermani) dhe po përfundon një projekt hulumtimi mbi ankthin e shkaktuar nga ndryshimet klimatike. Ajo është anëtare e organizatave si Fjala e Përbashkët Mes Të Rinjve, Fondacioni Sekular Josip Sruk, Shoqata Progotoga dhe anëtare e Panelit të Ekspertëve të ODIHR-it për Lirinë e Fesë dhe të Besimit. Tamara filloi kohët e fundit projektin Ndërkombëtar Sekularist, ku ajo mbron sekularizmin, LFB-në dhe të drejtat e pakicave fetare.

Si do ta përshkruanit përvojën tuaj, si ateiste e re, që mbroni sekularizmin gjatë angazhimit në dialogun mes feve dhe besimeve të ndryshme?

“Të jesh i ri aktiv në LFB dhe ateist, përbën padyshim sfidë të dyfishtë. Në hapësirën e LFB-së, rrallë ndodh që sekularizmi të jetë qartazi pjesë e axhendës dhe ndonjëherë më duhet të luftoj që të jem pjesë e disa tryezave. Financiarisht, nuk mbështetem nga ndonjë organizatë e fuqishme fetare dhe ashtu si shumë anëtarë të tjerë të rinj, shpesh më duhet të mbështetem në donacione të vogla nga shoqata ime ose të paguaj nga xhepi për të marrë pjesë në konferenca, seminare dhe takime. Ndonjëherë, përfshirja ime duket sa për sy e faqe. Njerëzit s’para presin që në diskutimet ndërfetare të jenë të pranishëm persona ateistë ose laikë, madje kam dëgjuar deklarata paragjyquese për sekularistët dhe ateistët, që pasohen me vështrime të tronditura, kur shpjegoj se çfarë jam. Pastaj ka konfuzion për termat. Ateizmi, humanizmi apo sekularizmi nuk janë njëlloj, edhe pse kanë elementë të përbashkët. Shumë habiten si ka mundësi që unë, si ateiste që jam, dua të marrohem dhe të krijoj familje. Ata e shohin sekularizmin dhe ateizmin si kundërta e vlerave “tradicionale” të familjes, madje disa mendojnë se ne duam të promovojmë “mekatin” - që nuk është aspak e vërtetë. Gjithmonë do ta mbroj të drejtën e besimit, ndërkohë që edhe unë duhet të kem të drejtën që të mos besoj. Besoj se do të ndihmonte sikur në tryezat e diskutimit për LFB-në të kishte më shumë ateistë dhe sekularistë.”

Pse duhet prania jote në tryezën e një dialogu të tillë?

“Unë kam interes në këtë dialog. LFB-ja më mbron. Perspektivat sekulare dhe ateiste kanë vlerë dhe unë mund të kontribuoj në to. Si e re, jam rritur në epokën e internetit dhe kam parë se si algoritmet, platforma dhe aktorë të ndryshëm

online janë të aftë të përhapin gjuhën e urrejtjes. Perspektiva e të rinjve është e vyer, sepse interneti është pjesë e jetës së përditshme dhe na pajis më mirë për të gjetur zgjidhje”.

4.4.5. Hapësirat fizike dhe virtuale

Hapësirat për dialog përtej kufijve të feve ose të besimeve duhet të jenë neutrale dhe është e rëndësishme të mendohet për faktorë si mënyra se si do të ulen njerëzit (për të shmangur përshtypjen e asimetrisë së pushtetit apo ndjesinë e ofendimit). Kur shtetet organizojnë një takim konsultimi ose komiteti të përbashkët, duhet të mbajnë parasysh implikimet dhe disa aspekte specifike të feve dhe të besimeve të ndryshme, si për shembull, ushqimi që do të shërbehet, simbolet dhe imazhet në sallën e takimit, ose rëndësia politike, historike apo kulturore e një vendi të caktuar. Shtetet duhet edhe të mendojnë edhe sa e lehtë është për komunitetet me prejardhje të ndryshme ekonomike dhe sociale, si dhe për personat me aftësi të kufizuara, të udhëtojnë për në vendin ku zhvillohet takimi.

Kur organizojnë konsultime online ose vlerësojnë nisma të mundshme, shtetet duhet të mbajnë parasysh sigurinë e përdoruesve, privatësinë dhe ruajtjen e të dhënave, gjuhën(t), terminologjinë gjithëpërfshirëse, si dhe përdorimin e simboleve dhe imazheve (p.sh., sfondi nuk duhet të ketë simbole të lidhura me fenë apo besimin e një pjesëmarrësi dhe jo të të tjerëve). Kur komentet ose përmbajtja duket se nxit dhunën, organizatori duhet të ndërhyjë menjëherë për të hequr përmbajtjen e dëmshme dhe/ose për të nxjerrë jashtë pjesëmarrësin, sipas rastit. Po kështu, duke pasur parasysh parimet e jetës private dhe mbrojtjes së të dhënave, fotografimet dhe regjistrimet video, si rregull, nuk duhet të lejohen. Kur organizatorët e lejojnë, duhet të kërkohet pëlqimi me shkrim përpara se çdo takim të filmohet ose të fotografohet dhe të tregohet qartë se për çfarë do të përdoren ato materiale.

Kur organizojnë konsultime ose takime, shtetet duhet të jenë të vetëdijshme për pengesat që mund të hasin personat me aftësi të kufizuara ose pjesëmarrës të tjerë. Këta individë punojnë në vende të ndryshme dhe kanë jetë të ndryshme. Vijnë nga komunitete fesh dhe besimesh të ndryshme dhe kanë të njëjtën të drejtë për LFB, si të gjithë të tjerët. Personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të përballen me nivele të konsiderueshme diskriminimi dhe përjashtimi, bazuar në stereotipe dhe paragjykime. Shumë shpesh shihen si njerëz që kanë nevojë për ndihmë, duke e parë kështu aftësinë e tyre të kufizuar si sëmundje. Në fakt, në dialogun mes feve dhe besimeve të ndryshme dhe në kontekstet e veprimit të përbashkët, njerëzit mund të kenë paragjykime të caktuara kulturore dhe fetare mbi aftësitë e kufizuara, të cilat mund të ndikojnë në ndërveprimin me këta individë.



Standardet

Konventa e OKB-së për Të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD),⁹⁰ e miratuar në vitin 2006, shënoi kalimin nga modeli mjekësor i të kuptuarit të aftësisë së kufizuar në modelin e bazuar te të drejtat e njeriut dhe te përfshirja sociale, ku është mjedisi që duhet përshtatur sipas nevojave të personave me aftësi të kufizuara për të garantuar pjesëmarrjen e plotë dhe respektimin e të drejtave të tyre, dhe jo e anasjellta. Një nga parimet e Konventës është “respekti për dinjitetin e qenësishëm, autonominë individuale duke përfshirë lirinë për të vendosur vetë, si dhe pavarësinë e personave” (neni 3.a). Shtetet palë të Konventës duhet edhe të marrin masa që “promovojnë aktivisht një mjedis, ku personat me aftësi të kufizuara të mund të marrin pjesë efektivisht dhe plotësisht në ecurinë e çështjeve publike, pa diskriminim dhe njësoj si të tjerët, si dhe që inkurajojnë pjesëmarrjen e tyre në çështjet publike (...)”⁹¹

Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë zotuar përmes dokumentit të Moskës të vitit 1991 se “do të ndërmarrin hapa për të garantuar mundësi të barabarta që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë plotësisht në jetën e shoqërisë së tyre (...), të promovojnë pjesëmarrjen e duhur të personave të tillë në vendimmarrje në fushat që kanë të bëjnë me ta. ... [dhe] të inkurajojnë kushte të favorshme për aksesin e personave me aftësi të kufizuara në ndërtesa dhe shërbime publike, strehim, transport dhe aktivitete kulturore dhe rekreative”.⁹²

Organizatorët duhet të sigurohen që personat me aftësi të kufizuara të mund të marrin pjesë, duke i bërë vendet fizikisht të aksesueshme (përfshirë akomodimin gjatë natës). Gjithashtu, duhet të ketë informacion të qartë dhe të plotë për aksesueshmërinë nëpër ambiente të ndryshme, duke përfshirë detaje mbi parkimin, tualetet dhe sistemimin e ndenjësive. Organizatorët duhet të parashikojnë mundësinë që personat me aftësi të kufizuara mund të kenë nevojë që t’i shoqërojë dikush. Nëse pjesëmarrja fizike është e pamundur, individëve mund t’u ofrohet ndjekja e aktivitetit *online*, por kjo formë duhet të jetë përjashtim, jo rregull.

Teknologjia e re i ka transformuar mënyrat e pjesëmarrjes, informimit dhe konsultimit me personat me nevoja të ndryshme. Përtej pjesëmarrjes online, organizatorët duhet të marrin masa që të gjitha platformat dhe materialet të jenë dixhitalisht të aksesueshme. Këtu përfshihen faqet e internetit, dokumentet dhe mjetet *online*.

Përdorimi i gjuhës së shenjave në takime ndihmon në pjesëmarrjen edhe të personave që kanë probleme me dëgjimin, kurse formatet e lehta për t’u lexuar lehtësojnë pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara intelektuale.⁹³ Për personat që kanë probleme me të folurin, mund të përdoren metoda alternative komunikimi (AAC), si gjestet ose pajisjet që gjenerojnë të folurin.⁹⁴ Personeli duhet të trajnohet se si ta mbështesë efektivisht pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara.



Çfarë e bën të sigurt një hapësirë për dialog?

- **Vendi neutral:** një vend që nuk identifikohet me një besim të caktuar. Në disa kontekste, kjo nënkupton që vendi i zgjedhur të mos perceptohet si i lidhur me asnjë institucion shtetëror, p.sh., një bibliotekë apo një park publik.
- **Aksesueshmëria:** një vend ku personat me aftësi të kufizuara mund të shkojnë lirisht, një vend ku mund të zgjedhësh ushqimin që është në përputhje me ato çka kërkon feja apo besimi yt apo mbulimi i kostove të udhëtimit dhe kostot për kujdesin ndaj fëmijëve.
- **Vendi i qetë, jo shpërqendruar:** vend ku nuk ka shumë vepra arti apo zhurmë (sidomos kur ka ndjeshmëri fetare).
- **Një vend ku ka hapësirë për lutje apo meditim.**
- **Ulja në formë rrethi:** jo ulje sipas hierarkisë.
- **Përveç sallës kryesore, të ketë edhe salla më të vogla:** për diskutime në grupe më të vogla jashtë sallës kryesore.

Angazhoni **moderatorë** tek të cilët grupi ka besim (nisur nga përkatësia e tyre), njerëz me përvojë në moderim (edhe në tema të vështira) dhe me ekspertizë.

Një tjetër pengesë që hasin zakonisht organizatat më të vogla në thithjen e fondeve nga shteti për organizimin e dialogut dhe veprimeve të përbashkëta është fakti që thirrjet (aplikimet) për fonde janë të ndërlikuara dhe kërkojnë kohë. Thirrjet për financim të shpallura nga shteti nuk duhet të synojnë vetëm aktivitete në nivel kombëtar ose federal; ato duhet të marrin në konsideratë edhe kapacitetin organizativ dhe administrativ të organizatave të vogla apo vendore dhe t'i përshtatin kërkesat teknike sipas vendit. Shtetet duhet t'i thjeshtojnë procedurat e aplikimit dhe/ose të kenë një pikë kontakti për pyetjet nga organizatat e vogla gjatë procesit të aplikimit. Shtetet mund edhe të organizojnë thirrje të dedikuara për grupe të caktuara, p.sh., inkurajimin e projekteve të organizuara nga gratë/të rinjtë ose për ta.

4.4.6. Lidhja e komuniteteve me platformat ekzistuese kombëtare dhe ndërkombëtare

Shtetet mund të mbështetin përfshirjen e komuniteteve duke krijuar platforma që sjellin bashkë komunitete fesh dhe besimesh të ndryshme dhe aktorë të tjerë shtetërorë dhe joshtetërorë, duke i bërë ata bashkë për shqetësime të përbashkëta dhe duke u dhënë mundësinë të ndjekin të njëjtat strategji. Këto platforma mund të mundësojnë krijimin e lidhjeve mes komuniteteve të feve dhe besimeve të ndryshme dhe mes vetë individëve, lidhje që nuk do të krijoheshin ndryshe ose vështirë se do të krijoheshin, p.sh., me organizatat e shoqërisë civile, qeverinë, parlamentin, gjyqësorin dhe agjencitë ligjzbatuese.



Praktikë e mirë: Koalicioni i Tryezës së Rrumbullakët Ndërkombëtare për Lirinë Fetare (IRF)

Koalicioni i Tryezës së Rrumbullakët Ndërkombëtare për Lirinë Fetare (MVS)⁹⁵ është nismë e shoqërisë civile, me seli në SHBA⁹⁶, e themeluar në vitin 2010. Koalicioni mbledh bashkë individë, komunitete, OJF dhe funksionarë shtetërorë me prejardhje nga fe dhe besime të ndryshme për të diskutuar mbi çështje si LFB-ja, diskriminimi dhe armiqësitë sociale. Arsyeja është se, nëse komunitetet e feve dhe të besimeve të ndryshme bëhen bashkë për të nxjerrë në pah dhe për të diskutuar mbi problematika me interes të përbashkët, mbrojtja dhe përkrahja e tyre në forumet ndërkombëtare është shumëfish më e fuqishme.

Që në fillim, koalicioni vendosi që diskutimet do të bazoheshin te dialogu dhe shkëmbimi i përvojave, por tryezat e rrumbullakëta duhej të orientoheshin drejt arritjes së veprimeve dhe rezultateve praktike. Gjithkush është i mirëpritur që të bashkohet, të kontribuojë dhe të organizojë nisma. Pjesëmarrësit hartojnë deklarata të disa feve bashkë në përgjigje të shkëlqeve të LFB-së në mbarë botën, në përpjekje për të informuar hartuesit e politikës së brendshme dhe të jashtme të SHBA-së.

Qeveria e SHBA-së i është përgjigjur pozitivisht koalicionit, duke i vënë në dispozicion ambiente të mëdha duke parë rritjen e anëtarësisë, si dhe duke dërguar përfaqësues të qeverisë në takimet ku janë ftuar. Raportohet se pjesëmarrja e shtetit ka ndihmuar në formësimin e politikës së SHBA-së, për shembull, duke marrë masat që jezidët dhe pakica të tjera fetare të përfshiheshin në shpalljen e veprimeve të ISIS-it, si genocid nga qeveria amerikane. Për më tepër, qeveria e SHBA-së ka kërkuar aktivisht kontributin e koalicionit për ndryshimet në Aktin Ndërkombëtar të Lirisë Fetare dhe Aktin e Politikës së të Drejtave të Njeriut të Ujgurëve. Koalicioni i Tryezës së Rrumbullakët IRF citohet si praktikë e mirë nga disa diplomatë amerikanë në angazhimin mes shtetit dhe feve/besimeve, duke rritur interesimin e shteteve të tjera për të vënë në zbatim të njëjtin model.

Siç e tregon edhe shembulli i mësipërm, dialogu dhe veprimi i përbashkët janë të dobishëm jo vetëm në nivel kombëtar. Dialogu përtej përkatësisë në një fe apo në një besim të caktuar dhe në aktivitetet mes feve dhe besimeve të ndryshme mund të mbështesin ndërtimin e paqes, ku kufijtë shoqërohen me ndasi mes fesh ose besimeve të ndryshme, me tensione, incidente kufitare dhe/ose me konflikte më të gjera. Palët në konflikt mund të ftojnë në bisedimet e paqes edhe përfaqësues të shoqërisë civile, udhëheqës të

komunitetit ose grupe fetare ose besimi. Këtu, rolet dhe përgjegjësitë e tyre në proces duhet të jenë të qarta që në fillim. Shih [Lehtësimit i Ndërmjetësimit dhe Dialogut në OSBE: Udhëzues Referencë](#).⁹⁷

Në tërësi, duke eksportuar praktikën e mira dhe duke ndihmuar komunitetet fetare dhe besimtare që të krijojnë hapësira për dialog në forume dypalëshe dhe shumëpalëshe, shtetet krijojnë mundësi që ato të kontribuojnë në procese të ndryshme, qoftë edhe në qartësimin dhe shtjellimin më të mirë të së drejtës ndërkombëtare, përmes përhapjes së shembujve të suksesshëm të aktiviteteve të përbashkëta, ndërtimit të paqes apo të trajtimit të problemeve të tjera globale. [Parlamenti i Fesë Botërore](#) është shembulli i një organi të spikatur ndërkombëtar me histori të gjatë, i cili promovon harmoninë ndërfetare dhe angazhimin në sfida të ndryshme bashkëkohore.



Praktikë e mirë: Paneli Ndërkombëtar i Parlamentarëve për Lirinë e Fesë dhe të Besimit (PNPLFB)

[Paneli Ndërkombëtar i Parlamentarëve për Lirinë e Fesë dhe Besimit \(PNPLFB\)](#) është rrjet global parlamentarësh dhe ligjvënësish të angazhuar në luftën ndaj persekutimit fetar dhe në avancimin e lirisë së fesë dhe të besimit. Ky panel fokusohet në rritjen e një rrjeti global të larmishëm dhe bashkëpunues dhe në trajnimin e parlamentarëve në mbështetjen e lirisë së fesë dhe të besimit në vendet e tyre dhe jashtë shtetit.

PNPLFB-ja u themelua në nëntor 2014 në Norvegji, bazuar në Kartën e Oslos për Lirinë e Fesë dhe të Besimit,⁹⁸ që u nënshkrua nga mbi 20 parlamentarë nga mbarë bota në Qendrën e Çmimit Nobel. Me mbi 350 anëtarë, përfshirë parlamentarë dhe ligjvënës aktualë dhe të mëparshëm nga mbi 97 shtete, PNPLFB ofron një sërë shërbimesh si trajnim, organizim të eventeve të nivelit të lartë, hulumtim, mbrotje, përkrahje dhe rritëzim. PNPLFB drejtohet nga një komitet drejtues jozyrtar i përbërë nga parlamentarë dhe një sekretariat me këshilltarë politikash.



Praktikë e mirë: Unioni Ndërparlamentar

[Unioni Ndërparlamentar \(IPU\)](#) është organizatë globale e parlamenteve kombëtare. I shpallur në vitin 1889, tani ka 180 parlamente anëtare dhe 15 parlamente anëtare të asociuara. IPU-ja lehtëson dialogun dhe bashkëpunimin parlamentar dhe fuqizon parlamentet dhe parlamentarët në promovimin e paqes, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm në mbarë botën. Me bindjen se feja dhe besimi luajnë rol thelbësor në shtete dhe shoqëri, në vitin 2023, IPU publikoi [Raportin Parlamentar për Fenë dhe Besimin](#).⁹⁹ Ky raport analizon se si parlamentet dhe parlamentarët angazhohen me çështjet e fesë dhe besimin në punën e tyre për të

ndërtuar shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse. Gjithashtu, raporti shërben edhe si mjet edukativ, si një ftesë për parlamentet që të analizojnë legjislacionin e tyre (dhe ta sjellin në përputhje me kornizat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut) dhe si ftesë për dialog ndërparlamentar dhe ndërfetar, veçanërisht për promovimin dhe mbrojtjen e shtetit të së drejtës, paqes dhe gjithëpërfshirjes.

Ekzistojnë edhe organizata të tjera, të themeluara nga shtete që “mendojnë njëloj”, siç është Aleanca e Artikullit 18¹⁰⁰ (fillimisht e njohur si Aleanca Ndërkombëtare për Lirinë e Fesë dhe të Besimit), e cila sjell bashkë përfaqësues të shteteve anëtare, të mbështetur nga ekspertë të shoqërisë civile dhe organizata ndërqeveritare, me qëllim mbrojtjen, promovimin dhe lehtësimin e lirisë së fesë dhe të besimit. Në kuadër të aktiviteteve të veta, Aleanca Neni 18 ka një grup pune që vë në dukje praktikat e mira në dialogun fetar dhe besimtar dhe në veprimet e përbashkëta në nivel komuniteti për promovimin e LFB-së.

Teksa shtetet me shumë gjasa mbeten aktorët kryesorë brenda sistemeve ndërkombëtare, shumë organizata fetare apo besimtare kontribuojnë aktivisht në procese ndërkombëtare, si për shembull përmes Task Forcës Ndërinstitucionale të OKB-së për Angazhimin me Aktorët e Besimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm, ose procesit të Stambollit.



Procesi i Stambollit

Rezoluta 16/18¹⁰¹ e Këshillit të të Drejtave të Njeriut parashikon pesë pika veprimi për të trajtuar intolerancën dhe diskriminimin mbi bazën e fesë apo besimit. Pas miratimit të rezolutës në vitin 2011, shtetet krijuan “Procesin e Stambollit”, një forum ku shtetet dhe aktorët e tjerë shkëmbejnë përvojat e zbatimit dhe praktikat e mira. Edhe pse rezolutat pasuese nuk bëjnë thirrje shprehimisht për përfshirjen e shoqërisë civile, takimet më të suksesshme dhe më produktive të Procesit të Stambollit kanë vënë fort theksin te pjesëmarrja e shoqërisë civile, duke përfshirë aktorët e bazuar në besim.

Praktikë e mirë: Fetë për Paqen

Fetë për Paqen (RfP)¹⁰² është koalicioni ndërfetar më i madh në botë. I themeluar në vitin 1970, RfP sjell bashkë përfaqësues të institucioneve fetare të përkushtuara ndaj arritjes së paqes.

Organizata është e pranishme në pothuaj 100 shtete dhe pesë rajone përmes Këshillave Ndërfetarë. RfP synon të arrijë përgjigje ndërfetare, novatore dhe gjithëpërfshirëse ndaj sfidave globale dhe, për këtë qëllim, angazhohet me qeveritë, shoqërinë civile dhe organizatat fetare, duke krijuar partneritete. Teksa shumë rrjete vendore krijohen në kohë krize, RfP synon të ndërtojë struktura të qëndrueshme që vazhdojnë edhe pas krizave.

Me përkushtimin për të luftuar konfliktet e dhunshme, për të çuar përpara zhvillimin njerëzor, për të nxitur shoqëri të drejta dhe harmonike dhe për të mbrojtur mjedisin, RfP krijon hapësira që njerëzit nga besime të ndryshme që jetojnë krah për krah, të punojnë bashkë për të arritur këto qëllime. Me Rrjetin Global të Grave të Besimit¹⁰³, RfP synon të çojë përpara përfshirjen dhe udhëheqjen e grave. Me Rrjetin Rinor Ndërfetar¹⁰⁴ shfrytëzon energjinë, përkushtimin dhe krijueshmërinë e udhëheqësve të rinj fetarë, teksa sjellin vlerat morale dhe ide novatore në punën e organizatës.

RfP mbron dhe përkrah për përfshirjen e udhëheqësve të rinj fetarë dhe të institucioneve të tyre në promovimin e edukimit fetar, të kuptuarit dhe përkushtimit ndaj LFB-së, si një mënyrë për të promovuar për mirëqenien e përbashkët bazuar në respektin për dinjitetin njerëzit dhe të drejtat e njeriut. Në lidhje me LFB-në, RfP monitoron dhe zbaton programe që trajtojnë abuzimet, ngacmimet dhe diskriminimet e motivuara nga feja. Në nivel vendor, programet përfshijnë fuqizimin e udhëheqësve fetarë vendorë për t'iu kundërvënë shkeljeve të LFB-së dhe diskriminimit. RfP ka financuar edhe grante të vogla për nisma ndërfetare që ndihmojnë personat e shpërngulur nga konfliktet. Në nivel ndërkombëtar, RfP mobilizon rrjete të mëdha me aktorë të larmishëm fetarë dhe besimtarë, që të drejtojnë fushata globale.



Intervistë: Sharon Rosen

Sharon Rosen është drejtore globale e angazhimit fetar në organizatën Kërkimi për Gjuhën e Përbashkët¹⁰⁵ (*Search*), organizata joqeveritare më e madhe në botë që punon për ndërtimin e paqes. Sharon ka përvojë të gjerë në punën me LFB-në dhe në hartimin e zbatimit të programeve, që ndërtojnë bashkëpunimin përmes feve, me qëllimin për të çuar përpara paqen. Ajo e ka përfaqësuar Search-in në bashkëkrijimin dhe drejtimin e nismës Kodi Universal i Sjelljes për Vendet e Shenjta,¹⁰⁶ që është miratuar nga shumë organizata dhe institucione fetare dhe ndërfetare në mbarë botën. I shpallur në vitin 2011 bashkë me Qendrën e Oslos për Paqen dhe Të Drejtat e Njeriut, Një Botë në Dialog dhe Fetë për Paqen (RfP), Kodi Universal është një qasje shumësektoriale që e vendos angazhimin ndërfetar në zemër të tij, me qëllim që vendet e shenjta të mbrohen dhe të garantohet aksesit për adhuruesit e tyre.

Pse punoni me mbrojtjen e vendeve të shenjta/fetare?

“Shpesh më pyesin pse fokusohem te vendet e shenjta dhe jo te njerëzit. Por të dyja janë të ndërlidhura pazgjidhshmërisht, sepse vendet e shenjta simbolizojnë identitetet fetare më të thella të njerëzve dhe shpesh vihen në shënjestër për të lënduar njerëzit që i kanë për zemër këto vende. Nuk do ta harroj kurrë pikëllimin e një banori të Alepos kur pa minaren e xhamisë së madhe Umajad të shekullit XI në Siri, të shembej në vitin 2013. “*Kjo është hera e parë që qaj. Identiteti im u shkatërrua*”, tha. Njerëzit kanë lidhje aq të thellë me vendet e shenjta, sa që pësojnë traumë të madhe kur ato sulmohen. Njëkohësisht, për shkak se komunitetet e

kanë interes të përbashkët mbrojtjen e vendeve të shenjta të tyre, kjo nevojë mund t'i ndihmojë të bëhen bashkë duke kapërcyer përçarjet e konfliktit për të gjetur zgjidhje dhe për të zvogëluar dhunën.“

Si mund të mbrohen më mirë vendet e shenjta/fetare?

“Është e rëndësishme që ruajtja e vendeve të shenjta të bëhet me angazhim shumësektorial, kur është e mundur, ku të bëhen bashkë qeverisja qendrore dhe vendore, agjencitë ligjzbatuese, gjyqësori, media dhe aktorët fetarë. Kontekstet e ndryshme ofrojnë mënyra të ndryshme bashkëpunimi me udhëheqësit fetarë zyrtarë dhe jozyrtarë, duke përfshirë gratë dhe të rinjtë në ruajtjen e vendeve të shenjta”.

A mund të jepni ndonjë shembull konkret të kësaj pune në zonën e OSBE-së?

“Në vitin 2010, ne filluam të angazhohemi në Bosnjë-Hercegovinë duke përdorur qasjen shumësektoriale. Këshilli Ndërfetar atje e përshëndeti me entuziazëm nismën tonë për mbrojtjen e objekteve fetare dhe e miratoi Kodin Universal menjëherë. Këshilli hartoi një strategji sipas së cilës, nëse një vend i shenjtë sulmohej, udhëheqësit nga fe të ndryshme do ta vizitonin vendin së bashku, do ta dënonin sulmin dhe do të ftonin median. Media do të raportonte për sulmin, por edhe për solidaritetin e përbashkët të udhëheqësve fetarë. Në një incident, edhe policia u thirr në vendngjarje dhe, si rezultat i kësaj shfaqjeje solidariteti të ndërsjellë, policia u motivua të përpiqej më shumë për të kapur fajtorët. Edhe sistemi i drejtësisë u përfshi dhe, duke pasur parasysh vëmendjen e medias, u bë më efikas në trajtimin e çështjeve gjyqësore të mëvonshme. Bashkia e riparoi vendin e dëmtuar dhe, në një rast, pastori i një kisha të dhunuar kërkoi takim me autorët, gjë që rezultoi në pajtim dhe në riparimin e dëmeve nga vetë dhunuesit¹⁰⁷. Pas kësaj, pati rënie të dukshme të numrit të incidenteve”.

4.5. TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA

Shtetet duhet të garantojnë që të gjitha proceset që lidhen me konsultimet, komitetet e përbashkëta këshillimore apo mundësitë e financimit për projektet e dialogut dhe të masave të përbashkëta, të jenë transparente. Transparenca kontribuon në llogaridhënie. Në komunikimin mbi konsultimet, komitetet e përbashkëta këshillimore apo mundësitë e financimit, shtetet duhet të respektojnë detyrimet e transparencës, ku informacioni të shpërndahet në mënyrë të hapur dhe të aksesueshme për personat e përfshirë në nisma si dhe për të tjerët. Transparenca mund të ndikojë shumë në efikasitetin dhe legjitimitetin e angazhimit dhe të bashkëpunimit. Komunikimi i hapur në lidhje me hulumtimet, gjetjet dhe fondet e konsultimeve dhe të komiteteve të përbashkëta këshillimore, mund të luftojë perceptimin se ato janë


kapur nga një grup i vogël individësh apo komunitetesh specifike me interesa të ngushta personale. Në këtë drejtim, transparenca mund të promovojë përfshirjen dhe të inkurajojë angazhimin.

Shtetet duhet të lehtësojnë angazhimin e vazhdueshëm midis komuniteteve fetare apo besimtare dhe zyrtarëve shtetërorë në të gjitha nivelet, si edhe të garantojnë që kanalet e komunikimit të qëndrojnë gjithmonë të hapura. Procesi mund të bëhet më i hapur duke caktuar një pikë kontakti zyrtare dhe duke sqaruar se si mund të kontaktohet dhe si do të japin përgjigje. Gjithashtu, kur shteti thërret një konsultim, mbledhje të komitetit të përbashkët këshillimor apo dialog, përdorimi i mënyrave të shumëfishta të komunikimit dhe shpërndarja e informacionit të të gjitha organizatat ndërfetare të konsoliduara dhe të respektuara mund të ndihmojë aktorët e vegjël dhe më pak të njohur që të angazhohen. Kjo në vetvete ndërton transparencën dhe llogaridhënien, ndërkohë që më shumë organizata vihen në dijeni për proceset dhe mund të japin kontributin e tyre.

KAPITULLI 5

PROJEKTET DHE THIRRRJET PËR FINANCIM

“ Konsultimi i mirëfilltë përfshin krijimin e mundësive për të dëgjuar dhe për t’u kushtuar vëmendje të gjithë të interesuarve, duke u dhënë të gjithëve mundësinë të thonë fjalën e tyre.”



KAPITULLI 5

PROJEKTET DHE THIRRJET PËR FINANCIIM

Kur shtetet vendosin ta mbështesin dialogun dhe proceset e veprimeve të përbashkëta për çështje që lidhen me LFB-së, përpara se të përcaktojnë mënyrën se si do ta arrijnë këtë, duhet të identifikojnë problemet që po përpiqen të zgjidhin. Më pas, për t'i adresuar këto probleme si duhet, shtetet duhet të marrin në konsideratë strukturat, proceset dhe kontekstin, të cilat mund edhe të kenë nevojë për disa ndryshime. Më pas, ata mund të identifikojnë nëse projektet e dialogut dhe të veprimit të përbashkët përshtaten me zgjidhjen e propozuar si pjesë e një plani më të gjerë strategjik. Dialogu dhe proceset e veprimit të përbashkët nuk ka gjasa të zgjidhin shpejt e shpejt çështjet më të mëdha (p.sh. tensionet në komunitet); këto projekte kërkojnë kohë për të krijuar besim dhe marrëdhënie mes komuniteteve të ndryshme.



Shtetet duhet të marrin në konsideratë pozicionin e tyre në lidhje me problemin e identifikuar dhe rezultatin e pritshëm të projekteve për dialog dhe veprime të përbashkëta dhe të shohin se sa mund t'u duhet të investohen dhe sa mund të vazhdojë angazhimi i tyre. Ata duhet të mendojnë se si do të perceptohen dhe a do të besohen nga aktorët e tjerë, si dhe duhet gjithashtu të marrin në konsideratë se çfarë pritshmëri mund të sjellin projektet dhe nëse ka kohë dhe burime financiare për t'i përmbushur ato pritshmëri.

Përveç kësaj, çdo shtet duhet të shohë mundësinë e krijimit të treguesve të vet të drejtave të njeriut sa i përket LFB-së: tregues strukturorë (organet/institucionet, zakonet, ligjet, traditat, etj.), treguesit e proceseve të brendshme (politikat, procedurat, praktika, buxhetet dhe kapacitetet, duke përfshirë edhe edukimin e nëpunësve civilë në lidhje me besimet fetare, etj.), dhe treguesit e rezultateve/performancës (të dhëna konkrete që tregojnë se ku qëndron shteti sa i përket garantimit të respektimit të LFB-së për të gjithë në një shoqëri të caktuar). Ndjekja e progresit në këtë mënyrë mund të nxjerrë në pah fushat, që kanë nevojë për përmirësim. Shtetet duhet gjithashtu të marrin në konsideratë se kush mund të jetë në pozicionin më të mirë për t'i ndihmuar ata në procesin e matjes së performancës, me cilat palë të interesuara duhet të konsultohen dhe cili mund të jetë formati më i përshtatshëm i konsultimit me to.

Kur për menaxhimin e mbështetjes për konsultimet, komiteteve të përbashkëta këshillimore dhe proceseve të dialogut me aktorët e LFB-së, shtetet duhet të kërkojnë individë që i kuptojnë shumë mirë të drejtat e njeriut, duke përfshirë edhe LFB-në dhe që kanë një

edukim të mirë në lidhje me besimet fetare. Ata gjithashtu duhet të vënë në dispozicion burime për të trajnuar stafin që punon në fushën e LFB-së. Përfaqësuesit e shteteve duhet të bëjnë përpjekje për të kuptuar karakteristikat specifike fetare dhe kulturore të komuniteteve të përfshira në dialog, si dhe dinamikën brendapërbrenda këtyre komuniteteve dhe mes komuniteteve të ndryshme. Një angazhim efikas me komunitetet e feve ose të besimeve të ndryshme kërkon gjithashtu që përfaqësuesit e shteteve të kuptojnë konceptin e 'fesë së jetuar', d.m.th., se si e praktikojnë dhe si e përjetojnë njerëzit fenë në jetën e tyre të përditshme, si dhe të vlerësojnë diversitetin dhe kompleksitetin e të pasurit të disa komuniteteve fetare.

Nëse ftohen lirisht dhe vullnetarisht, zyrtarët mund të vizitojnë vendet e kultit, të marrin pjesë në aktivitetet e komunitetit ose të familjarizohen me praktikën e tyre, të shohin komunitetet në veprim, duke u kujdesur në të njëjtën kohë që të mos favorizojnë asnjë komunitet në veçanti.

Në seksionin e mëposhtëm ofrohen disa pika që duhen marrë parasysh në hartimin e projekteve (ose thirrjeve për financim) në mbështetje të dialogut dhe të veprimeve të përbashkëta përtej kufijve të fesë ose të besimeve. Ajo çka është më e rëndësishmja është se këto pyetje presupozohet të shërbejnë si udhëzuese. Në disa raste, qasjet më pak gjithëpërfshirëse të organizatave të vogla mund të kenë më shumë potencial për të sjellë ndryshime pozitive, prandaj nuk duhen përjashtuar direkt. Në raste të tilla, është mirë që shtetet të përdorin këto mjete vlerësimi për të parë se ku mund të kenë nevojë organizatat e vogla për mbështetje shtesë dhe të hyjnë në diskutime me to për t'i inkurajuar dhe për t'i ndihmuar.

5.1. PROCESI I HARTIMIT TË THIRRJEVE PËR FINANCIM

5.1.1. Konsultimet dhe komitetet e përbashkëta këshillimore

Përpara se të marrin vendime mbi temat, termat e referencës, fondet që vënë në dispozicion, apo mbi lloje të tjera mbështetjeje praktike për nisma të ndryshme, shtetet duhet të organizojnë konsultime ku përfshihen aktorë të feve dhe të besimeve të ndryshme për të kuptuar shqetësimet që lidhen me LFB-në, tensionet e mundshme që mund të ulin këto nisma dhe kapacitetet e aktorëve për zbatim projektsh. Shtetet mund edhe të zgjedhin që ta formalizojnë procesin e konsultimit, duke ngritur komitete këshillimore gjithëpërfshirëse për të kontribuar në procese të ndryshme, në çështjet ndërsektoriale me interes ose në gjuhën e përdorur në këto procese.

Konsultimi i vërtetë përfshin krijimin e mundësive për të dëgjuar dhe për t'u kushtuar vëmendje të gjithë të interesuarve, duke u dhënë mundësi të gjithëve që të thonë fjalën e vet. Shteti nuk duhet ta kufizojë angazhimin e tij tek ato grupe që bien dakord me të apo që nuk e kritikojnë qëndrimin e qeverisë. Konsultimet duhet t'u ofrojnë të gjithëve mundësinë për të mësuar. Përveç kësaj, kur shtetet angazhohen rregullisht në dialog me të gjithë aktorët fetarë dhe besimtarë në mënyrë të barabartë, do të jenë në pozita më të mira për të kuptuar se cilat çështje mund të përmirësohen ose të zgjidhen përmes dialogut dhe ta nxisin një dialog të tillë me potencialin për veprime të përbashkëta pozitive.

Përveç konsultimeve para thirrjeve, shtetet duhet të vënë në dispozicion të publikut një version paraprak të thirrjeve që publiku të mund të japë vlerësimet apo qëndrimet e tij. Sa më transparent dhe më tërheqës të jetë ky proces, aq më i madh mund të jetë angazhimi. Si rregull, aty ku jepen fonde publike, duhet të zbatohen procese të rregullta transparence dhe llogaridhënieje.

Përrjashtim nga transparenca e plotë mund të bëjnë rastet kur, pas një vlerësimi me qëllim "për të mos bërë dëm", sipas të cilit tensionet ndërmjet komuniteteve janë shumë të larta, shtetet mund të duhet që ta kufizojnë sasinë e komunikimit që herët, nëse komunikimi mund të ndikojë negativisht në pjesëmarrjen e aktorëve dhe të minojë procesin e dialogut.

Përveç kësaj, megjithëse shtetet duhet të jenë të ndjeshme ndaj dialogut pas situatave të konfliktit me komponentët ndërfetarë dhe ndërbesimtarë që mund të nxisin pajtimin, ato nuk duhet të mbështesin projekte ku bëjnë pjesë individë që janë përfshirë personalisht në nxitjen e armiqësisë ose në diskriminimin e hapur ndaj aktorëve të tjerë.

5.1.2. Hartimi i thirrjeve për financim

Thirrjet e financimit duhet të përmbajnë një listë të pikave specifike që do të financohen - zakonisht specifikimi bëhet sipas temave - dhe duhet të specifikojnë se kush ka të drejtë të aplikojë dhe cilat janë kushtet e pjesëmarrjes. Për shembull, në thirrjet për financim mund të përcaktohet se financimi jepet për krijimin e një dialogu për personat që vijnë nga fe apo besime të ndryshme për të ndërtuar marrëdhënie të shëndetshme ndërkomunitare të karakterizuara nga besimi dhe respekti. Megjithatë, nismat mund të kenë prioritete ose qëllime të tjera, duke përfshirë çuarjen përpara të LFB-së ose promovimin në përgjithësi të të drejtave të njeriut, ndërtimin e komuniteteve të bashkëlidhura, ndërtimin e paqes ose veprime të tjera të projektuara për të kontribuar në përmirësimin e shoqërisë.

5.1.3. Pyetjet kryesore për një qasje tematike

- Për çfarë rezultatesh tematike punojnë me projekte departamentet ose ekipet e tjera në institucionet përkatëse (për shembull, për komunitete të bashkëlidhura, ndërtimin e paqes apo për promovimin e të drejtave të njeriut)? A ka ndonjë mbivendosje ose a është nxjerrë ndonjë mësim?
- Cilat janë rreziqet e një qasjeje tematike të caktuar, ose një qasjeje që është në përputhje ose që lidhet me prioritetet e politikave të tjera? Për shembull, a do t'i mirëprisnin komunitetet e feve ose të besimeve të ndryshme prioritetet dhe kuadrin e financimit nga shteti? A do të aplikonin pjesëmarrësit 'më të mirë' dhe a do të ishin në gjendje të kontribuonin në mënyrë domethënëse?

5.2. VLERËSIMI I APLIKIMEVE

Qëllimet dhe rezultatet e çdo projekti zakonisht vlerësohen sipas kriterëve të paracaktuara, si qëllimet, origjinaliteti, cilësia, përshtatshmëria, qëndrueshmëria, koherenca, fizibiliteti, qartësia, plotësia, motivimi ose diversiteti. Aplikimet për financim që kërkojnë të angazhojnë komunitetet dhe aktorët në dialog dhe në veprime të përbashkëta për të promovuar LFB-në dhe të drejta të tjera, duhet të vlerësohen sipas kriterëve të tilla. Shtetet duhet ta bëjnë të qartë se mbi çfarë të dhënash duhet të mbështeten propozimet (a duhet të ketë aplikimi edhe një hartëzim të plotë) dhe si duhet të dorëzohen ata. Është gjithashtu e rëndësishme të merren parasysh edhe rreziqet që mund të paraqesin projektet e propozuara dhe potenciali i tyre për të bërë dëm.

5.2.1. Hartëzimi

Aplikimet duhet të përmbajnë një hartëzim të hollësishëm të palëve të interesuara dhe të projekteve ekzistuese ose të projekteve të mëparshme në lidhje me çështjet që trajtojnë propozimet. Kjo duhet të vlerësohet duke e krahasuar me hartëzimin e vetë shtetit.

5.2.2. Pyetjet kryesore për t'u siguruar që propozimet janë të bazuara në të dhëna:

- A ka zhvilluar aplikanti konsultime apo ka krijuar komitete të përbashkëta këshillimore për të kuptuar se si e perceptojnë palët e interesuara çështjen që projekti kërkon të trajtojë?
- Sa e kupton aplikanti kontekstin në mënyrën që ai kontekst përjetohet nga komunitetet e feve dhe të besimeve të ndryshme? A janë marrë në konsideratë mospërputhjet brendapërbrenda komunitetit, si ato që

vijnë prej gjinisë, moshës etj., në formulimin e propozimit? A mund të ketë pengesa (p.sh. diskriminim ose shkelje të të drejtave) të cilat mund të bëhen shkak, që aplikanti të mos marrë pjesë?

- Sa i njohur është aplikanti me palët e interesuara që punojnë në fushën e dialogut dhe veprimit të përbashkët përtej kufijve të feve dhe të besimeve të ndryshme, ose në fushën e LFB-së dhe me ndikimin që ato kanë (p.sh. me grupet parlamentare, forumet shumëkombëshe për LFB-në/dialogun ose për konfliktet/zhvillimet ndërkombëtare me komponentë fetarë që kanë ndikim në komunitetet vendore, organizatat e shoqërisë civile, grupet me bazë besimi ose aktivistët vendorë)?

5.2.3. Zbatimi i projektit

Aktivitetet e dialogut formal dhe joformal duhet të shihen si plotësuese dhe të dyja duhet të merren parasysh gjatë hartimit të strategjive në këtë fushë. Qëllimi i përgjithshëm i një nisme duhet të jetë arritja e përfshirjes së të gjithë gamës së komuniteteve fetare ose të besimeve në shoqëri. Dialogu dhe veprimet e përbashkëta duhet të marrin në mënyrë domethënëse në konsideratë përvojat unike të jetuara të personave që preken nga sfidat që nismat e ndryshme kërkojnë të zgjidhin. Nëse ka të dhëna nga proceset e regjistrimit të popullsisë, këto të dhëna mund të na vijnë në ndihmë. Më pas, mund të jetë e rëndësishme të shihet, nëse një aplikim i caktuar vjen vetëm nga një komunitet fetar ose besim, apo nga një koalicion i gjerë ose nga një rrjet grupesh të ndryshme; nëse përfshin grupe abrahamike dhe/ose joabrahamike, teiste dhe/ose joteiste/ateiste.

Megjithëse, shtetet duhet të përcaktojnë në mënyrë transparente dhe objektive kriteret e vlerësimit për vlerësimin e aplikimeve, ato nuk duhet të përdorin fondet e tyre për të kontrolluar zhvillimin e proceseve të dialogut; duhet të jenë aplikantët – komunitetet, organizatat dhe individët ata që në fund, vendosin mbi nismat e tyre, duke përfshirë zbatimin e projekteve, kush merr pjesë në to dhe qëllimet që duan të arrijnë.

Në zhvillimin e çfarëdolloj projekti, aplikantët mund të hasin disa vështirësi që duhen trajtuar që në fillim. Një prej këtyre sfidave është fakti që dialogu dhe aktivitetet e veprimeve të përbashkëta prirën të tërheqin njerëz që kanë marrë pjesë edhe më parë në projekte të ngjashme. Me vlerë mund të jetë përfshirja në nisma të tilla edhe e njerëzve që nuk marrin pjesë zakonisht në to, por që i njohin mirë këto tema, si akademikët ose profesionistët që punojnë në fushën e LFB-së.

Në të njëjtën kohë, aktivitetet e dialogut prirën të tërheqin njerëzit e arsimuar që dinë t'i shprehin qartë idetë e tyre; këta janë zakonisht profesionistë më me përvojë. Është e rëndësishme që shteti ta pasqyrojë këtë në aktivitetet e komunikimit dhe që aplikantët të demonstrojnë se e njohin këtë dinamikë dhe kanë analizuar nëse forma

të ndryshme dialogu mund të përmirësojnë aksesueshmërinë dhe diversitetin e grupit. Këtu mund të përfshihen edhe forma të lehtësimit të dialogut, të cilat përpunohen paraprakisht që të angazhojnë të gjithë, p.sh., duke iu ofruar personave që e kanë të pamundur pjesëmarrjen, mundësinë që të kontribuojnë me shkrim, ose duke siguruar përkthim, gjuhën e shenjave, etj.

5.2.4. Pyetjet kryesore në lidhje me zbatimin e projektit

- Projektet shpesh ndërtohen në mënyrë që pjesëmarrësit të marrin pjesë në biseda të strukturuar mbi disa pyetje të caktuara. Sa e mundur është kjo për pjesëmarrësit që flasin një gjuhë të dytë (apo të tretë), apo për personat me aftësi të kufizuara? Çfarë ndikimi mund të ketë kjo te procesi? Si është përpjekur aplikanti të kapërcejë këto pengesa?
- A e ka konsideruar aplikanti ngurrimin që mund të vijë nga organizata (p.sh., sekulare) ndaj idesë së partneritetit me aktorë nga komunitete të ndryshme fetare ose besimi dhe anasjelltas, dhe cilat janë strategjitë e zbutjes?
- Pjesëmarrësit e mundshëm ndonjëherë mund të supozojnë gabimisht se u duhet nivel i lartë njohurish shkencore rreth fesë dhe besimit për të marrë pjesë. Ky është rasti i rrallë. Si do të hartohet dhe të promovohet propozimi për t'u siguruar që pjesëmarrësit e mundshëm të mos vetëpërgjashtohen?
- Nëse një projekt synon pjesëmarrës më të rinj në moshë, si është hartuar për të kapërcyer disa nga problematikat e perceptimit që lidhen me dialogun dhe aktivitetet e përbashkëta të veprimit përtej kufijve fetarë dhe atyre besimtarë?
- Dialogu dhe veprimet e përbashkëta shumë shpesh rezultojnë në shkëmbimin e njohurive dhe ideve të reja. A ka zgjidhje krijuese më të përshtatshme për paraqitjen, regjistrimin dhe shpërndarjen e rezultateve sesa raportet e thata dhe botimet e shkruara? (Kjo mund të përfshijë informacion në gjuhë të ndryshme të pakicave, formate të lexueshme dhe aksesueshmëri dixhitale).
- Kur aplikanti shqyrton përdorimin e zgjidhjeve më krijuese, a e ka menduar se si mund të perceptohet kjo nga audienca e synuar? A ka zgjidhje që me shumë gjasa dekurajojnë pjesëmarrjen e përfituesve të mundshëm (p.sh., kontekstet /mjediset dhe axhendat si në konferencë, kundrejt mjedisëve shumë pjesëmarrës ku të gjithë vendosen në baza të barabarta dhe rezultati prodhohet bashkërisht), duke ditur që jo të gjithë pjesëmarrësit preferojnë të njëjtën qasje?
- Çfarë masash propozohen për të garantuar që hapësirat/mjediset që përdoren janë të sigurta ose neutrale për pjesëmarrësit?

- A është realizuar aksesueshmëria e duhur nisur nga specifikat e grupeve që do të marrin pjesë, me qëllim që të shtrohet bazamenti për veprim të përbashkët?

5.3. MATJA E NDIKIMIT DHE SUKSESIT

Përpara se të vendoset për alokimin e fondeve, duhet konstatuar nëse projekti është ideuar për të sjellë ndryshim përmes dialogut dhe veprimit të përbashkët përtej kufijve fetarë dhe besimtarë, si dhe për të nxitur më tej tolerancën, respektin dhe mirëkuptimin. Shtetet duhet të sigurohen se projektet që financojnë të kenë integruar vlerësim adekuat në hartimin e projektit, përmes të cilit të maten sukseset dhe sfidat. Kjo mundëson modifikim të projektit gjatë zbatimit dhe ka ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë e tyre.

Ndërsa efektiviteti i kostos është një dëshirë legjitime për shtetet që merren me kërkesat për financim, rezultatet, vlera dhe ndikimi afatgjatë i proceseve të dialogut nuk mund të mos jenë as menjëherë të dukshme, as të lehta për t'u matur. Disa nisma mund të zgjidhin çështje praktike të menjëhershme me interes të ndërsjellë, ndërsa disa të tjera mund të sjellin përfitime të dukshme vetëm me kalimin e kohës. Gjithashtu, mund të jetë e vështirë të inkuadrohet lidhja e drejtpërdrejtë shkakësore ndërmjet aktiviteteve që rezultojnë nga dialogu dhe rezultateve të projektit në nivel shoqëror. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se asgjë nuk duhet të matet; shtetet duhet të jenë në gjendje të vlerësojnë nëse paratë janë përdorur mirë. Dialogu dhe propozimet e projektit të veprimit të përbashkët duhet të përfshijnë matje të përafërta për të vlerësuar ecurinë duke përdorur, për shembull, tregues të përbërë dhe sondazhe të bazuara në aftësi apo perceptim.

5.3.1. Pyetjet kryesore që lidhen me matjen e ndikimit dhe suksesit

- A ka përdorur aplikanti një model logjik ose ka paraqitur një tablo konkrete se çfarë rezultatesh synon të arrijë procesi dhe si mund të vlerësohet ecuria ose mungesa e saj?
- A kuptohet qartë në projekt problemi që kërkon të trajtojë?
- A ka zhvilluar projekti një deklaratë të qartë të objektivave kryesore? Kjo vlen pavarësisht qëllimit, p.sh., nëse objektivat synojnë pjesëmarrës individualë, komunitete më të gjera apo ndryshime të gjera shoqërore, si p.sh. përmes reformës ligjore.
- A ka projekti një kornizë të qartë të rezultateve që do të kontribuojnë në këto objektiva?
- A tregon projekti se si synon të arrijë objektivat e veta?
- Cilat janë supozimet kryesore që mbështesin këtë projekt?

- Çfarë risqesh janë identifikuar që mund të kufizojnë suksesin e projektit dhe a ka një “plan rezervë”? A kanë kryer një analizë bazike SWOT¹⁰⁸ ose analizë PESTLE¹⁰⁹? Për shembull, aplikantët mund të analizojnë faktorë të tillë si konfliktet në vende të tjera me përbërës të identitetit fetar ose të besimit, të cilat mund të vënë në rrezik nismat vendore ku komunitetet identifikohen me “bashkëbesimtarët” jashtë shtetit.
- Si e ka integruar aplikanti monitorimin dhe vlerësimin në hartimin e projektit?
- Cilët tregues cilësorë dhe sasiorë janë përzgjedhur?
- A ekziston një proces vlerësimi i vazhdueshëm që mundëson përshtatjen e projektit, apo është një aktivitet i vetëm?
- A mund të zbatohen masat e vlerësimit gjatë gjithë ciklit të projektit dhe të shërbejnë si pikë referimi për nisma të ardhshme? (Këta tregues tregojnë se ku projektet kanë qenë të suksesshme dhe aplikantët madje mund të sugjerojnë se si mund të përmirësohen. Shembujt mund të përfshijnë: numrin e dialogëve, diversitetin e pjesëmarrësve, numrin e deklaratave të përbashkëta të lëshuara në një periudhë të caktuar, vlerësimet e perceptimit të pjesëmarrësve përmes intervistave, ose numrin e ndërhyrjeve mbështetëse të lidhura me LFB-në me një aktor shtetëror. Nuk ka gjasa që një tregues i vetëm të mjaftojë për të kuptuar siç duhet ndikimin e projektit, por disa tregues të marrë së bashku mund të ndihmojnë për të pasur një tablo më gjithëpërfshirëse.)
- A e shpjegon aplikanti bindshëm qëndrueshmërinë e këtij projekti dhe çfarë parashikon të bëjë më pas?

KAPITULLI 6

LISTA E KONTROLLIT PËR SHTETET

“ A keni marrë parasysh gamën e aftësive, kapacitetin dhe përvojën e ekipit tuaj për të arritur rezultate të suksesshme? ”

KAPITULLI 6

LISTA E KONTROLLIT PËR SHTETET

Dialogu dhe veprimet e përbashkëta përtej kufijve fetarë dhe besimtarë mund të realizohen në nivele të ndryshme. Kjo listë kontrolli orienton shtetet që synojnë të krijojnë mjedis të favorshëm në mbështetje të nismave të tilla, që përfshin, por nuk kufizohet në aspektet më poshtë:

VLERËSIMI I NEVOJËS

01

Problemi që duhet adresuar dhe rezultati i dëshiruar

Duke menduar për problemin që synoni të adresoni, a është kryer analiza situacionale për të kuptuar kontekstin e gjerë?

- Cila është nevoja që po përpiqeni të adresoni?
- Pse keni zgjedhur të fokusoheni në këtë problem të veçantë?
- Cilat janë shkaqet kryesore të këtij problemi?
- Cili është rezultati/qëllimi i dëshiruar në trajtimin e këtij problemi të veçantë?
- A është ky rezultat/qëllim i pajtueshëm me promovimin e LFB-së dhe të drejtave të tjera të njeriut?
- Pse/si mendoni se dialogu apo nismat e veprimit të përbashkët do të kontribuojnë në zgjidhjen e këtij problemi?
- Konkretisht, çfarë duhet të jetë ndryshe në të ardhmen krahasuar me sot?
- Cilat janë supozimet themelore që informojnë këtë nismë të mundshme dialogu?

02

Prioritizimi përkundër detyrimit ligjor

Duke menduar për problemin që synoni të adresoni, a janë konsideruar ndikimet ligjore të përgjigjes?

- A është shteti ligjërisht i detyruar t'i përgjigjet problemit në fjalë?
- Nëse nuk ka detyrim ligjor për t'u përgjigjur, cila është vlera e shtuar e veprimit të shtetit në këtë fushë?
- A ka korniza të tjera ligjore që rregullojnë angazhimin e shtetit me aktorët fetarë ose besimtarë që do të ndikojnë në ndonjë nismë që mund të keni?
- A mbart rreziqe angazhimi i shtetit në këtë fushë?
- A do të ishte një aktor tjetër joshjetëror në pozitë më të mirë për t'u përgjigjur?
- Pas kryerjes së vlerësimit “mos bëj dëm” për çdo veprim shtetëror të parashikuar për të adresuar problemin e identifikuar, a është angazhimi i shtetit zgjidhja më e mirë?

- A është trajtimi i këtij problemi/investimi në këtë fushë prioritet afatgjatë, apo ka të ngjarë që prioritetet të ndryshojnë (nëse po, si pasqyrohet te rezultatet e mundshme?)

03

Përshtatja strategjike

Duke menduar për problemin që synoni të adresoni, a keni menduar si lidhet me aktivitetet, synimet dhe rezultatet e shtetit në nivel më të gjerë?

- Si përshtatet ky qëllim brenda strategjisë më të gjerë shtetërore?
- A ka veprime të ndërmarra nga kolegë/organe të tjera shtetërore që do ta mbështesin/minojnë këtë synim?
- A është organi shtetëror ku punoni në pozitën më të mirë për të arritur këtë qëllim?
- Si do t'ua komunikoni homologëve veprimet në këtë fushë?
- Çfarë hapash konkretë do të ndërmerrni për të arritur qëllimin?
- Çfarë hapash të tjerë do të ndërmerrni dhe cilat janë afatet e propozuara?
- A përshtaten të gjithë këta hapa së bashku si pjesë e një kuadri më të gjerë strategjik?
- Cilat janë pasojat e mundshme të paqëllimshme të një nisme të tillë?
- Kush mund të përfitojë apo të humbasë nga nisma të tilla?

VLERËSIMI I KONTEKSTIT

04

Perceptimi i shtetit

Gjatë hartimit të nismës, a keni faktorizuar mënyrën se si shteti perceptohet nga pjesëmarrësit, nga komunitete të ndryshme fetare dhe besimtare?

- A perceptohet shteti si aktor i besuar dhe madje i barabartë (ose i paanshëm) nga ata që dëshiron të angazhohen?
- A ka ndonjë fe/besim të preferuar shtetëror?
- Si ka vepruar dhe reaguuar në përgjithësi shteti në të kaluarën për të mbrojtur të drejtat e njeriut të individëve me prejardhje nga komunitetet fetare apo besimtare?
- Cili është historiku i shtetit në mbrojtjen e të drejtave të njeriut për të gjithë?
- A ka një shtet ligjor funksional dhe a mund të presin të gjithë nga shteti trajtim të drejtë dhe të barabartë pa diskriminim për asnjë shkak?
- Çfarë pengesash/mundësish mund të hasni duke pasur parasysh perceptimet e shtetit?
- A kundërshtojnë aktorët shtetërorë stereotipet/paragjykimet e komuniteteve fetare ose besimtare në deklaratat publike dhe komunikimet e tjera, veçanërisht për tema që shkaktojnë polarizim ose ankthe sociale; a janë të heshtur/shpërfillës, apo përkundrazi, i rrënjosin edhe më shumë ato?

- Kur shtetet komunikojnë dhe reagojnë ndaj ngjarjeve të rëndësishme ndërkombëtare ose gjeopolitike, a sigurohen që përgjigjet e tyre diplomatike, humanitare ose ligjore të jenë gjithëpërfshirëse dhe të mos perceptohen si diskriminuese)?

05

Hartëzimi i nismës dhe palëve të interesit

Gjatë hartimit të nismës, sa të përditësuar e keni informacionin për aktivitete të ngjashme dhe për aktorët në shtetin tuaj?

- A ekzistojnë aktorë dhe/ose procese të tjera të bazuara në besim dhe/ose laikë për të adresuar këtë problem?
- A janë krijuar nisma të tjera dialogu ose veprimi të përbashkët përtej kufijve fetarë ose besimtarë për të adresuar këtë problem ose nevoja të tjera në kontekstin tuaj ose në kontekste të ngjashme?
- A keni të dhëna nga censi që tregojnë përbërjen fetare të popullsisë?
- A jeni në dijeni të përbërjes së komuniteteve të pakicave fetare ose besimtare brenda vendit tuaj?

06

Korniza e mosmarrëveshjeve dhe tensioneve vendore

Gjatë hartimit të nismës, si i faktorizoni përvojat e komuniteteve të ndryshme fetare dhe besimtare që lidhen me shtetin tuaj?

- A keni konsideruar sfidat më të gjera me të cilat mund të përballen komunitetet?
- A keni konsideruar çekuilibrat e pushtetit midis aktorëve fetarë ose besimtarë të cilët mund të angazhohen në dialog?
- A ka një konflikt të vazhdueshëm ose tensione sociale që prekin pjesëmarrësit?
- Si janë kornizuar këto tensione dhe cilat janë efektet e mundshme të diskriminimit strukturor dhe dhunës mbi komunitete të caktuara?
- A luan rol media në shtetin tuaj në nxitjen e tensioneve apo në ruajtjen e paqes?
- A do të binin dakord të gjitha komunitetet fetare dhe besimtare?
- A është (shihet) shteti (si) i anshëm ndaj një grupi apo një tjetri, apo si garant i paanshëm i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të secilit?

GATISHMËRIA E BRENDSHME

07

Diagnoza e brendshme dhe gatishmëria për të vepruar

Në përgatitje për të nxitur dialog apo veprim të përbashkët më të gjerë, a keni konsideruar gamën e aftësive, kapacitetin dhe përvojën e ekipit tuaj për të arritur rezultate të suksesshme?

- A angazhohen përgjithësisht ekipi juaj dhe/ose kolegët që punojnë në strukturat shtetërore me komunitetet fetare dhe besimtare?
- A keni ju ose kolegë të tjerë përvojë dhe procese për t'u angazhuar me segmente të ndryshme të komuniteteve fetare dhe besimtare?
- Nëse po, sa efektive janë këto procese?
- A do të ketë rezistencë të brendshme ndaj idesë për t'u angazhuar me këtë fushë apo me aktorë/komunitete të caktuara?
- Sa i larmishëm është ekipi juaj dhe a mund të përfitoni nga ky diversitet në nismën tuaj?

- A keni nevojë ju ose ekipi juaj për buxhet shtesë, kapacitete, sisteme ose trajnime shtesë, p.sh., për të drejtat e njeriut, komunikimin jo të dhunshëm, ndërmjetësim dhe edukim fetar për të kryer punën në këtë fushë?
- A ekziston ndonjë boshllëk njohurish apo fusha që kërkojnë hulumtime të mëtejshme?
- Cilët faktorë mund të forcojnë kapacitetin tuaj për të mbikëqyrur punën ku angazhohen komunitetet fetare dhe besimtare (dhe jo vetëm për çështjet fetare) dhe për të garantuar qasje bazuar në të drejtat e njeriut?

08

Plani i Veprimit

Në përgatitjet për ofrimin e mbështetjes për dialogun apo projektet e veprimeve të përbashkëta, a keni hartuar dokumente solide për të artikuluar qartë qëllimin dhe drejtimin e ardhshëm të mbështetjes dhe për të paraqitur se si do të jetë suksesi?

- A i keni përcaktuar veprimet e nevojshme për të arritur qëllimin?
- A e dini se çfarë mbështetje jeni gati të ofroni dhe si do t'u drejtoheni komuniteteve të feve dhe besimeve të ndryshme dhe aktorëve të tjerë të shoqërisë civile?
- A i keni marrë parasysh rreziqet që lidhen me veprimet që propozoni?
- A keni përcaktuar një buxhet real? Si/kur do ta matni suksesin tuaj?
- Si do ta monitoroni dhe vlerësoni përparimin drejt objektivave strategjikë duke mbështetur dialogun dhe nismat e veprimit të përbashkët përtej kufijve fetarë dhe besimtarë?
- A keni përcaktuar një grup të plotë treguesish?
- A do të përfshini komente nga aktorë të tjerë?
- Si do t'i përfshini rishikimet në mënyrë që të përshtatni qasjen, të mësoni nga përvojat dhe të përmirësoheni vazhdimisht?
- Sa i qëndrueshëm është plani juaj?

09

Përgatitja e kanaleve të qarta të komunikimit

Në përgatitjet për t'u angazhuar me aktorët për të nxitur dialog apo veprim të përbashkët më të gjerë, a keni krijuar një proces për të komunikuar informacionin në lidhje me nismën te palët e ndryshme të interesuara?

- A ka pika qendrore apo kontakti që merren me komunitetet fetare ose besimtare, të cilët mund të koordinojnë në mënyrë transparente komunikimin nga shteti dhe të marrin dhe t'u përgjigjen pyetjeve nga komunitetet fetare ose besimtare dhe/ose aktorët e shoqërisë civile të angazhuar në dialog dhe në veprime të përbashkëta përtej kufijve të fetare apo besimtare?
- A janë pikat e kontaktit të paanshme dhe a i trajtojnë të gjitha komunitetet në mënyrë të barabartë?
- A ka pengesa gjuhësore dhe komunikimi për të kapërcyer, apo lloje të veçanta të gjuhës që duhen shmangur? A është gjuha me ndjeshmëri gjinore?
- Cili proces i marrjes së përshtypjeve do t'ju ndihmojë të vlerësoni përgjegjshmërinë dhe paanshmërinë (të perceptuar dhe reale) të pikave të kontaktit?

10

Përgatitja e ambienteve të përshtatshme

Në përgatitjet për zhvillimin e konsultimeve, takimeve të komitetit të përbashkët këshillimor apo për mbështetjen e dialogut apo masës së përbashkët, a keni menduar për logjistikën praktike për pjesëmarrësit?

- A keni menduar nëse mund të ofroni hapësira neutrale fizike dhe/ose online?
- A keni marrë parasysh faktorë të tillë si mënyra se si do të ulen pjesëmarrësit dhe përdorimin e titujve për të mos krijuar përshtypjen e asimetrisë së pushtetit apo ndjenjën e ofendimit, si dhe aksesin dhe akomodimin për personat me aftësi të kufizuara dhe grupe të tjera me nevoja të veçanta?
- A e keni marrë parasysh se si ndikon organizimi i aktiviteteve në hapësira virtuale?
- A do të mundësonte kjo një pjesëmarrje ndryshe?
- A keni marrë parasysh mbrojtjen e privatësisë dhe të të dhënave dhe nevojën për të krijuar hapësira të sigurta ku çdo i pranishëm të mund të flasë lirshëm dhe pa frikë nga hakmarrja/bullizimi

ANGAZHIMI ME KOMUNITETET FETARE DHE BESIMTARE

11

Komunikimi me komunitetet e feve dhe të besimeve të ndryshme dhe me aktorë të tjerë të shoqërisë civile

Teksa mendoni për aktorët me të cilët doni të konsultoheni apo që dëshironi t'i inkurajoni që të angazhohen në dialogun apo veprimin e përbashkët të financuar/mbështetur nga shteti me qëllim që të arrini sukses, a jeni shprehur plotësisht qartë për komunikimin dhe angazhimin me këta aktorë?

- Kush do të ishte i interesuar për mbështetjen nga shteti?
- A e kanë pasur mundësinë ose a do t'u jepet mundësia të ndajnë perspektivën e tyre, dhe si do të garantoni që zërat e tyre të dëgohen?
- A po e kufizoni angazhimin vetëm tek ata që janë dakord me qeverinë dhe që nuk e kritikojnë qëndrimin e qeverisë?
- A kanë mundur komunitetet të zgjedhin pjesëmarrësit/përfaqësuesit e tyre për takimet e ndërmjetësuara nga shteti dhe a kanë pasur kohë për të gjetur bashkëbisedues të përshtatshëm?
- A e keni marrë parasysh gjuhën e përdorur në komunikim dhe implikimet se kush mund të reagojë (drejtuesit/aktorët zyrtarë dhe jozyrtarë, gratë, të rinjtë, komunitetet e shumicës, pakicat etj.)? A jeni përpjekur të siguroheni, që kur vendosni afatet, të merrni parasysh festat fetare dhe a i keni bërë mesazhet lehtësisht të kuptueshme në mënyrë që procesi të jetë sa më transparent dhe të ketë sa më shumë ndikim?
- A e keni shpërndarë informacionin edhe në rrjetet ekzistuese që punojnë për ndërtimin e paqes, të drejtat e njeriut dhe lirinë e fesë ose besimit, si dhe në rrjetet e feve të ndryshme dhe ato të shoqërisë civile që mund të përfaqësojnë komunitete dhe struktura fesh dhe besimesh të ndryshme?
- A po i shqyrtoni mënyrat e ndryshme ku informohen segmente të ndryshme të popullsisë për t'u siguruar për komunikimin me ta, ku përfshihet përshtatja e komunikimit sipas mënyrave të informimit apo investimi edhe në burime të tjera për të garantuar këtë komunikim?

12

Pjesëmarrja gjithëpërfshirëse dhe e barabartë në procese të mbështetura nga shteti

Kur mendoni se si mund të integrohen praktikat e gjithëpërfshirjes (sidomos ato që lidhen me fenë, moshën dhe gjininë) në punën e shtetit, cilat mund të jenë sfidat gjatë ndërveprimit me komunitetet dhe drejtuesit vendorë të feve dhe të besimeve të ndryshme?

- A i ftoni rregullisht komunitetet e feve dhe të besimeve të ndryshme që të kontribuojnë në diskutime dhe procese të drejtuara nga shteti për çështje të ndryshme me interes për ta (jo vetëm çështje fetare) së bashku me aktorë të tjerë të shoqërisë dhe a i nxisni që të kontribuojnë në çështje urgjente për shoqërinë në përgjithësi (përpara se të realizohen proceset përkatëse)?
 - Çfarë masash ndërmerri për t'u siguruar që proceset të jenë gjithëpërfshirëse, si për shembull duke siguruar barazi mes brezave dhe gjinive të ndryshme dhe mundësinë për të kontribuar në diskutime dhe për të ndikuar në rezultate?
 - Si mund ta lehtësoni përfshirjen e zërave të ndryshme nga komunitetet pa struktura formale?
 - Si siguroheni që të gjithë të ndihen të sigurt/komodë për t'u shprehur në aktivitete me prani fizike që organizohen nga shteti, pavarësisht nëse përfaqësojnë komunitete tradicionale apo të sapokrijtura, të mëdha apo të vogla, teiste, joteiste apo ateiste apo identifikohen në baza të tjera, si p.sh. si "racë"/etni, gjini, apo si një kombinim karakteristikash të shumëfishta të identitetit?
 - A mbahen konsultimet, takimet e përbashkëta të komitetit këshillimor, ose aktivitetet me prani fizike në datat e duhura/në kohë të përshtatshme për një numër sa më të madh palësh të interesuara?
 - A janë lehtësuesit/moderatorët e dialogut të mirëtrajnuar dhe të vetëdijshëm për kontekstin/çështjet e LFB-së dhe dinamikat e pushtetit në mjedisin ku do të operojnë?
 - A i merrni parasysh edhe nevojat e grupeve më të vogla dhe më pak të strukturuar nëse janë në gjendje të aplikojnë për fonde dhe t'i menaxhojnë ato apo kriteret tuaja janë barrë e madhe për ta?
 - A e keni menduar se sa mund të ndikojnë në grupe të caktuara fondet që vihen në dispozicion, si p.sh. a nxisni pasjen e projekteve edhe për gratë dhe të rinjtë, si dhe nëse do të ishin ato të dobishme?
-

13

Integrimi i qasjes me në qendër të drejtat e njeriut në të gjitha ndërveprimet me komunitetet fetare dhe besimtare

Kur mendoni se si mund të nguliten në mendje qasjet me në qendër të drejtat e njeriut në punën që mund të bëni në shtetin tuaj, cilat mund të jenë sfidat gjatë ndërveprimit me komunitetet dhe drejtuesit vendorë të feve dhe të besimeve të ndryshme?

- A i respektoni të drejtat e individëve të çdo komuniteti fetar ose besimi pa diskriminim?
- A keni integruar një qasje që ka në qendër plotësisht të drejtat e njeriut, në kriteret e përdorura për të vlerësuar, nëse duhet ta mbështesni apo jo një projekt apo nismë për dialog dhe veprim të përbashkët?
- A angazhoheni me komunitetet e feve ose të besimeve të ndryshme duke qenë të hapur ndaj diversitetit të plotë të aktorëve fetarë ose besimtarë, teistë, joteistë dhe ateistë?
- A verifikoni nëse ata që pretendojnë se përfaqësojnë një komunitet të caktuar, janë realisht përfaqësues legjitimë të atij komuniteti?
- A verifikoni nëse, në situatat pas konfliktit, ata që mbështeten – për shembull, për të marrë pjesë në konsultime, komitete të përbashkëta këshillimore, apo për të përfituar fonde ose vlerësim me çmime - janë përfshirë personalisht në nxitjen e armiqësisë ose diskriminimit e hapur të aktorëve të tjerë?

14

Platformat për përhapjen e praktikave të mira dhe për inkurajimin e barazisë

A po shihni mundësinë e ofrimit të mundësive që në shtetin tuaj të formohen partneritete të reja mes komuniteteve të feve dhe të besimeve të ndryshme përmes organizimit të dialogëve ose veprimeve të përbashkëta?

- A ofroni mundësi rrjetëzimi për individë dhe organizata me të njëjtën mendësi që merren me dialogun dhe aktivitetet e veprimeve të përbashkëta?

15

Marrja e masave që politikat arsimore të promovojnë aktivisht të drejtat e njeriut, duke përfshirë respektin për LFB-në dhe vlerësimin për pluralizmin dhe diversitetin mes feve dhe besimeve të ndryshme

Deri në çfarë mase janë integruar në hartimin e nismës së planifikuar, aspektet se si ndikon arsimi publik në shtetin tuaj në aftësinë e komuniteteve të feve dhe të besimeve të ndryshme për të kontribuar pozitivisht në proceset e dialogut dhe të veprimeve të përbashkëta?

- A zbatoni politika arsimore efikase që synojnë të forcojnë respektimin, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke luftuar njëkohësisht supozimet e bazuara në paragjykime dhe koncepte të papajtueshme me LFB-në?
- A siguroheni që sistemet dhe kurrikulat arsimore të nxisin njohjen dhe respektin më të madh të feve ose të besimeve të ndryshme, si dhe vlerësimin për pluralizmin dhe diversitetin mes feve/ besimeve të ndryshme dhe rëndësinë e ruajtjes së dinjitetit të genësishtëm njerëzor të çdo personi?

16

Ngritja e zërit kundër urrejtjes dhe veprimet për parandalimin e krimeve të urrejtjes

Si merret në konsideratë ndikimi i politikave të ndryshme në parandalimin e krimeve të urrejtjes në shtetin tuaj në nismën e planifikuar? Në veçanti, si mundën këto politika të rrisin aftësinë e komuniteteve të feve dhe të besimeve të ndryshme për të kontribuar pozitivisht në dialog dhe veprime të përbashkëta?

- A e ngrini menjëherë zërin kundër mbrojtjes së urrejtjes, gjë që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi apo dhunë për shkak të fesë apo të besimit, apo për shkaqe të tjera të kombinuara?
- A i evidentoni publikisht pasojat mbi komunitetet e feve dhe të besimeve që vijnë për shkak të formave të caktuara të shprehjes që mund të mos arrijnë pragun e përgjegjesisë penale/juridike, por që dërgojnë prapëseprapë një mesazh përjashtimi?
- A i mbulon si dhe sa duhet korniza ligjore krimet e urrejtjes?
- A u përgjigjeni me forcë krimeve të urrejtjes kur ato ndodhin?
- A mblidhni të dhëna të ndara për krimet e urrejtjes dhe a i përdorni ato të dhëna për të hartuar politika të mirinformuara?
- A u ofroni mbështetjen e duhur viktimave të urrejtjes (përtej procedimeve penale për krimet e urrejtjes ose nxitjen e dhunës), duke përfshirë mbështetjen psikosociale ose rritjen e fondeve në mbështetje të viktimave përmes masave të organizatave vendore apo në komunitet?

17

Garantimi i barazisë, transparencës dhe llogaridhënies në mbështetje të nismave për dialog

Si janë përfshirë në hartimin e nismës së planifikuar aspektet si mënyra e trajtimit nga shteti të proceseve vendore të tenderimit, sidomos ato që lidhen me përvojat e komuniteteve të feve dhe të besimeve të ndryshme?

- A veproni si garant i paanshëm në çdo proces financimi?
- A trajtohen sa dhe si duhet nëpunësit civilë që punojnë me komunitetet e feve dhe të besimeve të ndryshme dhe a angazhohen ata efektivisht në mënyrë të paanshme me aktorët e feve dhe të besimeve të ndryshme?
- A janë në gjendje komunitetet e feve/besimeve të ndryshme dhe palët e tjera të interesuara të bëjnë pyetje dhe të marrin përgjigjet përkatëse brenda afateve të arsyeshme kohore për çdo proces mbështetjeje/financimi?
- A keni marrë masa për transparencë dhe llogaridhënie të plotë gjatë përcaktimit të kriterëve të financimit, administrimit, vlerësimit, raportimit mbi ndikimin e nismave përkatëse dhe mbi vazhdimësinë e tyre?
- A keni marrë parasysh edhe vlerësimin e palëve të interesuara në programin e mbështetjes/financimit që do të zbatoni?

18

Krijimi i vizibilitetit për nismat pozitive në nivele të ndryshme (edhe jashtë shtetit)

Çfarë mundësish dhe përfitimesh ekzistojnë për promovimin e dialogut dhe veprimeve të përbashkëta ku angazhohet edhe shteti në forume të ndryshme (duke përfshirë edhe forumet ndërkombëtare)?

- A i vini në dukje shembujt pozitivë të dialogut dhe të veprimeve të përbashkëta përtej kufijve të feve dhe të besimeve të ndryshme dhe a dilni me deklaratë në mbështetje të tyre duke theksuar nismat ku grupet punojnë së bashku për të trajtuar probleme konkrete në kuadrin e të drejtave të njeriut?
- Nëse jo, a është kjo diçka që mund ta konsideroni dhe në cilat forume?
- A keni parë mundësinë e dhënies së çmimeve vlerësuese për njerëzit ose organizatat e përfshira në drejtimin e projekteve të suksesshme të veprimit të përbashkët?

KAPITULLI 7

PËRFUNDIM

“ Dialogu dhe proceset e veprimit të përbashkët nuk janë një zgjidhje e atypëratyshme, por duhet të jenë pjesë e një strategjie afatgjatë. ”

KAPITULLI 7

PËRFUNDIM

Në këtë udhëzues shihet se nuk janë shtetet ato që duhet t'i udhëheqin apo t'i menaxhojnë proceset e dialogut dhe të veprimit të përbashkët përtej kufijve të feve dhe të besimeve të ndryshme, por janë disa arsye për të cilat shtetet duhet të shohin mundësinë e mbështetjes së proceseve të tilla si elemente të rëndësishme drejt shoqërive paqësore dhe pluraliste. Në të vërtetë, rëndësia e dialogut është konfirmuar vazhdimisht nga shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së. Standardet e të drejtave të njeriut dhe angazhimet e OSBE-së nuk vijnë me një plan zbatimi hap pas hapi; një qasje e tillë, e njëjtë për të gjithë, nuk do të merrte parasysh specifikat e konteksteve, nevojave dhe ndjeshmërive të ndryshme. Megjithatë, në këtë udhëzues ofrohen një sërë rekomandimesh se si shtetet mund të luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e dialogut dhe proceseve të veprimit të përbashkët që kalojnë kufijtë e feve ose të besimeve të ndryshme. Në të trajtohen edhe disa faktorë që shtetet duhet t'i marrin parasysh kur vendosin çfarë duhet të mbështesin dhe si.

Dialogu dhe proceset e veprimit të përbashkët nuk janë një zgjidhje e atypëratyshme, por duhet të jenë pjesë e një strategjie afatgjatë. Në këtë udhëzues theksohet se sa e rëndësishme është që shtetet të reflektojnë së brendshmi dhe të jenë të gatshëm të angazhohen në mbështetjen e nismave të tilla në mënyrë strategjike dhe kuptimplote. Në të përcaktohen edhe faktorët kryesorë që ndihmojnë në krijimin e një mjedisi të favorshëm për dialog dhe veprim të përbashkët: mbrojtja, promovimi dhe lehtësimi i LFB-së (ndër të tjera edhe promovimi i të drejtave të njeriut), qasja 'mos bëj dëm', paanshmëria, aksesueshmëria dhe gjithëpërfshirja, transparencja dhe llogaridhënia. Së fundi, në këtë udhëzues ofrohen disa këshilla praktike se si mund të angazhohen shtetet në mbështetjen e konsultimeve, komiteteve të përbashkëta këshillimore dhe në financimin e projekteve në mënyra të tilla që optimizojnë rezultatet. Në Kapitullin 7 ofrohet një listë kontrolli praktike, por jo joshteruese, për shtetet, bazuar në informacionin e paraqitur në këtë udhëzues. Shtojcat përmbajnë një përmbledhje të informacionit të mbledhur nga shtetet pjesëmarrëse si pjesë e një sondazhi të kryer nga ODIHR-i për qëllime të këtij publikimi, si dhe disa udhëzime për lehtësuesit e dialogut.

Ky udhëzues është pjesë e punës së ODIHR-it për të ndihmuar shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së në promovimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave të njeriut nëpërmjet institucioneve të forcuara demokratike, që çojnë drejt një sigurie më të madhe. Përveç këtij udhëzuesi, ODIHR-i fton palët e interesuara, duke përfshirë edhe zyrtarët e shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së, të konsultohen edhe me burime të tjera të publikuara në faqen e internetit të ODIHR-it.



SHTOJCAT

SHTOJCA 1

UDHËZIME PËR LEHTËSUESIT E DIALOGUT

Dialogu duhet të drejtohet gjithmonë nga një lehtësues i paanshëm, i cili mund të ndihmojë në trajtimin e diskutimeve të vështira dhe të inkurajojë pjesëmarrësit drejt disa sjelljeve/parimeve që duhet të respektohen gjatë një dialogu. Ky i fundit duhet të shërbejë për të krijuar besim dhe për të çuar përpara bashkëpunimin. Ndonjëherë, disa çështje të ngritura për diskutim paraqiten si shqetësimet kryesore, por kur nisin diskutimet del qartë se ka çështje, tabu ose sfida të tjera edhe më të rëndësishme për t'u adresuar. Njerëzit mund të diskutojnë për qëndrime të ndryshme, por pa bërë të ditura interesat ose nevojat e tyre. Ata që drejtojnë dialogun duhet të jenë të gatshëm që gjatë gjithë dialogut të kuptojnë nëse duhet, apo jo ta ndryshojnë kursin apo nëse duhet apo jo të përfshijnë edhe aktorë të tjerë.

Dialogët produktivë shpesh strukturohen rreth një sërë sjelljesh që lehtësuesit e trajnuar mund t'i nxisin edhe më shumë.

- Në kontekstin e një dialogu, një individ nuk mund të përfaqësojë kurrë një komunitet të tërë; prandaj, drejtuesi duhet të inkurajojë përdorimin e përemrit “Unë” dhe shprehjeve si “Unë besoj se...”, “Në përvojën time...” etj.
- Dialogu duhet të inkurajojë shkëmbimet e sinqerta dhe duhet t’u kujtojë pjesëmarrësve që të flasin vetëm për gjëra që nuk i kanë problem t’i ndajnë.
- Dialogu duhet t’i inkurajojë pjesëmarrësit që ta dëgjojnë njëri-tjetrin me vëmendje dhe duke u mësuar pjesëmarrësve se si mund ta bëjnë këtë, kur e kanë të vështirë të dëgjojnë apo të dëgjojnë. Disa nga shkaqet që nuk na lënë të dëgjojmë me vëmendje janë: ndjesia e paragjykitimit ose njëanshmërisë; dallimet gjuhësore ose thekse të caktuara; zhurmat; shqetësimet, frika ose zemërimi; mospërqendrimi dhe shpërqendrimet e jashtme. Një lehtësues i frytshëm i dialogut i ndihmon pjesëmarrësit dhe zhvillon disa mekanizma dhe mënyra ndërhyrjesh që çojnë në zbutjen e këtyre pengesave dhe në kapërcimin e tyre, atë ku është e mundur.
- Shfaqja e normave shoqërore gerontokratike mashkullore, stereotipeve dhe e një gjuhe të caktuar (p.sh. thirrjet për respektimin e më të mëdhenjve kur shprehet një mendim ndryshe ose mospranimi

i angazhimit të grave si një qëndrim që nuk është në përputhje me 'rolin' e tyre) në proceset e dialogut mund t'i bëjë të rinjtë, gratë dhe vajzat që të mos ndihen pjesë e dialogut. Një lehtësues i mirë dialogu duhet t'u japë drejtim këtyre sjelljeve.

- Lehtësuesit duhet t'i inkurajojnë pjesëmarrësit që të jenë mendjehapur. Dialogu nuk duhet të fokusohet në debate që nuk çojnë asgjekundi apo që shndërrohen në një lloj gare për të përcaktuar se kush ka më shumë 'të drejtë', por duhet të bëjë të mundur që secila palë të mësojë diçka gjatë procesit. (Pjesëmarrësit mund të përballen me akuza/dyshime nga vetë komunitetet e tyre se do të 'bëhen njësh me palën tjetër' apo se do të humbasin identitetin e tyre fetar, gjë që mund t'i bëjë ata të mos angazhohen më gjerë dhe më thellë).
- Dialogu është më shpesh produktiv nëse pjesëmarrësit respektojnë ndjenjat e njëri-tjetrit. Pjesëmarrësit mund të mos pajtohen me pikëpamjet e njëri-tjetrit, por një lehtësues duhet t'i inkurajojë ata dhe t'u kujtojë që të respektojnë çdo person dhe ndjenjat e tij. Kur një person lëndohet, lehtësuesi duhet t'i japë palës së lënduar mundësinë të shpjegojë se pse ndodhi kështu. Kjo u ofron palëve mundësi për të mësuar.

Lehtësuesit duhet t'i inkurajojnë pjesëmarrësit që të bien dakord për përdorimin e një gjuhe të përbashkët ose të një 'marrëveshjeje për mënyrën se si do të punojnë'. Kjo u jep atyre mundësinë për të përcaktuar bashkërisht përkufizimet e termave kyçë dhe për të diskutuar çdo qëllim të dialogut për të garantuar angazhimin e barabartë të të gjithë pjesëmarrësve.

SHTOJCA 2

PYETJET E SONDAZHIT

- 1. Nga cili shtet pjesëmarrës i OSBE-së jeni?**
- 2. Ju lutemi jepni emrin, titullin, institucionin dhe e-mailin e pikës së kontaktit për këtë sondazh.**
- 3. A mund të na thoni se në cilën nga fushat e mëposhtme janë të përfshirë aktorët joshitetërorë në dialogun mes feve dhe besimeve të ndryshme dhe në aktivitete partneriteti:**
 - Promovimi i lirisë së fesë ose besimit (p.sh., puna për sigurinë e vendeve të adhurimit, avokimi për ndryshime legjislative në këtë fushë, konfidencialiteti i informacionit të privilegjuar që u jepet drejtuesve të komuniteteve);
 - Përveç promovimit të feve ose të besimeve të ndryshme, edhe promovimi i të drejtave të njeriut;
 - Ndërgjegjësimi për adresimin e çdo keqinterpretimi të komuniteteve të feve dhe të besimeve të ndryshme në media dhe/ose në jetën publike;
 - Promovimi i tolerancës dhe i mosdiskriminimit;
 - Promovimi i jetës kulturore dhe/ose i diversitetit kulturor;
 - Ofrimi i shërbimeve sociale;
 - Edukimi mbi tolerancën;
 - Avokimi për ndryshime në legjislacion dhe/ose politikë.
- 4. Ju lutemi, a mund të jepni disa shembuj nismash konkrete në këto fusha?**
- 5. Ju lutemi, a mund të jepni informacion në lidhje me aktivitetet që promovojnë lirinë e fesë ose të besimit nëpërmjet aktiviteteve me përfshirjen e feve ose të besimeve të ndryshme?**
 - Cilët aktorë, institucione apo organizata i mundësojnë këto nisma?
 - Cilët aktorë, institucione apo organizata marrin pjesë në këto nisma (aktorë fetarë dhe/ose laikë)?
 - Çfarë ndikimi kanë ato?
- 6. Si ka ndikuar pandemia COVID-19 te nismat e feve ose të besimeve të ndryshme në vendin tuaj?**

- 7.** A janë shfaqur nisma të reja të feve ose të besimeve të ndryshme si rrjedhojë e pandemisë COVID-19?
- 8.** Në cilat aktivitete angazhohet shteti për mbështetjen e dialogut mes feve ose besimeve të ndryshme?
 - Duke financuar nisma për dialog mes feve ose besimeve të ndryshme;
 - Takimet ose ofrimi i aktiviteteve për dialog për aktivitete të tilla;
 - Në ngritjen e kapaciteteve të komuniteteve të feve dhe besimeve të ndryshme;
 - Aktivitete të tjera;
 - Shteti nuk përfshihet në aktivitete të tilla.
- 9.** Nëse shteti e mbështet dialogun mes feve dhe besimeve të ndryshme në vend, si e bën këtë? (p.sh., cilët aktorë shtetërorë janë të përfshirë? A ka ndonjë departament apo ekip të caktuar që angazhohet në aktivitete të tilla? A ka një fokus të caktuar në çështjet apo punët e brendshme në aktivitetet ndërkuftare/ndërkombëtare?)
- 10.** Cilat sfida dhe mundësi identifikohen në vendin tuaj si mbështetje dhe lehtësim i aktiviteteve të dialogut mes feve ose besimeve të ndryshme? (p.sh., A keni krijuar partnerë që përfaqësojnë demografinë? A keni besim te partnerët? A shihni një gamë të gjerë aktorësh të përfshirë në aktivitete të tilla, p.sh., gratë, të rinjtë, pakicat fetare, aktorët laikë, aktorët e njohur dhe aktorët më të rinj? A janë aktivitete të tilla të përhapura në të gjithë vendin apo të përqendruara kryesisht në zona të caktuara? Si e monitoroni apo e vlerësoni ndikimin e nismave të tilla?)
- 11.** Për proceset e sponsorizuara nga shteti që lidhen me dialogun mes feve ose besimeve të ndryshme, si garantohet një pjesëmarrje e gjerë dhe e barabartë mes aktorëve të ndryshëm?
- 12.** A ka ndonjë informacion tjetër që dëshironi ta ndani me ODIHR-in?

SHTOJCA 3

PËRMBLEDHJA E PËRGJIGJEVE TË SONDAZHIT

Llojet e mbështetjes shtetërore

- Në të gjithë zonën e OSBE-së, shtetet e mbështesin dialogun mes feve dhe besimeve të ndryshme në mënyra të ndryshme.
- Disa japin financim ose lloje të tjera mbështetjeje (p.sh., një vend takimi ose një platformë për koalicionet e veprimeve të përbashkëta) pa u përfshirë në thelbin dhe rezultatin e dialogut. Shtete të tjera angazhohen më tepër në këto çështje, ndonjëherë si pjesë e një politike specifike shtetërore ose përmes strukturave shtetërore të ngritura në nivel vendor dhe/ose kombëtar.
- Kur shtetet krijojnë struktura që sjellin bashkë grupe të ndryshme (zakonisht) fetare, ato priren të jenë kryesisht forume ku shteti konsultohet me përfaqësuesit e grupeve fetare për çështje që lidhen me jetën fetare.
- Në disa shtete, ekzistojnë (zakonisht) struktura/zyrtarë qeveritarë të mandatar për shqyrtimin e çështjeve që lidhen me jetën/komunitetet fetare. Ata mund edhe të organizojnë takime periodike të përfaqësuesve të grupeve fetare.
- Në varësi të marrëveshjes shtet-fe, disa shtete nuk ofrojnë asnjë lloj financimi apo mbështetje materiale për dialogun, por angazhohen me aktorët e feve dhe të besimeve të ndryshme për një sërë çështjesh dhe i përdorin informacionet e mbledhura për të punuar për krijimin e një mjedisi edhe më të favorshëm.
- Disa shtete e përqendrojnë angazhimin, mbështetjen dhe financimin e tyre për grupet fetare kryesore (me ose pa një komponent që shkon përtej kufijve të feve dhe të besimeve të ndryshme) dhe të pakëta janë shtetet që raportuan se i përfshijnë të gjitha këto grupe.
- Në disa dialogë mes feve dhe besimeve të ndryshme përfshihen edhe aktorë të shoqërisë civile, në varësi të kontekstit dhe temës së dialogut.
- Disa shtete i trajtojnë shkëmbimet mes feve ose besimeve të ndryshme apo mbështetjen për LFB-në si pjesë të aktiviteteve të tyre ndërkulturore.

- Disa shtete të tjera raportuan se në programet e tyre të mësimdhënies në shkolla, përfshijnë edhe pjesë mbi traditat e ndryshme fetare ose mbajnë konsultime në proceset që lidhen me arsimin.

Niveli i angazhimit

- Angazhimi i shtetit me aktorët që përfaqësojnë fe dhe besime të ndryshme, sidomos kur ky angazhim është i formalizuar, priret të realizohet kryesisht në nivel kombëtar, ku shteti angazhohet në mënyrë proaktive me liderët tradicionalë.
- Disa shtete angazhohen edhe në nivel lokal.

Fushat e angazhimit ndërkomunitar në dialogun dhe veprimin e përbashkët

- Në disa zona të OSBE-së, dialogu dhe bashkëpunimi ndërfaqetar realizohet rreth çështjeve me interes të ndërsjellë, si kthimi i pronës ose aksesit i të burgosurve në shërbime fetare.
- Angazhimi me shtetin, i nisur qoftë nga shteti apo vetë komunitetet, realizohet edhe rreth çështjeve të sigurisë, adresimit të krimit të urrejtjes dhe trajnimit të agjencive ligjzbatuese. Aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve shtetërore në këtë fushë mund të përfshijnë pjesëmarrjen e disa grupeve fetare.
- Në disa shtete pjesëmarrëse, organizatat dhe strukturat fetare përfshihen fuqimisht në ofrimin e shërbimeve sociale, ndërsa në kontekste të tjera, organizatat dhe strukturat fetare përfshihen në dialogun ndërfaqetar dhe ndërbesimtar, por jo domosdoshmërisht në ofrimin e shërbimeve sociale, gjë që është kryesisht në fushën e veprimit të shtetit.
- Disa shtete raportuan se janë aktivë në ndërtimin e paqes ndërkombëtare përmes dialogut ndërfaqetar.
- Disa shtete vunë në dukje se strukturat fetare ishin aktive gjatë pandemisë Covid-19, duke ofruar informim dhe shërbime për të gjitha segmentet e popullsisë, pavarësisht prejardhjes fetare apo besimit.
- Disa shtete mbështetën nismat ndërfaqetare dhe/ose ndërbesimtare gjatë pandemisë; disa vunë re rritje të pjesëmarrjes në shërbesat fetare, për shkak të mundësisë së pjesëmarrjes *online*.
- Pjesëmarrja në jetën fetare si e tillë, si dhe aftësia për të ushtruar plotësisht LFB-në, u bënë gjithashtu temë diskutimi gjatë pandemisë.
- Në disa shtete, nisma të reja ndërfaqetare u formuan gjatë pandemisë. Për shembull, një shtet raportoi një nismë që synonte mbështetjen e përpjekjeve për vaksinim, duke ndarë informacionin shëndetësor dhe duke rritur aksesin e barabartë, pavarësisht nga përkatësia fetare apo besimi.

FUNDSHËNIMET

Të gjitha linqet janë aksesuar më 23 gusht 2024.

1. Zotimet e OSBE-së për Dimensionin Njerëzor: Vëllimi 1, Përmbledhje Tematike (Botimi i 4-t), OSBE/ODIHR, 27 prill 2023.
2. Lehtësimi i Ndërmjetësimit dhe Dialogut në OSBE, Udhëzues Referencë, OSBE, 13 nëntor 2014, faqe 10.
3. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Kombet e Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme, Rezoluta 217A e miratuar më 10 dhjetor 1948, neni 18.
4. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Kombet e Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme, Rezoluta 2200A (XXI) e miratuar më 16 dhjetor 1966, neni 18, pika 1.
5. Sekularizmi - a është i mirë apo i keq për lirinë e fesë dhe besimit? OSBE/ODIHR, 1 prill 2022.
6. Bertrand Jayles, Siew Ann Cheong, Hans J. Jermann, Ndërveprimet ndërmjet komuniteteve përmirësojnë qëndrueshmërinë e shoqërive multikulturore tek Fizika A: Mekanizmi statistikor dhe aplikimet e tij, vëll. 607, 1 dhjetor 2022, 128164.
7. Vendimi i Këshillit Ministror të OSBE-së, nr. 4/03, "Toleranca dhe Mosdiskriminimi" (MC. DEC/4/03, Maastricht, 2 dhjetor 2003.
8. Vendimi i Këshillit Ministror të OSBE-së, nr. 3/13, "Liria e Mendimit, Ndërgjegjës, Fesë dhe Besimit", (MC. DEC/3/13, Kiev, 6 dhjetor 2013.
9. Konferenca për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë, Akti përfundimtar i Helsinkit, KSKE, 1 gusht 1975, Kapitulli VII.
10. Liria e Fesë dhe Besimit dhe Siguria: Orientim për Politikën, OSBE/ODIHR, 9 shtator 2013.
11. Fabio Petito, Stephanie Berry dhe Maria Mancinelli, Strategjitet e Angazhimit Ndërfetar: instrument politikash për të avancuar lirinë e fesë dhe besimit, Universiteti i Saseksit, 2018.
12. Takimi Suplementar i Dimensionit Njerëzor (SHDM) I 2017 mbi Lirinë e Fesë ose Besimit: Problemet, Mundësitë dhe Sfidat Specifike të Luftës ndaj Antisemitizmit, Intolerancës dhe Diskriminimit ndaj të Krishterëve, Muslimanëve dhe Pjesëtarëve të Feve të tjera, Kryesia austriake e OSBE-së dhe ODIHR-it, Vjenë, 22-23 qershor 2017; dhe, Takimi Suplementar i Dimensionit Njerëzor (SHDM II) 2023 mbi Rolin e Shoqërisë Civile në Promovimin dhe Mbrojtjen e Tolerancës dhe Mosdiskriminimit, Kryesia e Maqedonisë së Veriut e OSBE-së dhe ODIHR-it, Vjenë, 26-27 qershor 2023.
13. Për sa i përket mësimdhënies, kjo përfshin edhe lirinë e prindërve dhe të kujdestarëve ligjorë që edukimi fetar dhe moral i fëmijëve të tyre të jetë në përputhje me bindjet e tyre dhe kapacitetet zhvilluese të fëmijës. Shih edhe PNDPCP, neni 18, pika 4, si dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijës, Kombet e Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme, rezoluta 44/25 e miratuar më 20 nëntor 1989, neni 14, pika 2.
14. Shih, për shembull, nenet 6(b) dhe (f). Deklarata e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së (UNGA) për Eliminimin e të Gjitha Formave të Intolerancës mbi bazën e Fesë apo Besimit; Rezolutën 2005/40, pika 4(2) e Komisionit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut; si dhe Rezolutën 6/37, pika 12(h) e Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut.
15. Përdorimi i termit "racë" në këtë udhëzues nuk nënkupton pranimin nga OSBE/ODIHR të ndonjë teorie bazuar në ekzistencën e racave të ndryshme. Ky është një term që përdoret gjerësisht në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, si dhe në legjislacionet e brendshme.
16. PNDPCP, nenet 2, 4, 18 dhe 26; Deklarata për Eliminimin e të Gjitha Formave të Intolerancës dhe Diskriminimit mbi bazën e Fesë apo Besimit, Kombet e Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme, rezoluta 36/55 e miratuar më 25 nëntor 1981; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (PNDESK), Kombet e Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme, rezoluta 2200A (XXI), neni. 2(2); Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), nenet 2, 3.
17. Heiner Bielefeldt, Nazila Ghanea & Michael Wiener, Liria e Besimit ose Fesë: Komentari mbi të Drejtën Ndërkombëtare, (Oxford: Oxford University Press, 2016), f. 553-557.
18. Për më shumë informacion mbi këtë të drejtë, duke përfshirë edhe lidhjen e saj me të drejta të tjera, ju lutemi shihni këtë seri videosh: Të kuptojmë të drejtën/lirinë e fesë dhe besimit, OSCE/ODIHR, 2022.
19. Komenti i Përgjithshëm nr. 22 (48) (neni 18), Kombet e Bashkuara, Komiteti i të Drejtave të Njeriut, takimi i 1247-të (sesioni i dyzet e tetë), 20 korrik 1993.
20. Raporti i Raportuesit Special për lirinë e fesë dhe besimit, Kombet e Bashkuara (A/HRC/34/50), Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i të Drejtave të Njeriut, (sesioni i tridhjetë e katërt), 17 janar 2017, pika 30.
21. Për shembull, në italisht, *interconfessionale* përdoret ("confessione" është termi me të cilën kushtetuta italiane u referohet komuniteteve fetare në përgjithësi, ndërsa në rusisht janë të paktën dy terma që përdoren si sinonime: *межконфессиональный диалог/interconfessional dialogue* dhe *межрелигиозный диалог/ dialog ndërfetar.*

22. [Shih, për shembull, Arsyetimi e Shkrimeve të Shenjta, faqja e internetit e Programit Ndërfetar të Kembrixhit, Universiteti i Kembrixhit.](#)
23. [Është e vërtetë që në nivel ndërkombëtar është njohur fakti se vlerat e përbashkëta njerëzore të shprehura në tërë spektrin e feve dhe besimeve mund të jetë forcë e fuqishme për ruajtjen e dinjitetit, të drejtave dhe vlerën e barabartë të gjitha qenieve njerëzore \(shih: p.sh., Deklaratën e Bejrutit të vitit 2018 “Besimi për Të Drejtat”, Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut \(OHCHR\), 28 qershor 2018; si dhe Planin e Veprimit për Udhëheqësit dhe Aktorët Fetare për parandalimin e Nxitjes së Dhunës që mund të Çojë në Krime Mizore \(Plani i Veprimit\), Zyra e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Gjenocidit dhe Përgjegjësinë për të Mbrojtur, 2017.](#)
24. [Po aty, Deklarata e Bejrutit e vitit 2018 “Besimi për Të Drejtat”.](#)
25. [OHCHR, Deklarata e Bejrutit.](#)
26. [#Instrumentet Besimi për të Drejtat, Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut \(OHCHR\), 1 janar 2020.](#)
27. [Fetë, Besimet dhe të Drejtat e Njeriut: Qasja “Besimi Për të Drejtat” - kurs në internet, Instituti i Paqes i SHBA-së, Akademia Globale Gandhi-King.](#)
28. [Udhëzues për Lehtësuesit e trajnimit “Besimi për të Drejtat”, Qendra Ndërkombëtare për Ligjin dhe Studimet Fetare \(ICLRS\).](#)
29. [Paketa e Trajnimit “Besimi për të Drejtat”, Besimi për Të Drejtat dhe Akademia e Besimit për Të Drejtat, 2022.](#)
30. [Türk bën thirrje për masa që adresojnë urrejtjen fetare, fjalim nga Volker Türk, Komisioneri i Lartë i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, në sesionin e 55-të të Këshillit të të Drejtave të Njeriut – Diskutim paneli mbi kundërvënien ndaj urrejtjes që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi ose dhunë, 8 mars 2024.](#)
31. [Liliya Sazonova, Roli i dialogut ndërfetar në procesin e mbrojtjes dhe zbatimit të të drejtave të njeriut botuar në *Journal for the Study of Religions and Ideologies* 3 \(7\):170-181 \(2004\).](#)
32. [Qasja bazuar në të drejtat e Njeriut, Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut \(ENNHRI\), faqja e internetit.](#)
33. [Treguesit Ilustrativë për LFB-në, A/75/385: Raport i Ndërmjetëm i Raportuesit Special për lirinë e fesë dhe besimit, Ahmed Shaheed: Eliminimi i të gjitha formave të intolerancës fetare, OHCHR, 12 tetor 2020.](#)
34. [Projekti “Atlasi për të Drejtat e Pakicave Fetare dhe Besimtare” identifikon fushat prioritare dhe treguesit për matjen e ecurisë si dhe të dhënat që mund të ndihmojnë shtetet në vlerësimin e ecurisë së tyre në krijimin një mjedis të favorshëm për pakicat fetare dhe besimtare që kërkojnë të ushtrojnë të drejtat e tyre në Shtete Anëtare të caktuara të BE-së.](#)
35. [Udhëzime për Rishikimin e Legjislacionit në lidhje me Fenë dhe Besimin, OSBE/ODIHR, 28 shtator 2004.](#)
36. [Në vitin 2022, qeveria e SHBA-së vlerësonte se popullsia e ishullit ishte 1.3 milion banorë. Sipas censit të 2021-shtit, popullsia në territorin e kontrolluar nga qeveria ishte 918.100 banorë. Të dhënat e censit të 2011-ës për territorin e kontrolluar nga qeveria treguan se 89.1% e popullsisë ishin të krishterë ortodoksë, 2.9% katolikë romakë \(latinë\), 2% protestantë, 1.8% myslimanë, 1% budistë, 0.5% katolikë maronitë, si dhe 0.3% ortodoksë armenas, si dhe popullata të vogla me hebrej, dëshmitarë të Jehovait dhe Bahai. Shih Raportin e SHBA-së për Lirinë Ndërkombëtare Fetare, Seksioni 1: Demografia Fetare, Qipro, 2022, Departamenti i Shtetit i SHBA-së.](#)
37. [Deklarata të Përbashkëta, Zyra e Rrugës Fetare drejt Procesit të Paqes të Qipros \(nën kujdesin e Ambasadës së Suedisë\).](#)
38. [Shih *Handyside k. Mbretërisë së Bashkuar* \[GjEDNJ, 1976\], pika 49; PNDÇP neni. 20 \(2\); shkaqe të tjera të parashikuara në nenet 19\(3\) dhe 20\(1\); Lordi Singh i Uimbëldonit, Bisedimet ndërfetare duhet të shkojnë përtej çajit dhe samosës, thetimes.co.uk, 22 korrik 2017.](#)
39. [A/HRC/55/47: Urrejtja mbi bazën e fesë apo besimit - Raportuesi Special për lirinë e fesë dhe besimit, OHCHR, mbajtur në Këshillin e Të Drejtave të Njeriut të OKB-së në sesionin e 55-të, 8 janar 2024, Seksioni II, pika 7.](#)
40. [Po aty, Seksioni IIIB, pika 13.](#)
41. [Po aty, seksioni VB, pika 4.](#)
42. [Plani i Veprimit i Rabatit, OHCHR, 5 tetor 2012.](#)
43. [Luftimi i Gjuhës së Urrejtjes, Rekomandimi CM/Rec\(2022\)16, Këshilli i Evropës, 20 maj 2022.](#)
44. [Adresimi i gjuhës së urrejtjes përmes edukimit: udhëzues për politikëbërësit, UNESCO dhe Zyra e OKB-së për Parandalimin e Gjenocidit dhe Përgjegjësinë për të Mbrojtur, 2023.](#)
45. [Kodi i sjelljes në kundërvënien ndaj gjuhës së urrejtjes së paligjshme në internet, Komisioni Evropian, 2016.](#)
46. [Akti i Shërbimeve Digjitale, Komisioni Evropian, hyrja në fuqi më 17 shkurt 2024.](#)
47. [Prozhektorët te Inteligjenca Artificiale dhe Liria e Shprehjes, Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias, 20 janar 2022.](#)
48. [Kimlya dhe të tjerë k. Ruisë, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut \(kërkesat nr. 76836/01 dhe 32782/03, vendimi i 1 tetorit 2009\), pika 4; *Dëshmitarët e Jehovait të Moskës dhe të tjerë k. Ruisë*, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut \(kërkesa nr. 302/2\), vendimi i 10 qershorit 2010, pika 101; *Gorzeliq dhe të tjerë k. Polonisë*, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut \(kërkesa nr. 44158/98\), vendimi i 17 shkurtit 2004, pika 52; dhe *Sidropoulos dhe të tjerë k. Greqisë*, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut \(kërkesa nr. 26695/95, vendimi i 10 korrikut 1998\), pika 31.](#)
49. [Udhëzime për Personalitetin Juridik të Komuniteteve Fetare dhe Besimtare, OSBE/ODIHR, 4 shkurt 2015.](#)
50. [Udhëzime për Lirinë e Asocimit, OSBE/ODIHR, Komisioni i Venecias, 1 janar 2015, Parimi 7 dhe pikat 200-223.](#)

51. Po aty, Parimi 7; Raport i Raportuesit Special për të drejtat e lirisë së tubimit paqësor dhe asociimit, Maina Kiai, A/HRC/23/39, Kombet e Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i të Drejtave të Njeriut, sesioni i njëzet e tretë, 24 prill 2013, pikat 18-42; shih edhe ekspertët e të drejtave të OKB-së nxisin Indinë që të shfuqizojë ligjin që kufizon aksesin e OJQ-ve në financime të huaja thelbësore, OHCHR, 16 qershor 2016.
52. Shih, për shembull, Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së që evokojnë "kundërvënien ndaj financimit të terrorizmit", p.sh. Rezolutat 1373 (2001), 2133 (2014), 2178 (2014), 2199 (2015) dhe sidomos Rezolutën 2462 (2019).
53. Shih për shembull: Gjeorgjia: Opinion mbi nismat legislative për transparencën dhe rregullimin e shoqatave të financuara nga jashtë të ashtuquajturat "Ligjet e agjentëve të huaj" dhe legjislacioni të ngjashëm, si dhe përputhshmëria e tyre me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, OSBE/ODIHR, 20 tetor 2023; Bosnja-Hercegovina: Mendim i përbashkët për Projektligjin e Republikës Srpska për Regjistrin Special dhe publicitetin e Punës së Organizatave Jofitimprurëse, OSBE/ODIHR dhe Komisioni i Venecias, 12 qershor 2023; Opinion i ndërmjetëm urgjent për projektligjin "Për organizatat joqeveritare jofitimprurëse" dhe projektndryshimet ligjore për "Përfaqësuesit e huaj": Republika e Kirgistanit, OSBE/ODIHR, 12 dhjetor 2022.
54. Udhëzime për Lirinë e Tubimit Paqësor: Botimi i dytë, OSBE/ODIHR, Komisioni i Venecias, 25 tetor 2010.
55. Këshilli i Ministror i OSBE-së, Vendimi nr. 9/09 "Lufta ndaj Krimeve të Urrejtjes", Athinë, 2 dhjetor 2009.
56. Të kuptojmë Krimet e Urrejtjes kundër Myslimanëve - Adresimi i Nevojave të Sigurisë të Komuniteteve Myslimane: Udhëzues Praktik, OSBE/ODIHR, 15 maj 2020.
57. ESTAR: Forcimi i mbështetjes për viktimat e kimit të urrejtjes, faqja e internetit e projektit të OSBE/ODIHR.
58. Krimet e Urrejtjes Antisemite, OSBE/ODIHR, 18 shtator 2019.
59. Praktikat shtetërore dhe roli i shoqërisë civile në lidhje me incidentet e përdhosjes së teksteve fetare, përfshirë djegien e Kur'anit, OSBE/ODIHR (pritet të publikohet në 2024).
60. Parimet Udhëzuese të Toledos për Mësimdhënien rreth Feve dhe Besimeve në Shkollat Publike, OSBE/ODIHR, 27 nëntor 2007.
61. Adresimi i Antisemitizmit përmes Arsimit: Mjetet ndihmëse të Mësimdhënies, Mjetet Ndihmëse 1: Rritja e njohurive rreth hebrenjve dhe judaizmit, OSBE/ODIHR, 4 dhjetor 2009, faqja 1.
62. Po aty.
63. Shih p.sh.: Mos Bëj Dëm, faqja e internetit e projektit të CDA-së për të nxënë bashkëpunues, ose, Mos Bëj Dëm: Mbështetje Ndërkombëtare për Shtetformimin, OECD, 24 dhjetor 2009.
64. Rekomandimet e Oslos për të Drejtat Gjuhësore të Pakicave Kombëtare, OSCE/HCNM, 1 shkurt 1998.
65. Udhëzimet e Lubjanës për Integrimin e Shoqërive Diverse, OSCE/HCNM, 7 nëntor 2012.
66. Shih, për shembull, Komenti i Përgjithshëm nr. 22 i CCPR-së: neni 18 (Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë), Kombet e Bashkuara, Komiteti i të Drejtave të Njeriut, takimi i 1247-të (sesioni i dyzet e tetë), 30 korrik 1993.
67. A/HRC/37/49 Raport i Raportuesit Special për lirinë e fesë dhe besimit, OKB, Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i të Drejtave të Njeriut (sesioni i tridhjetë e dytë), 28 shkurt, pikat 78 dhe 81.
68. Raporti i Raportuesit Special për lirinë e fesë dhe besimit, (A/HRC/25/58), Kombet e Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i të Drejtave të Njeriut, sesioni i njëzet e pestë, 26 dhjetor 2013, pika 37.
69. Parimet e Strasburgut për dialogun ndërfetar brenda Këshillit të Evropës, Këshilli i Evropës.
70. Parimet në lidhje me Statusin e Institucioneve Kombëtare (Parimet e Parisit), Kombet e Bashkuara, Rezoluta 48/134 e Asamblesë së Përgjithshme, 20 dhjetor 1993.
71. Në vitin 2021, Shërbimi Statistikor Kombëtar i Gjeorgjisë vlerësoi se popullsia ishte 3.7 milion banorë. Censi i vitit 2014 vërente se pjesëtarët e Kishës Ortodokse Gjeorgjiane përbënin 83.4% të popullsisë, myslimanët 10.7% dhe pjesëtarët e Kishës Apostolike Armene 2.9%. Pjesa e mbetur prej 3% përbëhej nga katolikë, jezidë, grekë ortodoksë, hebrenj, një numri në rritje të grupeve fetare të përcaktuara nga ligji si "jotradicionale" si baptistët, dëshmitarët e Jehovait, pentekostalët, episkopatët dhe Shoqëria Ndërkombëtare e Ndërgjegjes Krishtanë, si edhe individë që deklarohen pa përkatësi fetare (Burimi: Raporti për Lirinë Fetare Ndërkombëtare 2022: Gjeorgji, Departamenti i Shtetit i SHBA-së).
72. Shih faqen e internetit Tolerantoba.ge.
73. Shih: Katherine Marshall dhe Susan Hayward, me Claudia Zambra, Esther Bregier dhe Sarah Jackson, Gratë në Ndërtimin e Paqes Fetare, Instituti i Paqes i OKB-së, Dialogu i Zhvillimit të Besimeve Botërore, Qendra Berklej për Fenë, Paqen dhe Çështjet Botërore në Universitetin e Xhorxhtaunit (Uashington DC; USIP, 2011).
74. Për më shumë informacion mbi këtë temë, shih: Dalia Goodhardt dhe Sharon Rosen, Qasja e Përbashkët ndaj Angazhimit Fetar: Udhëzuesi i Lehtësuesit, Kërkimi për Gjuhën e Përbashkët, 2020.
75. Rezoluta e Këshillit të Sigurimit për gratë, paqen dhe sigurinë, Kombet e Bashkuara, S/RES/1325, miratuar në takimin e 1213-të të Këshillit të Sigurimit, 31 tetor 2000.
76. Liria e fesë dhe besimit, si dhe liria kundër dhunës dhe diskriminimit me bazë orientimi seksual dhe identiteti gjinor, Raport i Ekspertit të Pavarur për mbrojtjen ndaj dhunës dhe diskriminimit me bazë orientimi seksual dhe identiteti gjinor, Këshilli i të Drejtave të Njeriut, sesioni i pesëdhjetë e pestë, 19 qershor-14 korrik 2023.
77. Plani i Veprimit i qeverisë norvegjeze për Diversitetin Gjinor dhe Seksual (2023-2026), Ministria e Kulturës dhe Barazisë e Norvegjisë, Oslo, 27 janar 2023.

- 78.** Referencë janë atentatet në vendet ku rrinte komuniteti LGBTI që lanë të vdekur dy persona dhe lënduan rëndë nëntë të tjerë në natën para paradës së Krenarisë së Oslos, në qershor 2022, nga një person që sipas prokurorisë ishte betuar për besnikëri ndaj Shtetit Islamik. Gjyqi filloi në mars 2024. Shih: Paul Kirby, [Videoja e sulmit me armë në lokalitë të gay-ve në Norvegji shfaqet në gjyq](#), faqja e internetit: [bbc.com](#), 12 mars 2024.
- 79.** Deklaratë e Përbashkët e udhëheqësve fetare të Këshillit të Komuniteteve Fetare dhe Qëndresës për Jetën në Norvegji (STL) dhe udhëheqësve të organizatave LGBTI dhe Njerëzit e Besimit të LGBTI. Sundvollen, 24 gusht 2023.
- 80.** *Po aty.*
- 81.** Goodhardt dhe Rosen, [Udhëzuesi i Lehtësuesit](#).
- 82.** *Po aty.*
- 83.** Puna me dhe për RININË: Udhëzime për integrimin rinor, Misioni i OSBE-së në Serbi, 2021; dhe Rachel Forster, Punim: Drejt udhëheqjes rinore për lirinë e fesë dhe besimit, Kërkimi për Gjuhën e Përbashkët, mars 2023.
- 84.** Historia jonë, Futbollit për Paqen, faqja e internetit.
- 85.** Paneli i Parë për Besimin dhe Shtetet e Brishta: Angazhimi Fetar në luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, Instituti i Paqes në SHBA, regjistrim video 38:00 39:38, 27 korrik 2018.
- 86.** *Po aty.*
- 87.** Sipas Databazës Botërore të Feve 2020 të Universitetit të Bostonit, myslimanët përbëjnë rreth 59% të popullsisë, të krishterët 38%, ateistët apo agnostikët 2.5% dhe Bahai 0.6%. Në vitin 2017, Kongresi Botëror Hebre vlerësojnë se ishin 40-50 hebre (Raporti për Lirinë Ndërkombëtare Fetare 2022: Shqipëri, Departamenti i Shteti, SHBA).
- 88.** Shih Hawre Ahmed Mohammed, Gjenocidi i fundit ndaj Popullit Jazidi, Rishikim i Studimeve të Lindjes së Mesme, Vol 56, Botimi 1, qershor 2022, Botim i Universitetit të Kembrixhit, fq. 108 122.
- 89.** Dokumentari “30 vjet liri besimi”, Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, 21 dhjetor 2020.
- 90.** Konventa për Të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD), Kombet e Bashkuara, Rezoluta A/ RES/61/106 e Asamblesë së Përgjithshme (sesioni i gjashtëdhjetë e një), miratuar më 12 dhjetor 2006.
- 91.** *Po aty*, neni 29.6.
- 92.** Dokumenti i Takimit të Moskës për Konferencën mbi Dimensionin Njerëzor të KSBE, OSBE, 3 tetor 1991, pikat 41.2, 41.3 dhe 41.5.
- 93.** Faqja e internetit: [E lehtë për lexim. Evropa Përfshirëse](#).
- 94.** Komunikimi Shtues dhe Alternativ (AAC), faqja e internetit e Shoqatës Amerikane për të Folurin-Gjuhën-Dëgjimin (ASHA).
- 95.** Faqja e internetit e Tryezës së Rrumbullakët Ndërkombëtare për Lirinë Fetare.
- 96.** Sipas të dhënave të Institutit Publik Kërkimor për Fenë, në vitin 2022, amerikanët e përshkruanin veten si pa përkatësi fetare 26.8%, protestantë të bardhë 13.9%, protestantë evangjelistë të bardhë 13.6%, katolikë të bardhë 12.6%, katolikë hispanikë 8.6%, protestantë të zinj 7.7%, protestantë hispanikë 3.5%, protestantë të tjerë jo të bardhë 2.5%, hebrej 1.9%, epoka e re 1.6%, mormonë 1.5%, dëshmitarë të Jehovait 1.1%, budistë 0.7%, hindu 0.7%, myslimanë 0.6%, unitarianë 0.5%, të krishterë ortodoksë 0.5%.
- 97.** OSBE, [Lehtësimi i Ndërmjetësimit dhe Dialogut në OSBE](#).
- 98.** Karta e Oslos, Paneli Ndërkombëtar i Parlamentarëve për Lirinë e Fesë dhe Besimit (IPPFoRB), nëntor 2014.
- 99.** Raporti Parlamentar për Fenë dhe Besimin: Të punojmë drejt Shoqërive më Paqësore dhe Gjithëpërfshirëse, Unioni Ndërparlamentar, 2023.
- 100.** Faqja e internetit e Aleancës Neni 18 (Neni 28 Aleanca).
- 101.** Rezoluta 16/18 për Luftën ndaj intolerancës, stereotipizimit negativ dhe stigmatizimit, si dhe diskriminimit, nxitjes për dhunë dhe dhunës ndaj personave me bazë feje apo besimi (A/HRC/RES/16/18), Kombet e Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Të Drejtave të Njeriut, 12 prill 2011.
- 102.** Faqja e internetit e [Feve për Paqen](#).
- 103.** Faqja e internetit e [Rrjetit Global të Grave të Besimit, Fetë për Paqen](#).
- 104.** Faqja e internetit e [Rrjetit Rinor Ndërfetar, Fetë për Paqen](#).
- 105.** Faqja e internetit e [Kërkimit për Gjuhën e Përbashkët](#).
- 106.** Faqja e internetit e [Kodit Universal për Vendet e Shenjta, Kërkimi për Gjuhën e Përbashkët](#).
- 107.** Për më shumë informacion mbi Kodin Universal dhe përfshirjen e SFCG-së në Bosnjë-Hercegovinë, shih modulin e dytë të këtij kursi në internet të krijuar nga SFCG dhe USIP për Angazhimin Fetar në Ndërtimin e Paqes - Qasja e Gjuhës së Përbashkët.
- 108.** Për të identifikuar Pikat e Forta, Pikat e Dobëta, Mundësitë dhe Kërcënimet.
- 109.** Për të vlerësuar risikun potencial Politik, Ekonomik, Social, Teknologjik, Ligjor dhe Mjedisor.

